



4 Buxheti i autostradës

Portreti i muajit: U dekorua mikja e Kosovës 2

Milazim KRASNIQI: Autostrada që na e rrit vetëbesimin .. 3

Lulzim Ahmeti: Buxheti i autostradës 4-5

Intervistë me Arsim Bajramin..... 6-7

Fitim Veliu: Debati parlamentar: etika, diskursi dhe politika 8

Intervistë me Fatmir Sfishtën 9-10

Besnik Boletini: Konsumimi i duhanit në QKUK po dëmton pacientët 11-12

Muhamet Jahiri: BE-ja mbështet Republikën e Kosovës në rrugën e saj të integritimit 13

Edona Magashi: Rritet numri i lëndëve të pazgjidhura .. 14

Amel Ilmiu: I duam edhe pse na urrejnë! 15-16

Intervistë me Atifete Jahjagën 17-19

A.A.: Në fokusin ndërkombëtar 20-21

Muhamed J. Kajolli: Masakra në Medinë 22-25

John Esposito: Amerika & Pranvera Arabe: një rrugë e re përpara..... 26-27

Nexhat Ibrahim: Nocioni "terrorizmi islam" në kontekst të gabuar 28-29

Robert F. Worth: Intelegjencia arabe 29-30

George W. Gawrych: Sundimi otoman, Islami dhe shqiptarët, 1874-1913 31-36

Intervistë me Ilir Muharremin..... 36-37

Artan Bejta & Jehona Sahiti: Stresi i shkaktuar nga traumat! 38-39

Alban Bilalli: Berisha hyn në analet e futbollit australian..... 40



9 Intervistë me Fatmir Sfishtën




11 Konsumimi i duhanit në QKUK...



13 BE-ja mbështet Republikën...



28 Nocioni "terrorizmi islam"...



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET,
KULTURË, ARSIM, ETIKË

Viti VI / Nr. 60

19 nëntor - 19 dhjetor 2011

Botues

Zëri Ynë

O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor

Muhamed Jusufi - KAJOLLI

kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës

Avni AVDIU

avni.avdiu@gmail.com

Redaktor i kulturës

Flamur MALOKU

flamurmalku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika

Osman D. GASHI

osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore

Mimoza SINANI

e-mail:

revistapaqja@gmail.com

revistapaqja@hotmail.com

http://www.zeri-yne.org

Adresa:

Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14,
përballë teatrit Dodona,
Prishtinë, Kosovë



Micheline Anne-Marie Calmy-Rey
Presidente dhe Ministre e Jashtme
e Zvicrës

U DEKORUA MIKJA E KOSOVËS

Presidentja dhe Ministra e Punëve të Jashtme të Zvicrës, Micheline Anne-Marie Calmy-Rey, mori çmimin “Diaspora”, të cilin ia ndau mërgata shqiptare e Kosovës në Zvicër. Ceremonia e ndarjes së çmimit u bë në kryeqendrën zvicerane, në Bernë, në një sallë protokollesh qeveritare zvicerane. Ndarjes së çmimit i parapriu një marrëveshje në sferën e transportit e nënshkruar me ministrin e jashtëm të Kosovës, Enver Hoxhaj.

Çmimi “Diaspora” iu dha ministres së jashtme zvicerane, nga Shpëtime Kamberi, arkitekte e re, e cila edhe e punoi statujën e arit. Ky çmim iu dha si shenjë mirënjohje dhe respekti për kontributin për shtetësinë e Kosovës.

Micheline Calmy-Rey u shpreh shumë e emocionuar me rastin e ndarjes së çmimit dhe me vlerësimin që iu bë asaj dhe Zvicrës. Një fjalë falënderimi, në konferencën për medie që u mbajt në një sallë protokollesh të Qeverisë së Zvicrës, e mbajti edhe ministri Hoxhaj. Po ashtu edhe ambasadori i Kosovës në Zvicër, Naim Malaj falënderoi presidenten Calmy-Rey dhe Zvicrën për gjithë atë që kanë bërë për Kosovën në kohët më të vështira që ajo ka kaluar.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes në fushën e transportit dhe rrugëve, presidentja dhe ministria e punëve të jashtme të Zvicrës bashkë me ministrin e punëve të jashtme të Kosovës, mbajtën një konferencë shtypi, ku ishin të pranishëm përfaqësues të shumë medieve zvicerane dhe atyre shqiptare që veprojnë në Zvicër. ■

BIOGRAFIA:

Micheline Anne-Marie Calmy-Rey u lind më 8 korrik 1945 në Sion, Valais. Është Presidente e Konfederatës së Zvicrës dhe gjithashtu ministre e punëve të jashtme të Zvicrës. Ka qenë anëtare e Këshillit Federal Zviceran që prej vitit 2003. U bë kryetare e Konfederatës më 2007 dhe sërish më 2011. U diplomua në Institutin e Studimeve Ndërkombëtare në Shën Maurice më 1963 në shkencat politike. Më 1966 u martua më Andre Calmyn me të cilin kanë dy fëmijë. Si anëtare e Partisë Socialdemokrate gjatë periudhës 1981-1997 ka qenë përfaqësuese në Këshillin e Lartë të Kantonit të Gjenevës. Në periudhën 1992-1993 u bë presidente e asamblesë. Prej 1986-1990 dhe 1993-1997 ishte kryetare e degës së partisë së saj në Gjenevë. Në vitin 1997 u zgjodh anëtare e Këshillit të Shtetit në Gjenevë. Më 2001 u vu në krye të Departamentit të Financave dhe u bë presidente e Këshillit të Shtetit. Më 4 dhjetor 2002 u zgjodh në Këshillin Federal, duke kryesuar Departamentin Federal të Punëve të Jashtme. Ishte gruaja e katërt e zgjedhur në Këshillin Federal në historinë e Zvicrës. Më 7 dhjetor 2005 u zgjodh nënkryetare e Zvicrës, funksion ky që e

kreu deri më 2006. Më 1 janar 2007 u bë Presidente e Konfederatës me 147 vota, e dyta femër e në historinë e Zvicrës. Calmy-Rey u zgjodh nënkryetare për vitin 2010, duke shërbyer së bashku me Doris Leuthard. Më 8 dhjetor 2010 u zgjodh, për herë të dytë, si Presidente për vitin 2011. Calmy-Rey është anëtare e Këshillit Botëror të Grave Lidere, një rrjet ndërkombëtar i presidenteve të tanishme dhe ish-grave e kryeministreve, misioni i të cilave është për të mobilizuar gratë udhëheqëse në nivel global në një nivel më të lartë veprimi kolektiv për çështje me rëndësi kritike për gratë dhe barazinë e tyre në zhvillim. Micheline Anne-Marie Calmy-Rey është kritikuar gjerë e gjatë për shkak të vendosjes së shamisë kur takoi presidentin iranian Mahmud Ahmedinixhad më 19 mars 2008. Shfaqja e saj me presidentin iranian përpara medieve ngjalli reagime të fuqishme negative. Ajo gjithashtu nxitu edhe polemika me rastin e nënshkrimit të një marrëveshjeje miltimiliardëshe për furnizim të energjisë zvicerane me gaz natyror nga Irani. SHBA, Izraeli dhe Kombet e Bashkuara u ankuan se Zvicra përcolli mesazhe të gabuara në kohën kur Teherani është subjekti i sanksioneve të OKB-së.

Autostrada që na e rrit vetëbesimin



Milazim KRASNIQI

Inaugurimi i 38 kilometrave të parë të autostradës, nga Vërmica deri në Suharekë, është një ngjarje e veçantë në historinë e re të Kosovës së pavarur, sepse e vërteton seriozitetin e shtetndërtimit. Vetëm ato shtete që kanë qëndrueshmëri dhe vizion për të ardhmen, investojnë në këso projektesh të mëdha. Vetëm shoqëritë që kanë besim në veten e tyre, janë në gjendje të përballojnë kostot e projekteve të këtilla.

Ndërsa, ndërtimi i kësaj autostrade do ta rritë edhe më shumë vetëbesimin e shtetit dhe të shoqërisë sonë, se mund të ecin përpara, duke i përzgjedhur vetë projektet që shprehin interesat strategjike. Lidhja e autostradës së Kosovës me atë të Shqipërisë, pa asnjë dyshim, është pjesë e atij interesi strategjik që e ndryshon pozitën ekonomike dhe gjeopolitike të Kosovës. Integrimet shumëplanëshe brendakombëtare do ta lehtësojnë edhe integrimin europian të Shqipërisë dhe të Kosovës, duke e ridimensionuar edhe pozitën e edhe fuqinë reale të kombit shqiptar.

Nga ana tjetër, frymëmarrja e re e Kosovës me daljen e shpejtë dhe të lehtë në Detin Adriatik, e inkadrion në hapësirën e gjerë të Mesdheut, duke e nxjerrë nga darët e hekurta të kufijve e kufizimeve sllave. Më askush nuk mund të thotë se rruga e shqiptarëve për në Europë duhet të kalojë nëpër Beograd, sepse thjesht ka ndërruar gjeografia e

rrugëve. Andej mund të ndërlihen rrugët për në korridoret paneuropiane, por jo si pronësi serbe mbi ato rrugë.

Autostrada e Kosovës vërtet është autostradë e shpresës, sikundër e quajti Kristofer Delli, ambasadori amerikan në Prishtinë. Është shpresë për të ardhmen e sigurt të shtetit të Kosovës dhe të kombit shqiptar në përgjithësi. Në të vërtetë, shpresa dhe besimi në të ardhmen më të mirë ka qenë në themel të kësaj autostrade, edhe atëherë kur pak njerëz kanë besuar se ajo do të bëhej një ditë. Me dhjetëra herë e kam dëgjuar presidentin e ndjerë, Ibrahim Rugovën, se si fliste me optimizëm për atë rrugë të kombit, deri sa qëndronim të vetmuar në barakën e vogël të Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, hiç më larg se njëqind metra larg tytave që bënin kujdestari në kulmin e objektit kryesor të policisë serbe. Ajo shpresë dhe ai besim, të përzier me intuitën e prodhuar nga përvojat e të kaluarës, kur ajo rrugë bashkonte viset ilire, e ka mbajtur në këmbë këtë popull, edhe kur furtunat e pushtimit ishin asgjësuese. Ajo shpresë u ka dhënë forcë e guxim luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që nëpër acar ta sfidonin kufirin e vdekjes, që kishte ngritur okupatori serb. Ish-shefi i Shtabit Operativ të UÇK-së, Bislim Zyrapi, më ka treguar se si një herë, deri sapo e kalonin Pashtrikun në mes të dimrit, një luftëtar i kishte kërkuar që të ktheheshin, meqë bënte një i ftohtë e tmerrshëm, sa kishin filluar të ngrinin. Por, ai i kishte thënë të ecte përpara, me besim se do të mbërrinin

të padëmtuar në cak, gjë që edhe ishte përmbushur. Prandaj, kjo autostradë, si produkt i vizionit dhe i luftës për liri, është rrugë e shpresës, vërtet.

Nëse kemi shpresuar për një të ardhme të mirë, kur kemi qenë nën okupim të egër, pse të mos shpresojmë dhe të besojmë tash, kur jemi në liri dhe të pavarur? Tash e ardhmja jonë nuk varet nga armiq të tanë, po varet nga vetja jonë dhe nga aleatët tanë.

Por, kjo përgjegjësi e fituar me shumë sakrificë, e cila na ka bërë shtet dhe shoqëri të lirë, sigurisht që kërkon edhe diçka sublime prej të gjithëve: kërkon të mposhtet edhe e keqja e vetes sonë. Ndërtimi me kaq sukses i kësaj pjese të autostradës tregon se kur ka vullnet, seriozitet dhe dashuri për vendin, mund të përballohen edhe projekte kaq të mëdha zhvillimore e integruuese. Por, për të pasur edhe projekte të tjera të mëdha, që do ta bëjnë vendin tonë një vend të respektuar, shoqëria jonë dhe qeveria jonë, duhet ta luftojnë në të gjitha frontet babëzinë dhe ligësinë, që na i ka lënë trashëgimi robëria shfytyruese, komunizmi çnjerëzor dhe tranzicioni i egër.

Kur e shikojmë këtë vepër madhështore, të ngritur me mundin tonë, bindemi se mund të bëjmë edhe më shumë, gjë që na e rrit vetëbesimin, i cili është i domosdoshëm për të ecur përpara. Prandaj, shikojeni me dashuri këtë vepër madhështore dhe forcojeni besimin në veten tuaj, si dhe në mundësitë e shtetit, të shoqërisë dhe të kombit tonë. ■

BUXHETI I AUTOSTRADËS

Lulzim AHMETI

Qeveria e Kosovës ka përgatitur buxhetin për vitin 2012, i cili do të jetë mbi 1.5 miliardë euro. Paratë më të mëdha janë orientuar për investime në infrastrukturën rrugore. Buxheti i miratuar nga Qeveria do të jetë për 7.7 për qind më i madh se i vitit 2011, por e metë e buxhetit është se të hyrat janë orientuar të mbledhen kryesisht nga ana e doganave të Kosovës, si dhe një pjesë nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK). Shumica e buxhetit të Ministrisë së Infrastrukturës do të përdoret për kryerjen e punimeve në autostradën Vermicë-Merdare. Qeveria ka paraprirë që 260 milionë euro të përdoren për autostradën vetëm gjatë vitit 2012, e çmimi përfundimtar i saj ende nuk dihet.

Ministri i Financave (MF), Bedri Hamza, ka thënë se buxheti i vitit 2012, për herë të parë, kalon vlerën e 1.520 miliardë eurove. Sipas tij, buxheti i ri siguron rritje ekonomike prej 5 për qind për vitin 2012. Ministri Hamza ka treguar se të hyrat e rregullta buxhetore për vitin 2012 pritet të jenë prej 1 miliard e 361 milionë eurosh, ose 4 për qind më të larta se në vitin 2011. “Nga këto të hyra, doganat e Kosovës pritet të grumbullojnë 860 milionë euro, ndërsa Administrata Tatimore pritet të mbledh mjetet në vlerë prej 285 milionë euro. Përpos këtyre të hyrave të rregullta dhe burimeve të tjera, do të trashëgojmë edhe një bilanc pozitiv bankar prej mbi 120 milionë eurosh nga ky vit, që do të përdoret si burim shtesë i financimit”, - ka theksuar Hamza. Sipas tij, mbi 40 për qind e buxhetit do të shpenzohet për projekte kapitale. “Shpenzimet për paga dhe mëditje janë 407 milionë euro, shifër kjo që paraqet një ngritje prej 5.4 për qind në krahasim me vitin 2011”.

Sipas ministrit Hamza, shpenzimet për mallra dhe shërbime janë paraparë të jenë 198 milionë euro. Ai ka garantuar se buxheti për vitin 2011 /12 ruan nivelin e lartë të shpenzimeve kapitale, me pjesëmarrje 40.5 për qind në buxhetin e tërësishëm. “Shpenzimet kapitale janë paraparë të jenë 616 milionë euro,

Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka treguar se Doganat e Kosovës do të jenë kontribuuesit kryesorë në buxhetin prej mbi 1 miliard e 520 milionë eurove. Ato pritet të grumbullojnë 860 milionë euro, ndërsa Administrata Tatimore 285 milionë euro

shifër kjo që përfaqëson një ngritje prej 15 për qind në krahasim me vitin 2011”, - ka theksuar ministri i Financave Bedri Hamza. Sipas tij, buxheti është në harmoni të plotë me marrëveshjen e arritur më herët ndërmjet Qeverisë dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN).

Buxheti i vitit 2011 është 1 miliard e 264 milionë euro të hyra buxhetore, ndërsa 1 miliard e 434 milionë euro shpenzime.

Megjithëkëtë, Avdullah Hoti, nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e ka kritikuar Qeverinë për mënyrën e hartimit të buxhetit. Sipas tij, buxheti për vitin 2012 nuk ka asnjë element të zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies sociale. Hoti theksoi se Qeveria do t'i ketë keq punët edhe me organizatat financiare ndërkombëtare, pasi nuk ka mësuar nga gabimet e veta. “Sikurse këtë vit, edhe buxheti i vitit 2012 ka të njëjta probleme strukturore. Deficiti buxhetor pritet të jetë 3.5 për qind, që është mbi normën e lejuar me standarde evropiane prej 3 për qind të GDP-së”, - ka deklaruar Hoti. Sipas tij, 466 milionë euro, ose 34 për qind e të hyrave në këtë projektbuxhet, janë mbi burimet e supozuara, siç është privatizimi i PTK-ës, letrat me vlerë dhe donacionet nga FMN-ja.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH), 2012-2014, sipas profesorit të ekonomisë Avdullah Hoti, është dokument i pavlerë për LDK-në, e po ashtu edhe Plani i Bullgarisë, i cili është hedhur poshtë nga vetë përpiluesit e tij, pasi që asnjë nga objektivat e këtij plani nuk është planifikuar në buxhetin e vitit 2012. “Qeveria përfundimisht hoqi dorë nga vizionet për rritje ekonomike prej 7 deri në 8 për qind dhe zvogëlim të papunësisë 8 deri në 10 për qind. Të gjitha këto janë konfirmuar nga vetë qeveria. Në dokumentin përcjellës të buxhetit për vitin 2012, pranohet se rritja ekonomike do të jetë vetëm 5 për qind, e jo 8 për qind, si është proklamuar në planin e Bullgarisë”, - ka thënë Hoti.

Kurse, drejtori i Institutit për Studime të Avancuara (GAP), Agron Demi, tha se disa nga projektet e planifikuara kapitale, për këtë vit, do të barten në

vitin e ardhshëm. Rrjedhimisht, sipas tij, së bashku me projektet do të barten edhe fondet. “Nëse bazohemi në buxhetin e vitit 2011, ku Ministria e Financave ka bërë publikimin e raporteve buxhetore deri në fund të shtatorit, duket se për kategorinë e investimeve kapitale vetëm 55 për qind e mjeteve janë shpenzuar në këtë nëntëmujor”, - është shprehur Demi. Deri në fund të vitit, sipas tij, kjo shifër mund të arrijë në 70 për qind, kurse 30 për qind e mjeteve të shpenzimeve kapitale do të transferohen në vitin tjetër. Andaj, Demi mendon se ka një shifër të fryrë për buxhetin e vitit 2012.

Në anën tjetër, profesori i ekonomisë, Muhamet Sadiku, ka thënë se Kosova është e obliguar që ta ruajë rezervën minimale në buxhet prej 250-280 milionë euro, sipas rekomandimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN). “Pra 250-280 milionë euro në buxhet nuk duhet të llogariten, pasi që ato janë rezerva dhe Qeveria nuk guxon t'i shpenzojë, me qëllim të ballafaqimit me rreziqet e paplanifikuara fiskale”, - ka potencuar Sadiku. Megjithatë, sipas tij, shuma prej 160 milionë euro është një deficit i planifikuar, e cila shumë, mund të jetë edhe më e madhe, nëse situata makroekonomike destabilizohet, ose nëse mungojnë investimet e



huaja direkte. "Definitivisht vitin tjetër Qeveria e Kosovës duhet të jetë shumë e kujdesshme me investimet", - ka porositur Sadiku.

Ndërsa, Sekretari i Përgjithshëm i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, ka thënë se buxheti për vitin 2012 është bërë në bazë të projeksioneve reale. Sipas tij, "Kosova edhe këtë vit ka projektuar të hyra që nuk janë realizuar, por gjithmonë duhet të ketë alternativa për zëvendësimin. Nëse Qeveria e Kosovës, sipas Rukiqit, i përmbahet marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar mund të thithen prapë donacione nga ky institucion. "Ky buxhet është harmonizuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Infrastruktura ende është një nga shqetësimet kryesore për investime dhe biznes. Në të njëjtën kohë rritja ekonomike ende ka nevojë për investime kapitale, prandaj në këtë sens investimi në infrastrukturë është i arsyeshëm", - ka thënë sekretari i OEK-ut, Berat Rukiqi.

Dogana e ATK-ja optimistë për të hyrat

Për drejtuesit e Doganës së Kosovës dhe Administratës Tatimore të Kosovës, mbledhja e të hyrave të parapara nga qeveria e Kosovës nuk do të jetë problem për vitin 2012. Doganat e Kosovës, vitin e ardhshëm, parashikohet t'i grumbullojnë rreth 860 milionë euro. Drejtori i Doganave, Naim Huruglica, ka thënë se kjo shumë nuk do të jetë problem të arrihet, pasi që dogana ka rritur efi-

kasitet në inkasimin e të hyrave. "Nëse bëjmë krahasim me këtë vit, ajo paraqet një rritje prej rreth 4 për qind, jo më shumë. Përderisa sivjet trendet janë se kemi arritur t'i mbledhim mbi 18 për qind krahasuar me vitin 2010, nuk besoj se ka arsye fare për shqetësim, se nuk do të arrijmë t'i grumbullojmë ato të hyra për 2012. Bile besoj se ato do të tejkalohen", - ka theksuar Huruglica. Për mospasjen e problemeve për mbledhjen e 285 milionë eurove, gjatë vitit 2012, u shpreh edhe drejtori i ATK-së, Behxhet Haliti. Përpos të hyrave nga Doganat e Kosovës dhe ATK-ja, do të trashëgohet edhe një bilanc pozitiv bankar prej mbi 120 milionë eurosh nga ky vit, që do të përdoret si burim shtesë i financimit.

Prin Kuvendi me buxhet

Kuvendi i Kosovës, për vitin 2012, do të ketë një buxhet prej 15.4 milionë eurosh, ndërsa Presidenca do ta ketë buxhetin vetëm 2.5 milionë euro, e Zyra e Kryeministrit nuk do të jetë edhe keq për nga paratë. Buxheti i kësaj zyre, për vitin 2012, do të jetë hiç më pak se 8.8 milionë euro.

Buxheti i ministrive, të cilat janë nën hierarkinë e kryeministrit, do ta kenë këtë buxhet për vitin 2012.

Buxheti i ministrive për vitin 2012

Ministria e Financave (MF) do ta ketë buxhetin 43.5 milionë euro, Ministria e Administratës Publike (MAP) 21.7 milionë euro, Ministria e Bujqësisë Pyll-

tarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) 21.4 milionë euro, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) 6.8 milionë euro, Ministria e Infrastrukturës (MI) 278.5 milionë euro, Ministria e Shëndetësisë (MSH) 88.5 milionë euro, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS) 18.0 milionë euro, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASHT) 40.9 milionë euro, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) 212.0 milionë euro, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) 66.8 milionë euro, Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) 7.1 milionë euro, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) 6.5 milionë euro, Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) 39.1 milionë euro, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) 99.5 milionë euro, Ministria e Drejtësisë (MD) 19.1 milionë euro, Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) 16.2 milionë euro, Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK) 35.8 milionë euro, Ministria e Integritit Evropian (MIE) 1.4 milionë euro, si dhe ministria e cila do të ketë më së paku buxhet për vitin 2012 do të jetë Ministria e Diasporës (MeD) 1.2 milionë euro.

Buxheti i komunave për vitin 2012

Sa i përket buxhetit, i cili iu është ndarë komunave të Kosovës nga Qeveria për vitin 2012, edhe këtë vit prin kryeqyteti. Shuma e mjeteve sipas buxhetit është: Prishtina 61.7 milionë euro, Prizreni 31.5 milionë euro, Ferizaj 19.5 milionë euro, Mitrovica 18.6 milionë euro, Gjakova 18.2 milionë euro, Peja 18.2 milionë euro, Gjilani 17.7 milionë euro, Podujeva 16 milionë euro, Vushtrria 12.5 milionë euro, Suhareka 12.2 milionë euro, Lipjani 11.4 milionë euro, Malisheva 9.9 milionë euro, Skenderaj 9.8 milionë euro, Drenasi 9.4 milionë euro, Rahoveci 9.3 milionë euro, Vitia 8 milionë euro, Kamenica 7.2 milionë euro, Istogu 7.1 milionë euro, Klina 7 milionë euro, Deçani 6.1 milionë euro, Fushë Kosova 6 milionë euro, Dragashi 5.5 milionë euro, Kaçaniku 5.5 milionë euro, Graçanica rreth 5 milionë euro, Shtimja 4.6 milionë euro, Obiliqi 4.3 milionë euro, Shtërpca 3 milionë euro, Novobërda 2.2 milionë euro, Hani i Elezit 1.7 milion euro, Juniku 1.2 milion euro, Ranilluga 1.1 milion euro, Mamusha 1 milion euro, Klllokoti 930 mijë euro dhe Parteshi 922 mijë euro. ■



Intervistë me Arsim Bajramin

Qytetarët kërkojnë të jenë faktor të pr

“Një prej propozimeve shumë interesante që nuk e kemi paraparë ne si komision ka qenë e drejta e qytetarëve që jo vetëm ta propozojnë presidentin me 15 mijë nënshkrime, por edhe të kërkojnë largimin ose shkarkimin e tij drejtpërdrejt me nënshkrime”, - ka thënë kryetari i Komisionit për Amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Arsim Bajrami

Intervistoi: Qëndresë MUSTAFA

Qytetarët e Kosovës në të ardhmen mund të jenë faktorë në procedurën e shkarkimit të Presidentit të vendit. Një kërkesë e tillë nga qytetarët është bërë gjatë debateve publike nëpër komunat e Kosovës mbi ndryshimin e Kushtetutës së vendit. Në një intervistë për revistën “Paqja”, kryetari i Komisionit për Amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Arsim Bajrami, një iniciativë të tillë e ka vlerësuar si burimore, ndërsa ka pranuar se kjo nuk ishte paraparë nga komisioni që ai drejton. “Ne do të shohim si mund ta krijojmë një amendament në mënyrë që qytetarët të jenë faktor edhe në procedurën e shkarkimit të presidentit”, - ka thënë Bajrami.

Ndër të tjerash Bajrami ka treguar se gjatë debateve, qytetarët kanë kërkuar që presidenti i ardhshëm të ketë zëvendëspresident, ndërsa, sipas tij, kandidati për president është kërkuar të mos ketë dy shtetësi.

Bajrami ka thënë se pjesa e dytë e nëntorit do të jetë faza ku do të fillohet debati me partitë politike dhe më pas draft amendamentet do t'i dërgohen Komisioni të Venecias për të dhënë mendimin rreth disa çështjeve të caktuara.

“PAQJA”: *Z. Bajrami, komisioni ka përfunduar debatet me qytetarët për amendamentimin e Kushtetutës së Kosovës. Çfarë propozimesh kanë pasur ata?*

Bajrami: Ne tash i kemi marrë mendimet e qytetarëve dhe jemi duke i klasifikuar dhe analizuar ato. Komisioni do të vendosë se cilat nga këto opsione të qytetarëve do të mund të plotësojnë amendamentet kushtetuese. Njëkohësisht, jemi duke shikuar se cilat alternativa janë përkrahur nga qytetarët më shumë, në mënyrë që komisioni të jetë i sigurt me rastin e përfundimit të amendamenteve kushtetuese. Një prej propozimeve shumë interesante, që nuk e kemi paraparë ne si komision, ka qenë e drejta e qytetarëve që jo vetëm



Arsim Bajrami

ta propozojnë presidentin me 15 mijë nënshkrime, por edhe të kërkojnë largimin ose shkarkimin e tij drejtpërdrejt me nënshkrime. Një gjë të tillë nuk e ka paraparë komisioni dhe ne do të shohim si mund ta krijojmë një amendament në mënyrë që qytetarët të jenë faktor edhe në procedurën e shkarkimit. Madje ka pasur propozime që të kemi edhe kushte shtesë për kandidatët për president, si: të jetë i lindur në Republikën e Kosovës, të jetë familjar, të jetë i martuar dhe të ketë fëmijë, në mënyrë që të sigurohet se bëhet fjalë për një personalitet social dhe familjar, çfarë ekziston edhe në disa kushtetuta të vendeve përëndimore.

“PAQJA”: *Sa do ta merrni parasysh iniciativën e qytetarëve për shkarkimin e presidentit me anë të nënshkrimeve?*

Bajrami: Po kjo do të merret seriozisht, sepse kjo është një iniciativë shumë burimore, e cila me siguri do të gjejë vend në amendamentet e reja dhe është rezultat drejtpërdrejt i propozimeve të qytetarëve në debatin publik.

“PAQJA”: *Sa janë përkrahur alternativat e komisionit nga qytetarët e Kosovës?*

Bajrami: Ne, si komision, kemi lënë me qëllim disa alternativa për të provokuar qytetarët që të jenë më aktivë në debat. Alternativa kryesore ka qenë ajo e zëvendësimit të përkohshëm të presi-

dentit. Ne kemi dalë me dy alternativa: atë që të shkojmë me modelin aktual, të përfaqësimit përmes Kryetarit të Kuvendit dhe ajo përmes një zëvendëspresidenti. Alternativa tjetër ka qenë ajo e kandidaturave, ku kemi pasur dy opsione: opsionin sipas të cilës partitë politike kanë të drejtë të propozojnë direkt kandidat për president dhe opsionin i dytë që edhe kandidatët e partive politike duhet të kenë 15 mijë nënshkrime. Ndërsa alternativa e tretë që e kemi lënë në këtë debat ka qenë ajo rreth shtetësisë së kandidatit për president, ku kemi pasur dy koncepte: njeri ka qenë që nuk është pengesë që një president të ketë edhe shtetësinë e dytë, meqenëse kushtetuta garanton dyshtetësinë dhe alternativa tjetër që presidenti, para se ta japë betimin, të lirohet nga shtetësia e dytë, në mënyrë që t'i përkushtohet tërësisht përfaqësimit të interesave të Republikës së Kosovës.

“PAQJA”: *Si kanë vendosur qytetarët sa i përket çështje se zëvendësimit të presidentit dhe çështjes së shtetësisë?*

Bajrami: Nga këto është përkrahur dukshëm më shumë opsioni i zëvendëspresidentit, sepse qytetarët kanë dashur të jenë të sigurt se për kë shkon vota e tyre si president. Ata kanë kërkuar që vota e tyre ta përcaktojë edhe zëvendëspresidentin, në rast të largimit të para-

Procedurës së shkarkimit të Presidentit

kohshëm. Në të gjitha qytetet e Kosovës, nga shumica dërmuese ose absolute e qytetarëve, është përkrahur opsioni i zëvendës-presidentit. Sa i përket shtetësisë së presidentit ka pasur opinione të ndryshme, por më tepër ka dominuar alternativa që presidenti duhet të lirohet nga shtetësia e dytë me rastin e marrjes së detyrës.

“PAQJA”: Z. Bajrami si do të vendosë komisioni sa i përket propozimeve të qytetarëve të Kosovës?

Bajrami: Ne jemi në fazën e përpunimit të rekomandimeve të qytetarëve. Më datën 14 dhe 15 nëntor, këto materiale do të jenë të gatshme dhe do t'i prezantohen komisionit dhe ideja është që komisioni të zvogëlojë numrin e alternativave. Natyrisht, se gjysma e muajt nëntor është faza kur ne do të bëjmë debat edhe me partitë politike dhe grupet parlamentare dhe tek pas marrjes së propozimeve nga partitë politike do ta finalizojmë tekstin të cilin simbolikisht do ta dorëzojmë në fund të vitit, pra një muaj para kohe, në mënyrë që edhe me këtë do të tregojmë se komisioni ka përmbushur mandatin e vet kohor dhe politik sa i përket reformës kushtetuese.

“PAQJA”: Z. Bajrami, ju keni deklaruar se për disa nga këto alternativat e diskutuara në këtë debat publik do të vendosë Komisioni i Venecias?

Bajrami: Gjithsesi. Pas takimit të datës 14 dhe 15 nëntor ne do t'i drejtohem Komisionit të Venecias, ku do të kërkojmë që ai komision, së paku për dy çështje të japë mendimin e vet specifik. Natyrisht, se ne do të kërkojmë ekspertizë të tekstit të amendamenteve, por për dy çështje do të kërkojmë në mënyrë specifike. Është fjala për praktikën evropiane sa i përket dështetësisë së kandidatëve për president dhe çështja e dytë ka të bëjë me kandidimin e kandidatëve nga partitë politike, se a thyhet parimi i barazisë dhe parimi i mosdiskriminimit nëse kandidatët e partive politike kandidohen në mënyrë automatike për president, pa pasur nevojë të mblidhen 15 mijë nënshkrime, kriter që vlen për kandidatët e paruar.

“PAQJA”: Z. Bajrami, po nëse partitë politike do të kërkojnë që të hiqet alternativa e dështetësisë, a do ta dërgoni prapë këtë çështje në Komisionin e Venecias?

Bajrami: Pa marrë parasysh epilogun e debatit me partitë politike, ne gjithsesi do ta kërkojmë mendimin e Komisionit të Venecias, sepse jam i sigurt se pas ardhjes së këtij mendimi do të ndërpritet debati politik dhe partitë politike do ta respektojnë plotësisht këtë ekspertizë të Komisionit të Venecias, pasi që ky komision është i specializuar për asistencë kushtetuese dhe të gjitha shtetet ku kanë pasur dilema, sidomos ku kanë pasur kontradikta dhe polarizime politike, kanë kërkuar ndërmjetësimin e këtij komisioni dhe, pas marrjes së vendimit të këtij komisioni, vendimi është implementuar praktikisht.

“PAQJA”: Z. Bajrami, po një pjesë dërmuese e këtij komisioni e përkrah alternativën që presidenti të mos ketë dështetësi?

Bajrami: Duhet ta pranojmë se pjesa më e madhe e anëtarëve e përkrah këtë opsion, sikurse që është përkrahur edhe në debatin publik. Mendoj se ky nuk është problem. Ka polarizime e dallime dhe mendoj se për këtë arsye është i nevojshëm arbitrimi ose dhënia e mendimit të Komisionit të Venecias. Me rëndësi është që të sigurohemi që në aspektin e këndvështrimeve të standardeve

evropiane si trajtohet kjo çështje, sepse kemi praktika të ndryshme kushtetuese. Në disa vende kërkohet shprehimisht kthimi i shtetësisë, në disa vende kthimi i shtetësisë kërkohet edhe në momentin e kandidimit. Ne do të shohim se cilat janë standardet evropiane në mënyrë që, me këto amendamente, të jemi plotësisht në pajtim me standardet më të reja të Bashkimit Evropian, sa i përket çështjes së shtetësisë.

“PAQJA”: Meqë shumica e anëtarëve të komisionit nuk e përkrahin këtë alternativë, atëherë cilët janë ata që po e kërkojnë një gjë të tillë?

Bajrami: Nuk mund të flas me emër se kush po e kërkon, por ka disa parti politike që e kanë problematizuar këtë çështje. Dua t'u siguroj se këtu nuk ka çështje personale. Ne kur e kemi shtruar këtë çështje nuk kemi menduar për individë, por në përgjegjësinë e funksionit dhe janë absolutisht krejt të pabaza personalizimet që bëhen për këtë çështje.

“PAQJA”: Ju, si njohës i praktikave të vendeve të tjera, cila mendoni se është alternativa më e duhur?

Bajrami: Personalisht unë nuk kam ndonjë problem, sepse e di që kushtetuta e Kosovës e njeh parimin e dështetësisë. Për mua kjo është më tepër kategori morale dhe mendoj se një kandidat serioz, i cili pretendon të marrë postin e presidentit, nuk ka asnjë arsye që të mos lirohet nga shtetësia e dytë edhe kur nuk e ka obligim kushtetues. Sepse funksioni i kryetarit është një funksion shumë i përgjegjshëm dhe kërkon angazhimin e plotë vetëm në Republikën e Kosovës. Mendoj se do të jetë shumë serioze për një kandidat që, kur ta fillojë garën, t'i garantojë qytetarët se në momentin kur të zgjidhet president do të shmangë çfarëdo interesi juridik me shtetin tjetër. Me këtë do ta fitojë besimin e qytetarëve dhe ata duhet të jenë të bindur se presidenti i tyre e ka marrë edhe kandidimin dhe postin shumë seriozisht dhe se ai nuk ka asnjë interes tjetër përveç interesit të Republikës së Kosovës. Pra kjo, më tepër, është kategori e kodit moral-politik. ■



DEBATI PARLAMENTAR: ETIKA, DISKURSI DHE POLITIKA

Fitim VELIU

Pasqyrimi subjektiv

Pothuajse është bërë zakon që të gjitha seancat e Kuvendit të Republikës së Kosovës të jenë top temat e kryelajmeve dhe kryetitujve të të gjitha mediave të shkruara dhe atyre elektronike. Jo pse aty zhvillohet ndonjë debat në frymën e konstruktivitetit parlamentar, etik e politik, por pse në të gjitha seancat e tilla deputetët e zhvendosin temën dhe qëllimin e seancës nga diskursi social në atë personal. Pra, seanca parlamentare thirret për të trajtuar një çështje objektive, me rëndësi nacionale e shpeshherë edhe kombëtare, por deputetët, në mungesë të përgatitjes, fakteve dhe dijenisë së tyre, e zhvendosin temën në debat personal.

Rrëshqitja e diskursit parlamentar

Në vend që të merren me shtetin, problemet, sfidat dhe rrugëzgjdhjet, ata merren me njëri - tjetrin gjatë tërë seancës, ku dominojnë akuzat e kundër akuzat, fyerjet e shantazhet. Madje për të qenë sa më superior ndaj tjetrit, deputetët nuk zgjedhin diskursin e të folurit, ku shpeshherë dominon edhe koncepti i vetëshpallur në rolin e demiurgut (selektuesit), ku deputeti përdor konceptet si gjynahqar, mëkatar. Kjo bëhet për ta shënjuar tjetrin në mungesë të mospunës së tij. Koncepti se tjetri është mëkatar, ose është gjynah i Zotit, përdoret si synim dhe qëllim pafajësie e pastërtie ndaj vetvetes. Religjioziteti formal i përdorur nga deputetët për qëllime personale dhe favore institucionale nuk i përjashton ata nga të qenit të paaftë për t'u marrë me shtetin dhe problemet e tij. Këto seanca parlamentare nuk i ngjajnë komunikimit të etikës e as politikës. Ato shpeshherë ngjajnë të jenë tragjike, komike e tragjikomike, por etike e politike assesi. Pra, diskursi rrëshqet çdo herë, pa e vënë re deputetët tanë të zgjedhur të "etikës politike". Seanca e mbajtur më 8. 11. 2011 ishte thirrur për të debatuar për reciprocitetin me Serbinë, por qytetarët nga kjo seancë mësuuan shumëçka tjetër, përpos çështjes së reciprocitetit. Kjo seancë afis-

honte më tepër dëshira, ëndrra, ambicie të deputetëve për karrierën e tyre personale, sepse pikërisht në atë ditë ishte lansuar një fiksiolajm mbi dekretimin e deputetëve në disa vende ndërkombëtare. Madje në këtë seancë i doli shumë punë edhe kryeministrit, kur deputeti i opozitës A. Gjini në rolin e gjykatësit filloi ta akuzojë kryeministrin se njerëzit e tij po gjykohen e rigjykohen për vepra të ndryshme. Kryeministri e personalizoi paksa debatin, por doli nga gracka për t'u mos u marrë me frustrimet e deputetit, i cili e sheh gjithçka vetëm zi. Diskursi i deputetit Gjini është i ashpër dhe frustues, subtil dhe jo argumentues. Është fjalaman, por i pavend dhe dekonspirues. Seanca nxori edhe fenomenin e tenderomanisë, madje për herë të parë në këtë seancë, Ministri, pa fajin e tij, por i shtyrë nën presionin e vazhdueshëm, pranoi se tenderin ja ka dhënë një të afërmi jo të largët, e deputeti Hamiti, në rolin e ciceronit parlamentar, duke menduar se përgjigja e ministrit nuk u dëgjua nga deputetët, e përfoli edhe njëherë fjalimin e ministrit, se tenderin ja ka dhënë të afërmit, pasi ministri mbaroi fjalimin e tij. Më e zëshme në këtë rast shfaqet deputetja D. Bujupi, e cila rastin e tenderit e quajti gjynah prej Zotit, kurse vetëm tri seanca më herët deputetja ishte kundër mësimëve të Zotit në shtetin laik. Kur nuk mund të deargumentojnë atë që thuhet para deputetëve, deputetët sillen



rrësh koncepteve fetare për ta ekspozuar etikën e tyre prej njerëzve të devotshëm e misionarë. E kjo i bën ta ndiejnë veten të paaftë, qyqarë e gjynahqarë të rastësishëm në këtë mes vorbulle. Në këtë seancë kishte edhe deputetë të atillë që kishin marrë një fiksiolajm mbi dekretimin e deputetëve në arenën ndërkombëtare, madje përfolja e disa prej emrave të deputetëve bëri që ata të deklarojnë përmes mediave admirimin që ata kanë për kryeministrin e tyre. Njëri nga deputetët e pozitës A.A, vendimin e kryeministrit të tij për dekretim e quan lajm të mirë për të. Ai shprehet i gatshëm të jetë në një mision të tillë. Ai brengoset për burimin e lajmit që nuk është zyrtar dhe institucional, por kjo ka pak rëndësi, kur emri i tij përfolet si mundësi.

Debati politik, formë pa përm-bajtje kruciale

Pra, debatet parlamentare janë pa vizion politik, pa diskurs etik të të folurit dhe pa ndonjë agjendë se si duhet të funksionojë tema, forma dhe përmbajtja e saj. Parlamenti vuan nga misioni dhe vizioni, gjuha dhe komunikimi, transparenca dhe llogaridhënia para qytetarëve. Misioni politik në vizionin e deputetëve është një idealitet fiktiv, misioni është më tepër teori e thënë, karshi punës praktike të pabërë. Misioni i deputetëve është vizioni i Alkimit të së Fishtës, ku koncepti atdhetar përkufizohet në karriqe, kuletë dhe pushtet. Ky është mision pa vizion, synim pa emocionin praktik. Gjuha lidhet me diskursin etik, pra të folurit nëpërmjet zgjedhjes së fjalëve të pastra gjuhësore, e jo fjalëve thumbuese, satirike, fyese. Gjuha parlamentare është larg domethënies së saj etike, kjo për shkak të mungesës së koncepteve të qarta politike. Të qenit politikan dhe të bërit politikë nënkupton statusin e etikës si qëndrim, të folur me kuptim dhe gjuhën e pastër si komunikim mes vete dhe të tjerët. Është ky trinomi statutar që ndërthet në vete formimin e politikanit deputet që duhet të ngrihet mbi dijen filozofike si mendim dhe gjenerim idesh, etikën si formim dhe qëndrim personal dhe politikën si mision nacional. ■

Intervistë me drejtorin e Qendrës së Studentëve në Prishtinë, Fatmir Sfishta

QENDRA SYNON ZGJERIMIN TEK FAKULTETI TEKNIK

Konvikti më i ri i Qendrës së Studentëve në Prishtinë, ai numër 7, pritet të hapet dhe të futet në shfrytëzim në fund të muajit nëntor të këtij viti. Në një intervistë për revistën "Paqja", drejtori i Qendrës së Studentëve, Fatmir Sfishta, ka thënë se është i privilegjuar që brenda 2 viteve e gjysmë është arritur t'i përurojë dy konvikte të reja, të cilat nuk janë ndërtuar që nga viti 1984. Mirëpo, ai është shprehur se, si drejtues i kësaj qendre, është i interesuar që zgjerimin e qendrës ta vazhdoj te kampusi rreth Fakultetit Teknik, ku ka në plan të ndërtojë 2 konvikte dhe ta funksionalizojë mensën që ndodhet aty

Intervistoi: Drita VITIA

Nëse e mbështet projektin financiarisht Qeveria e Kosovës ose Ministria e Arsimit, Qendra e Studentëve do t'i ketë edhe dy konvikte të reja, pas atij të shtatit, në pjesën rreth Fakultetit Teknik si dhe do të funksionalizohet mensa që gjendet atje, e që për momentin është në shfrytëzim të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Një projekt të tillë, drejtori i Qendrës së Studentëve, Fatmir Sfishta, në një intervistë për revistën "Paqja", ka thënë se ia ka propozuar prej kohësh Ministrisë së Arsimit dhe se po pret derisa kjo e fundit t'i gjejë mjetet për financim. Ndërkohë, konvikti më i ri, konvikti nr. 7, i cili është para finalizimit, sipas drejtorit Sfishta, pritet të hapet në fund të këtij muaji.

PAQJA: Kur pritet të hapet për studentë konvikti numër 7?

Fatmir Sfishta: Ky konvikt, me 440 vende, pritet të hyjë në funksion në fund të muajit nëntor. Mendoj që edhe intensiteti i punëve është i jashtëzakonshëm në mënyrë që të jetë i gatshëm për studentët në fund të këtij muaji.

PAQJA: Në çfarë faze janë punimet tani?

Fatmir Sfishta: Unë mendoj që tani punimet janë në fazën kozmetike siç quhet, në fazën detale të ndërtimit dhe tani pritet që edhe operatori, i cili e ka fituar tenderin, t'i sjellë edhe pajisjet e para dhe të fillojë t'i vendosë nëpër dhomat e konvikteve. Ky është projekt i Ministrisë së Arsimit, siç edhe është i informuar opinioni, dhe në bazë të informacioneve të tyre flas edhe unë sepse projekti është i përbashkët. Kuptohet, Ministria e Arsimit investon, ne përfitojmë.

PAQJA: Çfarë investime do të bëhen brenda për brenda dhomave?

Fatmir Sfishta: Dhoma do t'i ketë shtretërit e vet, vitrinën, karriget, tav-

Fatmir Sfishta



olinën, frigoriferin dhe pajisjet që janë të domosdoshme për çdo student dhe mendoj që këto pajisje dhe ky inventar do të jenë komod dhe do të jetë më i mirë sesa stilet më të vjetra.

Në konviktin e ri edhe 400 studentë më shumë

PAQJA: Sa ua lehtëson punën hyrja në fuqi e këtij objekti për rrethimin e studentëve?

Fatmir Sfishta: Lehtësimi do të jetë shumë i madh, duke i pasur parasysh kërkesat që kam pas unë si drejtor dhe i gjithë stafi i strehimit dhe, në përgjithësi, stafi i studentëve për akomodim. Pra rreth 400 vende, katërqind e më shumë vende nuk janë pak dhe mendoj që edhe një numër i madh i studentëve, të cilët kanë mbetur pa u akomoduar, do të futen këtu dhe ky është një lajm i mirë për studentët.

PAQJA: Në bazë të regjistrimit që keni bërë për këtë vit akademik, sa studentë kanë mbetur jashtë konvikteve dhe a do të arrijë ky konvikt t'i përfshijë të gjithë ata?

Fatmir Sfishta: Jo, fatkeqësisht jo. Kanë mbetur thuajse gjysma e strehimkërkuesve, rreth 2500 studentë, të cilët

kanë aplikuar dhe nuk i kanë plotësuar kriteret që të pranohen dhe fatkeqësisht nuk do të mund t'i sistemojmë të gjithë këta studentë, mirëpo do t'i sistemojmë mbi 400 studentë të cilët do t'i arrijnë pikët dhe do t'i plotësojnë kriteret më shumë se të tjerët.

PAQJA: Kur do të shpallet konkursi për strehim në këtë konvikt?

Fatmir Sfishta: Mendoj se rreth datës 20 nëntor do të shpallet konkursi për pranimin e studentëve për këtë konvikt. Do të jetë një konkurs i shkurtër, 3 deri në 5 ditë, në mënyrë që të arrijmë ta bëjmë vlerësimin e atyre aplikacioneve dhe t'i vendosim studentët menjëherë.

PAQJA: Çka do të ketë risi ky konvikt për dallim prej konvikteve të tjera në Qendër të Studentëve?

Fatmir Sfishta: Risi do të jetë se konvikti është modern, është ndërtuar i ri, do të ketë më shumë hapësira përcjellese se sa konviktet e tjera si biblioteka, ose sallë televizori, sallë interneti. Këto ndoshta të gjitha nuk do të përfundojnë menjëherë, por gradualisht. Gjatë këtij viti kalendarik, të gjithë këtë hapësirë do ta fusim në funksion të studentëve.

PAQJA: Si e kemi gjendjen në të gjithë Qendrën e Studentëve në Prishtinë?

Fatmir Sfishta: Fatmirësisht gjendja është e mirë. Kjo edhe falë menaxhimit të mirë të buxhetit që kemi pasur, sepse kemi kursyer, kemi investuar aty ku duhet, kemi investuar edhe në mensën e studentëve, gjë që është reflektuar shumë pozitivisht nga ana e studentëve sepse numri i abonentëve është shtuar këtë vit shumë më shumë se që ka qenë në vitet e kaluara dhe ky është një tregues i fortë që kemi bërë një planifikim të mirë në qendrën e studentëve me ato të holla që i kemi pasur.

Zgjerimi i Qendrës së Studentëve tek Fakulteti Teknik

PAQJA: A ka Qendra e Studentëve në plan zgjerimin e hapësirave në mensën e studentëve, meqë numri i konvikteve, e bashkë me të edhe i studentëve, po rritet?

Fatmir Sfishta: Për informimin e lexuesve edhe të studentëve, mensa e Qendrës së Studentëve ofron kapacitet shumë më të madh se sa që kanë konviktet, sepse ne, në mensën e studentëve, ushqejmë edhe studentë që nuk janë banorë të Qendrës së Studentëve, por që janë studentë të rregullt. Kështu që, mensa e studentëve ofron kapacitet edhe më të madh se sa ka studentë, deri në 9 mijë shujta në ditë mund të shtrohen në

mensën e QS-së. Pra, kapaciteti i mensës është i mjaftueshëm për këta studentë. Unë mendoj që ne, ose Ministria e Arsimit, Qeveria e Kosovës, të sigurojë fonde për ndërtime të tjera të konvikteve. Kur të ndërtohet ndonjë konvikt i ri te Fakulteti Teknik, atëherë duhet të hyjë në funksion edhe mensa e re atje, që është në pronësi tonën e që tash për tash është pjesë e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

PAQJA: A keni ndonjë plan për atë pjesë të Qendrës së Studentëve?

Fatmir Sfishta: Në afat të mesëm e kemi në plan, por krejt kjo varet prej fondeve sepse kërkesa kemi dhe arsyeja është, sepse ka mungesë të vendeve për studentë.

PAQJA: Cili është planifikimi për atë pjesë?

Fatmir Sfishta: Mendoj që në atë hapësirë, ku gjenden dy hektarë, të ndërtojmë edhe dy konvikte në një të ardhme dhe ta funksionalizojmë mensën, e cila është. Konviktet do të ndërtohen varësisht prej planit urbanistik që na lejon Komuna, bëhet fjalë për lartësinë e tyre etj. Kërkesa jonë për këtë projekt është e vazhdueshme, është gjithmonë në tavolinë, por duhet t'i kemi parasysh edhe rrethanat në të cilat është buxheti i Kosovës.

PAQJA: Çfarë investime objektive janë bërë për këtë vit në objektet e konvikteve në QS?

Fatmir Sfishta: Sivjet vlera e këtyre investimeve ka qenë rreth 400 mijë euro. Krejt këto investime janë bërë me fondin e Qendrës së Studentëve, me paratë e Qendrës së Studentëve, pra studentëve rrjedhimisht. Së pari është bërë termo izolimi dhe fasada e konviktit numër 3, i cili ka pasur shumë nevojë për një gjë të tillë dhe tash ai ka një temperaturë shumë më stabile, pastaj janë vendosur panelet solare në konviktin numër 3, panele të cilat do ta zbusin nevojën për ujë të ngrohtë në masë shumë të kënaqshme. Pastaj është bërë edhe gëlqerosja e brendshme e konviktit 5, konviktit më të madh të Qendrës së Studentëve dhe konviktit 4. Gjithashtu është bërë investim edhe në oborr, për shtrimin e pllakave dhe rregullimin e ambientit, si dhe është bërë një investim i nevojshëm në mensën e studentëve, investim i cili ka ndikuar që edhe pamja e mezes edhe higjiena e saj të jenë më të mira, kurse investimet e tjera kanë qenë ato të përditshmet, si dezinfektimi etj. Mendoj që këto investime do të ndikojnë që jeta e studentit në Qendrën e Studentëve të jetë më e mirë. ■





Ligji për Duhanin nuk respektohet as në institucionet shëndetësore

KONSUMIMI I DUHANIT NË QKUK PO DËMTON PACIENTËT

Qendra Klinike Universitare e Kosovës, përveç problemeve të shumta dhe të natyrave të ndryshme, po përballet edhe me një problem shtesë, atë të pirjes së duhanit nëpër klinika. Pirja e duhanit rrezikon seriozisht shëndetin e pacientëve të shtrirë në ato klinika. Ky është fakt shqetësues kur kemi parasysh se ata pacientë janë të operuar ose kanë ndonjë sëmundje tjetër, që d.m.th kanë imunitet të dobët. Përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë, por edhe të QKUK-së, thonë se ky është një problem shqetësues dhe se do të merren masa për parandalimin e kësaj dukurie

Besnik BOLETINI

Ligji për ndalimin e konsumimit të duhanit, përveç që nuk po respektohet dhe as nuk po përfilllet në vende publike, nuk po respektohet as në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, qendër kjo që ofron shërbime shëndetësore. Ty hysh në disa nga klinikat e QKUK-së është si të hysh në odë të burrave. Shumë njerëz, në të shumtën e rasteve shoqëruar të pacientëve, konsumojnë duhan nëpër korridorët e klinikave të QKUK-së, e nganjëherë edhe nëpër dhoma duke rrezikuar shëndetin e pacientëve edhe ashtu të sëmurë.

Ministria e Shëndetësisë dhe QKUK-ja kanë marrë masa për ndalimin e konsumimit të duhanit nëpër klinika, por aktualisht pak janë duke u përfillur këto masa,

të cilat ndoshta duhet të jenë më strikte.

Zëdhënësi i QKUK-së, Shpend Fazliu, ka thënë për revistën "Paqja" se drejtuesit e QKUK-së kanë marrë masa që të respektohet Ligji për Duhanin dhe se kanë informuar stafin për masat sanksionuese nëse e shkelin ligjin. Ai thotë se në kuadër të QKUK-së, ekziston një komision i cili merret me vlerësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, i cili po ashtu, monitoron edhe këtë çështje. Sipas tij, deri tani janë monitoruar shumë klinika dhe komisioni ka dhënë vërejtje dhe sugjerimet e tij. "Bazuar në Ligjin për Ndalimin e Pirjes së Duhanit në vendet publike, drejtuesit e QKUK-së, muaj më parë, kanë lëshuar një urdhëresë, e cila është vendosur në të gjitha repartet, klinikat, shërbimet dhe administratën e QKUK-së, ku punëtorët janë

informuar se ndalohet pirja e duhanit në vendet publike. Pra, të gjithë punëtorët e QKUK-së, janë të obliguar të respektojnë këtë urdhëresë, në të kundërtën dërgohen në Komision Disiplinor dhe merren masa sanksionuese ndaj tyre. Po ashtu, përgjegjësia bie edhe mbi drejtorët dhe shefat e reparteve, nëse nuk i lajmërojnë rastet e duhanpirjes", - tha Fazliu, duke shtuar se komisioni për vlerësimin e cilësisë së shërbimeve ka dhënë disa vërejtje në këtë drejtim. Lëndët kanë shkuar në komisionin disiplinor dhe janë në procedurë e sipër.

Shoqëruarit e pacientëve nuk përfillin masat

Fazliu theksoi se problemi kryesor është te të afërmit e pacientëve, të cilët nuk e respektojnë fare këtë urdhëresë

dhe shenjat që ndalojnë duhanin. “Problemin më të madh në këtë drejtim e kemi me palët ose familjarët që vijnë të vizitojnë të afërmit e tyre, të cilët shpeshherë tregohen të papërgjegjshëm dhe konsumojnë duhan, edhe pse shohin shenjat që informojnë për ndalesat. Punëtorët e sigurimit kanë njoftuar disa herë se kanë ndaluar palë që kanë zënë duke pirë duhan. Apelojmë te vizitorët dhe pacientët e shtrirë, por edhe te stafi i punëtorëve t’i përmbahen kësaj urdhërese, meqë respektimi i saj është në të mirë të tyre”, - shtoi Fazliu.

Ndërsa, Drejtori i Departamentit për Informim në Ministrinë e Shëndetësisë, Faik Hoti, ka thënë se kjo ministri ka marrë masa që duhani të mos konsumohet në ambientet ku ofrohen shërbime shëndetësore. Ai tha se kjo dukuri devijante është e pranishme edhe në QKUK, sidomos nga personat që i shoqërojnë pacientët. “Përkundër faktit se është në fuqi Ligji për Duhanin dhe deri tash Inspektorati Sanitar ka dhënë rreth 3.000 urdhëresa të ndryshme si paralajmërim i dënimeve për pirjen e duhanit në vende publike, Ligji nuk po gjen mbështetjen e nevojshme dhe nuk po zbatohet në masën e nevojshme. Edhe inspektorët shëndetësorë kanë shqiptuar disa dënime për individë dhe subjekte të ndryshme për shkeljen e ligjit të duhanit, por prapëseprapë, ligji po nëpërkëmbet. Në QKUK, fat-

keqësisht, përkundër paralajmërimeve të menaxhmentit se do të dënohen me heqje të 5 për qind të pagës, ata punonjës që gjenden duke pirë duhan, ka shumë raste që e vërtetojnë se ligji nuk po zbatohet”, - tha Hoti.

Ai shtoi se në IKSHP ky ligj zbatohet shumë mirë, gjithashtu edhe në MSH, ku nuk pihet duhan ndërsa, sipas tij, gjashtë drejtorë të departamenteve janë ndëshkuar me heqje automatike të 5 përqindëshit në pagë nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm, për shkak se në një moment e kanë shkelur këtë ligj.

“Me gjithë nivelin jo adekuat të zbatimit të Ligjit për Duhanin, institucionet nuk do të rrinë duarkryq para kësaj dukurie dhe tashmë është krijuar një grup brenda MSH-së, i cili do të bashkëpunojë edhe me aleatët e “Koalicionit antiduhan” që është nënshkruar kohë më parë midis institucioneve dhe shoqërisë civile, OBSH-së, e UNICEF-it, që të përgatis Koncept dokumentin, për ndryshimin e këtij ligji më 2012, ashtu që në të ardhmen të mos jetë ndarja e hapësirave në lokale 70/30 (70 për qind hapësirë pa duhan dhe 30 për qind hapësirë ku mund të pihet duhani nën kushtet e një ventilimi të mirë dhe kushtet e tjera), por që me Ligjin e ri të Duhanit që pritet të nxirret pas ndryshimeve më 2012, duhani të ndalohet 100 për qind në hapësirat publike”, - u shpreh Hoti.

As sigurimi s’mund t’i ndalë

Ndalimi i pirjes së duhanit në QKUK është i komplikuar për faktin se personat që shoqërojnë të sëmurët në gjendje të rëndë janë të stresuar për fatin e tyre, ndërsa konsumojnë duhanin në ambiente të QKUK-së, fatkeqësisht shpesh edhe afër sallave ku kryhen operacionet.

Edhe pse në të gjitha klinikat e QKUK-së ka pjesëtarë të sigurimit, as ata përkundër tendencave të vazhdueshme nuk mund t’i parandalojnë personat që pinë duhan në klinika.

Një anëtar i sigurimit ka thënë në kushte anonimiteti për revistën “Paqja”, se ka pasur raste kur nuk ka mundur që t’i ndalojë personat të pinë duhan. “Ka shpesh raste kur familjarë të pacientëve vijnë në klinika të nervozuar dhe komunikimi me ta është shumë i vështirë, pasi që ata pinë duhan brenda në objekt edhe si pasojë e asaj nervoze dhe është shumë e vështirë t’ia ndalojmë sepse nuk binden dhe ka raste kur edhe janë të ashpër. Ka raste kur një operacion zgjat shumë dhe ata qëndrojnë ashtu duke pritur, por edhe duke pirë duhan”, - shtoi ai.

Tymi i duhanit ndikon negativisht te pacientët e shtrirë në klinikat e QKUK-së, pasi që një pjesë e tyre janë të sapo operuar ose të tjerë që për shkak të sëmundjes e kanë imunitetin më të dobët. Prandaj duke marrë parasysh këtë fakt duhet që të merren masa më të rrepta dhe të mos lejohet pirja e duhanit nëpër klinika. ■





Deputetja e Parlamentit Evropian, Doris Pack,
ka vizituar Degën e Gazetarisë së Universitetit të Prishtinës

BE-JA MBËSHTET REPUBLIKËN E KOSOVËS NË RRUGËN E SAJ TË INTEGRIMIT

“Dëshiroj të cek diçka që është në dorën tonë. BE-ja duhet të punojë me pesë shtetet që akoma nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Këto shtete janë lidere dhe duhet ta kuptojnë se rasti i Kosovës është rast sui generis dhe nuk i shërben askujt për një rast të ngjashëm, pra nuk mund t’i shërbejë as Rumanisë e as Spanjës ose vendeve të tjera që kanë raste të ngjashme. Kjo detyrë urgjente qëndron mbi bareshën Eshton, sepse ajo duhet ta kuptojë nevojën për të pasur një unitet brenda qasjes së vetë të BE-së dhe kjo do të lehtësonte që edhe vetë serbët të kenë një qasje më realiste”, - ka thënë deputetja e Parlamentit Evropian, Doris Pack

Muhamet JAHIRI

Deputetja e Parlamentit Evropian, Doris Pack, ka thënë se BE-ja do ta mbështesë Kosovën në përpjekjen e saj të perspektivës evropiane dhe në çështjen e liberalizimit të vizave. Këto deklarata deputetja Pack i bëri në Prishtinë, gjatë një ligjërata të mbajtur para studentëve të Degës së Gazetarisë së Universitetit të Prishtinës (UP), të organizuar nga Instituti i Medies. “Bashkimi Evropian sigurisht që do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën në përpjekjet e saj që ta përmbushë perspektivën evropiane dhe këtu dua ta cek edhe çështjen e lëvizjes së lirë, pra çështjen e vizave. Unë e di se është shumë e vështirë që ju nuk mundeni t’i vizitoni familjarët, miqtë tuaj ose thjesht të dilni ta shihni Evropën dhe ky drejtim mund të them se është turp nga ana jonë, pra turpi është i yni”, - ka thënë Pack.

Ajo, para studentëve të gazetarisë, ka deklaruar se deri në heqjen e vizave për Kosovën do të rregullohet edhe çështja e kufijve, ndërsa ka thënë se edhe qytetarët e pjesës veriore të Mitrovicës mund të përfshihen në këtë proces. “Nëse qytetarët e pjesës veriore dëshirojnë të përfshihen në çështjen e liberalizimit, ata mund ta bëjnë vetë. Kështu që deri sa të arrihet çështja e heqjes së vizave edhe çështja e kufijve do të rregullohet

po ashtu. Unë shpresoj që edhe komuniteti evropian do të ketë një përgjigje aq të fuqishme sa është e nevojshme”, - është shprehur deputetja Pack.

Eurodeputetja, ndër të tjerash, ka thënë se është në dorë të BE-së që të punojë me pesë shtetet që nuk e kanë njohur Pavarësinë e Kosovës. Ajo ka porositur që këto vende ta kuptojnë se rasti i Kosovës është sui-generis dhe nuk i shërben askujt për një rast të ngjashëm. “Dëshiroj të cek diçka që është në dorën tonë. BE-ja duhet të punoj me pesë shtetet që akoma nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Këto shtete janë lidere dhe duhet ta kuptojnë se rasti i Kosovës është rast sui generis dhe nuk i shërben askujt për një rast të ngjashëm, pra nuk mund t’i shërbejë as Rumanisë e as Spanjës ose vendeve të tjera që kanë raste të ngjashme. Kjo detyrë urgjente qëndron mbi bareshën Eshton, sepse ajo duhet ta kuptojë nevojën për të pasur një unitet brenda qasjes së vetë të BE-së dhe kjo do të lehtësonte që edhe vetë serbët të kenë një qasje më realiste”, - ka thënë Pack.

E pyetur se a mund të ketë Ahtisari plus në veri të Mitrovicës, deputetja Pack është përgjigjur: “Nuk e di se çka është Ahtisari Plus, ne kemi planin Ahtisari, i cili funksionon shumë mirë në jug të Mitrovicës dhe nëse ka ndonjë plan tjetër mund të bëhet në pjesën veriore

dhe mund të funksionojë mirë, andaj ne nuk kemi nevojë për Ahtisari plus a minus ose çka do të jetë ai”.

Ndër të tjerash Pack ka thënë se në Kosovë janë bërë mjaft reforma, por sipas saj këto reforma nevojiten të bëhen në të gjitha nivelet. “Janë bërë mjaft reforma, por akoma nevojiten edhe më shumë në të gjitha nivelet. Edhe korrupsioni duhet të luftohet sepse është një sëmundje e keqe, pra si një lloj kanceri që përhapet shpejt. Pra është i domosdoshëm luftimi i korrupsionit në të gjitha nivelet dhe unë, në fakt, do ju inkurajoja juve si studentë, por edhe politikanët e profesorët, që ta luftoni korrupsionin në çdo nivel, sepse korrupsioni në të gjitha nivelet tregon mosrespekt për tjerët”, - është shprehur Pack.

Deputetja e PE-së i ka inkurajuar studentët që të punojnë dhe të kenë mësim sa më cilësor sepse, sipas saj, e ardhmja e Kosovës i takon brezit të të rinjve. Sipas saj, të rinjtë e Kosovës janë ata të cilët duhet të punojnë që ta përgatisin vendin dhe të bëhen gati drejt familjes së madhe evropiane.

Deputetja Pack, para ligjëratarës, është prituri edhe nga Shefi i Degës së Gazetarisë, profesor Milazim Krasniqi, i cili e ka njoftuar atë për punën në Degën e Gazetarisë, si dhe është takuar edhe me profesorët e tjerë të këtij departamenti. ■

Në Gjykatat e Kosovës numri i lëndëve të pazgjidhura arrin në 244 mijë sosh

Rritet numri i lëndëve të pazgjidhura

“Gjyqtarët e Kosovës e kanë kaluar normën për zgjidhje të disa lëndëve. Por edhe përkundër kësaj, numri i lëndëve ka ardhur duke u rritur. Është viti i dytë ku ne na mungojnë 123 gjyqtarë dhe janë diku 224 mijë lëndë të pazgjidhura”, - ka thënë Hasani, duke shtuar se ky është një problem i madh i Drejtësisë së Kosovës

Edona MAGASHI

Sistemi i drejtësisë në Kosovë vazhdon të mbetet sfidë e madhe për institucionet e vendit. Përveç kritikave nga raportet ndërkombëtare dhe vendore që drejtësia në Kosovë vazhdon të jetë ndër institucionet më të korrupsuara, një ballafaqim tjetër është edhe numri i madh i lëndëve të pazgjidhura nëpër gjykata.

Këtë e ka pranuar, për revistën “Paqja”, edhe kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, Fejzullah Hasani, i cili ka thënë se shifra e lëndëve të pazgjidhura arrin deri në 224 mijë sosh.

“Gjyqtarët e Kosovës e kanë kaluar normën për zgjidhje të disa lëndëve. Por edhe përkundër kësaj, numri i lëndëve ka ardhur duke u rritur. Është viti i dytë ku ne na mungojnë 123 gjyqtarë dhe janë diku 224 mijë lëndë të pazgjidhura”, - ka thënë Hasani, duke shtuar se ky është një problem i madh i Drejtësisë së Kosovës.

Hasani ka thënë se deri në fund të vitit do të plotësohet numri i 123 gjyqtarëve dhe, sipas tij, ky do të jetë një përfundim i mirë për zvogëlimin e lëndëve nëpër gjykatat e Kosovës.

“Tani janë duke i intervistuar gjyqtarët e Gjykatës së Qarkut dhe planifikohet që deri në fund të këtij viti të plotësohet numri prej 123 gjyqtarëve, në të gjitha nivelet e Kosovës. Shpresoj se me përfundimin e emërimit të gjy-



Fejzullah Hasani

qtarëve të rinj, numri i lëndëve do të ulet në masë të konsiderueshme”, - ka deklaruar Hasani.

Edhe kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Enver Peci, fajin për grumbullim e lëndëve dhe moszgjidhjen e tyre e ka hedhur te mungesa e kuadrove.

“Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka adresuar probleme më të mëdha, se çka e përbën numrin më të madh të lëndëve. Ju e dini që pjesën më të madhe e kemi me lëndët në ekzekutim ose përmbarim. Ne kemi një program dyvjeçar, në të cilin janë të angazhuar 30 referentë ekzekutues edhe ata veç i kanë arritur rezultatet e para në identifikimin e problemeve”, - ka thënë Peci.

Ai ka treguar se Këshilli Gjyqësor i Kosovës për zvogëlimin e lëndëve të pazgjedhura nëpër gjykata ka aprovuar një strategji të re. Kjo strategji, sipas Pecit, ka zvogëluar për 11 për qind të lëndëve në tremujorin e parë të zbatimit të saj.

Përfaqësuesit e sistemit të drejtësisë në Kosovë, përveç numrit të madh të lëndëve të pazgjidhura, kanë bërë të ditur edhe probleme të tjera me të cilat ballafaqohet ky institucion si: mungesa e hapësirave të mjaftueshme në gjykata, por edhe mbyllja e gjykatave në veri të Kosovës, të cilat disa ditë pas shpalljes së pavarësisë, në muajin shkurt të vitit 2008, ishin uzurpuar nga protestues serbë. ■





I DUAM EDHE PSE NA URREJNË!

Amel ILMIU

Dikur në Kosovë, sot edhe në Shqipëri, por asnjëherë në Serbi. Dhe pikërisht ky fakt është paradoksi ynë kombëtar. Sa herë që bëhet fjalë për raportin tonë me serbët, ne gjithnjë jemi inferiorë, edhe atë për fajin tonë. Para viteve të '90, por edhe më vonë, mund të dëgjoje këngë serbe në kafenetë shqiptare të Kosovës, madje edhe të gruas së kriminelit më të madh serb. Sot njëmbëdhjetë vjet pas luftës me serbët, kjo ndodh në Shqipëri, në bar-kafe e lokale të ndryshme. Turistët shqiptarë që vijnë ta vizitojnë vendin e

ëndrrave mund të mbesin gojëhapur, por pa guxuar të bëzajnë. Dhe kjo nuk ndodh veç lokaleve, në pushimoret e ndryshme bregdetare, por ndodh madje në pikë të Tiranës, edhe atë në panairin e 14-të të librit. Kjo për shqiptarët jashtë kufirit të Shqipërisë mund të jetë kuriozitet, por në Tiranë kjo ishte diçka normale dhe nuk zgjonte kurrfarë neverie. Stenda, restorante dhe kafene të improvizuara nga Serbia, prisnin vizitorët dhe lexuesit e panairit, përfshirë këtu edhe shkrimtarët. Të gjithë shijonin rakinë serbe, tingujt e muzikës serbe dhe qebapin e suxhukun serb. Edhe shërbimi bëhej në serbisht.

“Asgjë tragjike”, - do të thoshte dikush.

- Mirëpo, le të provojë ndonjë shqiptar të bëjë të njëjtën gjë në panairin e Beogradit dhe do ta shohë se sa tragjike do të jetë. Nëse dikujt kjo që po e themi i duket ksenofobi, atëherë edhe neve skenat e tilla na duken snobizëm.

Evropianistët modernë do të përpiqeshin të na bindnin se ne duhet të tregojmë kulturë të lartë qytetare, por nëse kjo qenka kështu, atëherë një 'logjikë e njëjtë shpie edhe në abandonimin e reciprocitetit edhe në Veri të Kosovës'. Ishin po serbët ata që i shqyen pikturat një piktoreje shqiptare gjatë një



ekspozite ballkanike në Beograd. Pastaj po këta serbë, na vijnë lirshëm në mes të Tiranës na servojnë pije, ngrënie e muzikë të tyre pa ferrë në këmbë.

Ka edhe më keq.

Fshatrat serbe e maqedonase janë mbushur me nuse shqiptare nga Shqipëria. Nipër e mbesa melez serbo-shqiptar nesër nuk do të dinë çfarë të shprehën për veten e tyre. Ata po lindin në një periudhë të urrejtjes së natyrshme, pas masakrave dhe krimeve të papara morbide që kanë bërë 'baballarët e tyre mbi dajallarët e tyre'.

Patriotizmi i rremë i shqiptarëve që rrahin gjoks nëpër tribuna, debate e fjalime politike, është si flluskë sapuni. Ai vjen në shprehje veç sa për propagandë e marketing politik. Aleanca e Kuqezinjve, një formacion i ri politik që shtiret për hiperpatriotizëm nuk bën as-

një deklaram për këto procese, e të mos flasim për partitë e tjera, të cilat e kanë dëshmuar veten në skenën politike shqiptare se për çfarë ekzistojnë.

Shtrohet pyetja: 'Pse...?!'

Dhe nuk është vetëm një pse. Ka plot. Pse i duam ata që na urrejnë? Ata na burgosën, na helmuan, na plaçkitën, na dhunuan, na vranë e bënë çmos mbi ne, kurse ne akoma i duam dhe flasim me nostalgji për ta, sikur jeta jonë të varej prej tyre. Pse i mbushim tregjet tona me mallrat e tyre, bëjmë biznese të fëlliqura e të pista dhe ua mbushim arkën e shtetit me paratë tona?

Deri kur kështu?! A nuk jemi ne ata që mezi presim që Serbia ta gjejë ndonjë vegël të vetën për të lansuar akuza të pabaza mbi ndonjë lider tonin të luftës, për të bërë pastaj qindra komente se si ai lider vërtet na qenka

matrapaz, hajn, idiot, se si u dashka të linçohet etj. etj.

Kur do të mbledhim mend?! Që ta çmojmë vlerën e njerëzve tanë, t'ua pranojmë meritat, t'ua themi të metat pa hiperbolizime, por që në të njëjtën kohë t'i kuptojmë kurthet dhe dredhitë e atyre që me shekuj e dëshmuar se nuk na duan, ta kuptojmë se dëshira e tyre është të na shohin vetëm si është më keq, andaj të mos shkojmë sipas qejfit të tyre. Pse bëhemi mashë e tyre?

Nuk është fjala për mbjellje të urrejtjes, as për revansh, as për ksenofobi, për është fjala se duhet të kthjellemi, ngase gjithçka po na shkon turbullt. Na janë mjegulluar sytë, veshët, kokat, zemrat, shpirtrat. Përpara nesh kemi një plojë të madhe që duhet të na e heqë këtë perde që po na pamundëson ta shohim, ta ndiejmë dhe ta kuptojmë realitetin. Ftesa për një qëndrim më racional ndaj serbëve nuk është thirrje për të rënë në nivelin e tyre, por është trokitje në lëkurën e çdo shqiptari për ta ndjerë sadopak peshën e vuajtjeve që po rëndon sot e kësaj dite nga nënat tona, nga familjet e të vrarëve, të dhunuarave, të zhdukurve etj. Është kjo thirrje që i bëhet arsyes për të qenë më pranë tonit, më solidar me dhimbjen e atij që i është shkaktuar ajo me pa të drejtë, më altruist ndaj atij që rënkton.

Pranimi i pozicionit inferior ndaj atyre që na urrejnë na bën gjithmonë të ulët në sytë e tyre, na robëron dhe na pengon të arrijmë atë që dëshirojmë në raport me ta. ■



Intervistë me presidenten e Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga

S'ka Ahtisaari Plus, e as autonomi për veriun

Intervistoi: Muhamet JAHIRI

Presidentja e Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga, ka thënë se institucionet e Kosovës nuk do të pranojnë që të ndryshohet plani i Ahtisaarit për Kosovën, e as të diskutohet për sovranitetin dhe integritetin territorial të vendit.

Sipas saj, nuk do të ketë as 'Ahtisaari Plus', e as autonomi për pjesën veriore të vendit, mirëpo edhe në atë pjesë do të ketë vetëm sundim të ligjit si në çdo pjesë tjetër të vendit. "Nuk ka 'Ahtisaari Plus', ose autonomi të veçantë për tri komunat veriore të Kosovës, nuk ka ndarje të territorit të Kosovës, nuk ka ndarje të territorit të Serbisë, nuk ka shkëmbim terrioresh dhe nuk ka as zhvendosje të popullsisë. Të gjitha këto zgjidhje janë të tejkaluara dhe në të kaluarën idetë e tilla u kanë sjellë shumë dhimbje dhe vuajtje popujve të këtij rajoni", - ka thënë Jahjaga.

Presidentja Jahjaga ka theksuar se barrikadat e vendosura në pjesën veriore të Mitrovicës nga ana e serbëve dhe bllokimi i lëvizjes së lirë të qytetarëve janë të papranueshme dhe joligjore. "Gjithsesi, barrikadat janë veprime kundërligjore që pengojnë qarkullimin e lirë të njerëzve dhe të mallrave dhe që krijojnë gjendjen e anarkisë dhe të tensionit", - është shprehur e para e vendit.

Jahjaga ndër të tjera ka shtuar se të gjitha çështjet mes Republikës së Kosovës dhe të Serbisë duhet të zgjidhen nëpërmjet dialogut si dy vende fqinje, të cilat kanë synimin dhe qëllimin e integriteteve në strukturat e Bashkimit Evropian. "Si dy shtete sovraane dhe të pavarura, edhe Kosova edhe Serbia kanë nevojë që të zhvillojnë dialog dhe të arrijnë të gjitha ato marrëveshje për rregullimin e marrëdhënieve bilaterale, por edhe multilaterale që i bëjnë shtetet ndërmjet vete", - ka theksuar Jahjaga.

Presidentja ka folur edhe për lobimin dhe për vizitat e shumta që po i zhvillon jashtë vendit. Ajo ka thënë se Kosovës i është përmirësuar dukshëm imazhi në botë dhe pritet që të ketë njohje të reja në ditët në vijim.

Atifete Jahjaga



"PAQJA": Znj. Jahjaga keni pasur shumë vizita jashtë vendit. Cili ka qenë qëllimi i këtyre vizitave?

Jahjaga: Paraqitja e vizionit për shtetin e Kosovës si faktor paqeje dhe stabiliteti, paraqitja e të arriturave në shtet-ndërtimin dhe në proceset demokratike, në sundimin e rendit dhe të ligjit dhe në konceptin qytetar të ndërtimit të shoqërisë sonë, me të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët, pa asnjë dallim. Të gjitha vizitat janë bërë me ftesë dhe kanë për qëllim njohjen me vizionin e ri të Kosovës, gjithashtu edhe me përparimin e marrëdhënieve bilaterale, inicimin e marrëdhënieve të ndryshme sektoriale, në përkrahjen që vendet dhe institucionet që i kam vizituar do t'i japin

në të ardhmen Kosovës, si në bashkëpunimin ekonomik po ashtu edhe në ndihmën për njohje të reja për shtetin e Kosovës dhe për anëtarësimin e Kosovës në organizatat e forumet ndërkombëtare. Çdo kund në fokus ka qenë synimi euro-atlantik i Republikës së Kosovës, anëtarësimi në BE dhe në NATO, dhe gjithsesi pranimi i Kosovës në OKB. Vizitat janë përcjellë edhe me takimet me miqtë e Kosovës, me njerëzit me ndikim në shtete përkatëse dhe arenën ndërkombëtare, që kanë punuar dhe punojnë në çështjen e Kosovës dhe janë shoqëruar, gjithashtu, edhe me ligjërata në Universitete ose institucione të ndryshme si dhe me intervista në media.

“PAQJA”: *Sa kanë ndikuar këto vizita në përmirësimin e imazhit të Kosovës në arenën ndërkombëtare?*

Jahjaga: Të gjitha institucionet e Kosovës, edhe Qeveria edhe Ministria e Jashtme, jemi të koordinuar dhe të them, kemi një lloj strategjie parimore në paraqitjet jashtë vendit. Presidentja shihet dhe është figurë e unitetit në Kosovë dhe ka mandatin kushtetues që ta përfaqësojë Republikën e Kosovës, brenda dhe jashtë shtetit. Në secilin vend jam pritur me të gjitha respektet dhe ceremonitë që i bëhen Presidentes së një vendi dhe çdo kund kemi avancuar marrëdhëniet e deritashme dhe jemi marrëvesh për përparimin e mëtejme dhe për koordinim të veprimeve në të ardhmen.

“PAQJA”: *Ju kemi parë se gjatë Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së keni qenë shumë aktive, duke u takuar me udhëheqës të shteteve të fuqishme. Keni marrë ndonjë premtim për njohje të reja?*

Jahjaga: Po kemi marrë premtime nga të gjithë ata me të cilët kemi biseduar, sepse kemi pasur dakordim të plotë se procesi i pavarësisë së Kosovës është procesi i pakthyeshem, se ka krijuar paqe dhe stabilitet në rajon dhe se nuk

ka alternativë tjetër, përveç që Kosova të pranohet në të gjitha organizatat dhe institucionet ndërkombëtare. Procesi i njohjeve është akt individual i secilit shtet, ndërsa Republika e Kosovës, nëpërmjet njohjeve dëshiron të fuqizohet në arenën ndërkombëtare, por edhe të zhvillojë marrëdhënie bilaterale me shtetet e caktuara. E dini se numri i njohjeve nuk ndikon që Kosova të jetë anëtare e OKB-së ose e BE-së, sepse procedurat e vendimmarrjes janë të përcaktuara. Mirëpo për ne njohjet kanë rëndësinë simbolike të ecjes përpara të proceseve dhe në këtë bazë shumë shpejt pritet që më shumë se gjysma e vendeve anëtare të OKB-së, ta njohin shtetin e Kosovës. Lobimi dhe politika e njohjeve është vetëm një segment i politikës së jashtme të Republikës së Kosovës, krahas marrëdhënieve diplomatike dhe marrëdhënieve ekonomiko-tregtare.

“PAQJA”: *Si jeni duke e parë dialogun teknik që është duke mbajtur në mes të Prishtinës dhe Beogradit?*

Jahjaga: I kam dhënë përkrahje dialogut sepse kjo jo që është mënyra më e mirë, por është rruga e vetme për zgjidhjen e çështjeve dhe problemeve

teknike dhe të tjera që ka Republika e Serbisë me Republikën e Kosovës dhe që në pjesën më të madhe është pasojë e luftës. Dialogu duhet të ketë sukses, sepse zgjidhjet që ofrohen janë zgjidhje evropiane nga praktikat dhe standardet më të larta të vendeve të BE-së. Dialogu si çdo herë është në interes të qytetarëve të të dyja vendeve sepse zgjidh çështjet që kanë të bëjnë me jetën dhe me punën e qytetarëve. Kosova dhe Serbia duhet t'i zhvillojnë marrëdhëniet si dy shtete fqinje dhe duhet që të bëjnë të gjitha marrëveshjet bilaterale ndërshtetërore, duke respektuar sovranitetin dhe integritetin territorial të secilit shtet. Edhe Kosova edhe Serbia të ardhmen e kanë në BE dhe në këtë rrugëtim duhet të ndihmojnë dhe jo të kundërshtojnë njëra-tjetrën.

“PAQJA”: *Znj. Jahjaga, që nga zgjedhja juaj në krye të shtetit, jeni akuzuar nga mediet se nuk jeni duke bashkëpunuar me to. Pse ky “izolim” mediatic?*

Jahjaga: Nuk ka izolim mediatic. Ndoshta perceptimi i medieve për rolin e Presidentes ka qenë i ndryshëm. Unë si Presidente e vendit punoj në bazë të Kushtetutës dhe Ligjit, jam faktor



unifikues dhe i shpreh qëndrimet e mia. Unë si qytetare kam mendim për secilën çështje mirëpo si Presidente kam obligimet e mia se si i drejtohem opinionit. Jemi të organizuar mirë në zyrën për informim dhe secili vizitor i ueb-faqes mund të bindet për aktivitetet dhe komunikimin me opinionin. Kam pasur për gjashtë muaj 10 vizita jashtë vendit: çdo kund kam pasur konferenca dhe intervista e gjithashtu kam dhënë intervista gati për të gjitha mediat e Kosovës. Në përgjithësi për këta muaj kam pasur më shumë se sa 60 adresime publikut.

“PAQJA”: *Tani ushtroni detyrën e Presidentes falë marrëveshjes politike në mes të PDK-së, LDK-së dhe AKR-së të ndërmjetësuar nga ambasadori Dell. Sipas kësaj marrëveshje, zgjedhjet presidenciale do të mbahen vitin e ardhshëm. A to t’i hyni kësaj gare?*

Jahjaga: Mandatin e kam në bazë të votimit në Kuvendin e Kosovës. Pa këtë votëbesim asnjë marrëveshje politike nuk do të më ulte në karrigen e Presidentes së vendit. Unë e kam mandatin aktual kushtetues dhe në kohën që caktohet data e zgjedhjeve dhe hapet



fushata zgjedhore atëherë unë kam të drejtë të deklarojem.

“PAQJA”: *Znj. Presidente pritet që në vitin e ardhshëm të kemi zgjedhje për presidentin sipas ligjit të ri. A keni menduar se si do të garoni për presidente, si e pavarur, apo keni menduar që të jeni kandidatë nga ndonjë parti e caktuar?*

Jahjaga: Në Kuvendin e Kosovës do të caktohet data e mbajtjes së zgjedhjeve të cilën më pastaj unë si Presidente e vendit duhet ta dekretoj. Unë jam faktor unikues. Gjatë gjithë mandatit do të sillem kështu dhe nuk do të ishte mirë që unë në të ardhmen të përcaktohem për diçka që është më pak se sa ky faktor uniteti. I kam dhe do t’i kem marrëdhëniet e mira korrekte dhe kushtetuese me të gjitha partitë dhe subjektet politike të Kosovës.

“PAQJA”: *A mendoni se duhet të ketë shtyrje për zgjedhjen e presidentit/es të*

ardhshëm, duke e respektuar me këtë rast edhe ligjin për presidentin/en që parasheh mandat pesëvjeçar?

Jahjaga: Çështja e zgjedhjeve dhe e ligjit nuk lidhet me mandatin tim dhe me përcaktimin tim personal. Unë kam vendosur të bëhem Presidente me përkrahjen e partive politike, me votimin në Kuvendin e Kosovës, duke krijuar kështu bazën e legjitimitetit. Nuk kam dhe as nuk kam pasur asnjë aspiratë tjetër.

“PAQJA”: *Sipas marrëveshjes së arritur mes tri subjekteve politike dhe ambasadorit të SHBA-së, Dell, kur parashihet të përfundojë mandati juaj në cilësinë e Presidentes. Ka ndonjë datë, apo parashihet që ky mandat të jetë sipas ligjeve të Kushtetutës?*

Jahjaga: Pyetja nuk ka të bëjë me Presidenten, por me Kuvendin dhe partitë politike. Unë respektoj legalitetin dhe legjitimitetin e secilit vendim. ■

Dy Evropat?! Kështu nuk shkon më...



Në Evropë tani ka shtete që duan të largohen prej eurozonës dhe Bashkimit Evropian dhe ka shtete që duan me çdo kusht të futen në eurozonë dhe Bashkimin Evropian. Presidenti francez, Nikola Sarkozy, ka shkaktuar depresion edhe më të thellë në këtë pikë neuralgjike, në momentet kur Greqia veçqë është zhytur në batakun e krizës së thellë, ndërsa e njëjta gjë ka gjasë ta pllakosë edhe Italinë dhe shtetet e tjera evropiane. Sarkozy u shpreh për një Evropë me dy shpejtësi të ndryshme: ajo "federale", e 17 vendeve anëtarëve të zonës euro dhe ajo "konfederate" e dhjetë vendeve jo në eurozonë. "Nuk mund të krijohet një monedhë e përbashkët pa konvergjenca ekonomike dhe integrim ekonomik. Është e pamundur. Por në të kundërt, nuk mund të mbrosh çështjen e federalizmit dhe, në të njëjtën kohë, të jesh në mbështetje të zgjerimit të Evropës. Është e pamundur. Këtu ka një kontradiktë. Ne jemi 27 vende. Është e qartë që ne na duhet të hapim dyert për Ballkanin dhe të bëhemi 32, 33 ose 34 vende. Por, mendoj se askush nuk mendon se federalizmi - integrimi total - është i mundur të arrihet mes 33, 34, 35 vendeve. Pra, çfarë do të bëjmë? Si fillim, sinqerisht, krijimi i një monedhe të vetme është një ide e mrekullueshme, por është paksa e pakuptimtë të krijosh një të tillë, pa pyetur më parë veten mbi çështjen e qeverisjes së saj, dhe pa pyetur veten mbi konvergjençën ekonomike. E thënë haptas, është mirë të kesh një vizion, por ka disa detaje që mungojnë: krijuam një monedhë të përbashkët, por nuk ndryshuam sistemet tona fiskale dhe ekonomike, të cilat jo vetëm që nuk konvergonin me njëra-tjetrën por madje kishin divergjenca. Dhe jo vetëm që krijuam një monedhë të përbashkët pa e konverguar, por edhe u munduam të ndryshonim rregullat e paktit. Kështu nuk mund të funksionojë më.

E kundërshton edhe kushërira



Edi Rama nuk ka tanimë probleme vetëm me njerëzit e partisë së tij, si Kastriot Islamin, Ben Blushin, Arben Malajn etj. Kundërshtare politike e tij është edhe kushërira e tij Erla Mëhilli, zëdhënësjja e kryeministrit të Shqipërisë, Sali Berisha. Ajo, në një intervistë të dhënë për "Gazeta Shqiptare", ka pohuar se e ka kushëri kreun e Partisë Socialiste, Edi Rama. Por lidhja e saj e gjakut me liderin e opozitës nuk e pengon ta cilësojë "një gënjeshtër të pacipë banal" përmendjen në librin e Ramës, "Kurban"-i, të një dialogu të zhvilluar mes saj dhe drejtorit të komunikimit të kreut të PS-së, Endri Fuga. Në këtë intervistë, Mëhilli thotë se atë çfarë ka shkruar Rama për të e mësoi nga të tjerët, ndërkohë që bën të ditur se nuk ka ndërmend ta blejë "Kurban"-in e Ramës, pavarësisht se shefi i saj, Berisha, i sugjeroi me humor që ta blinte librin e kushëririt.

A do ta sulmojë Izraeli Iranin?



Këto ditë, Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Bërthamore me qendër në Vjenë publikoi raportin e saj, në të cilin konfirmoi në mënyrë zyrtare për herë të parë se Irani është duke eksperimentuar me teknologjinë që shërben vetëm për një qëllim: ndërtimin e bombës bërthamore. Pas kësaj deklarate, për Izraelin ishte një moment ideal që të shkonte më tej në kërkesat e tij si politike, pra sanksionet, ashtu edhe ato ushtarake, për një sulm parandalues ndaj Iranit. Debatimi që

po vazhdon në Izrael për një sulm të mundshëm ndaj Iranit është më i hapur se kurrë më parë.

Mirëpo a është Izraeli duke përgatitur ndonjë sulm apo këto janë thjesht veprime që tentojnë të kenë efekt vetëm psikologjik? Apo mos vallë kjo është një mënyrë për t'i bërë presion botës, Europës dhe Shteteve të Bashkuara, veçanërisht që, nëse ata nuk do të ndërhyjnë, Izraeli është i gatshëm ta bëjë i vetëm ndërhyrjen?

Ish-shefi i Mossad-it, shefi i shërbimit sekret hebre, Meir Dagan, lëshoi një paralajmërim kundër sulmit izraelit ndaj Iranit. "Ne na duhet që të mendojmë të gjithë për një ditë më pas". Në mënyrë të vazhdueshme, ai nuk është lodhur duke e përsëritur se çdo sulm i Izraelit kundër Iranit do të kishte "pasoja katastrofike" për vetë Izraelin, me pasojë që do të kishin përmasa të paimagjinueshme.

Për një kohë të gjatë amerikanët kanë pasur frikë se Izraeli nuk do të mjaftohej me kërcënimet për sulm. Në pranverën e vitit 2008, Presidenti Bush bëri një vizitë të papritur në Izrael. Ai kërkoi që të takohej me kryeministrin e asaj kohe, Olmert dhe ministrin e mbrojtjes Barak. Asnjëri prej tyre nuk e dinte arsyen e takimit. Thuhet se Bush u kërkoi që të mos sulmonin Iranin. Një tjetër vizitë, këtë tetor, u bë nga Sekretari i Mbrojtjes, Panetta, i cili e bëri të qartë se ky nuk është opsion për Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo, për faktin se një hap i tillë mund të ketë pasojë të paparashikueshme me ndikime serioze në rajon dhe trupat amerikane të stacionuara atje. Mesazhi i fshehur i shefit të Pentagonit drejtuar qeverisë izraelite ishte i qartë: 'Izraeli nuk do të ketë ndihmën e SHBA-së në rast se planifikon të kryejë një sulm ushtarak kundër Iranit'.

Edhe Merkel pesimiste



Kancelarja gjermane, Merkel, është shprehur se Evropa mund të jetë duke përjetuar krizën e saj më të rëndë që pas Luftës së Dytë Botërore. Nga ana tjetër, liderët e Greqisë dhe Italisë kanë lënë qeveritë e tyre, që janë marrë aktualisht në dorë nga teknokratët me qëllimin e stabilizimit të situatës. "Evropa është në një nga momentet ndoshta më të vështira që pas Luftës së Dytë Botërore",

- deklaroi kancelarja Merkel, para partisë së saj në Lajpcig. Ajo shtoi se kishte frikë se Evropa do të dështonte nëse do të dështonte edhe monedha e përbashkët euro dhe se do të bënte gjithçka për ta ndaluar këtë. Gjatë takimit të saj, që ka zgjatur një orë, ajo nuk ka ofruar asnjë ide të re, ose mënyrë të re për zgjidhjen e këtij problemi të madh, që ka sjellë marrjen e paketave financiare ndihmëse nga Bashkimi Evropian dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar prej shumë vendeve. Sipas Merkelit, situata është shumë e rëndë dhe ka vënë në dyshim edhe vetë ekzistencën e Eurozonës dhe të monedhës së përbashkët. "Nëse euro dështon, dështon edhe Evropa dhe ne duhet që ta parandalojmë këtë gjë duke bërë gjithçka", - ka shtuar ajo.

Përgatiti: A. A.

Masakra në Medinë¹

Muhamed J. KAJOLLI

Kalifi Jezid e zëvendësoi Amër ibën Asin me Velid ibën Utbete ibën Ebi Sufjanin, i cili për të treguar se është ndryshe nga paraardhësi i tij ia sekuestroi tërë pasurinë dhe ia burgosi tërë stafin e shërbëtorëve të tij. Amrit nuk i mbeti rrugë tjetër veçse të intervenonte direkt tek kalifi. Pasi kalifi Jezid mësoi për situatën e krijuar atje, kërkoi nga Ubejdullahi (prefekti i Basrës dhe i Kufes) që t'i nxirrte nga burg, ndërsa prej Amrit kërkoi të jetë syhapur vazhdimisht ndaj Ibën Zubejrit, i cili pas vdekjes së Husejnit kishte përkrahje të madhe në Hixhaz. Jezidi kërkoi gjithashtu prej Amrit që të qëndronte në krah të prefektit të ri, mirëpo, Amri arriti që ta bindte Jezidin se as ai e as të tjerët që gravitojnë përreth tij, nuk janë në gjendje t'i qëndrojnë përballë Ibën Zubejrit.

Jezidi nga kjo bisedë kuptoi se as Velidi nuk është në gjendje të bëjë asgjë dhe, për këtë arsye, e zëvendësoi atë me Osman ibën Muhamed ibën Ebi Sufjanin.² Si i ri që ishte, ky nuk e kishte idenë e përgjegjësisë së tij, prandaj do të dërgonte një delegacion teknokratësh nga Medina te kalifi Jezid për të marrë udhëzime se si të vepronin me banorët e Medinës dhe politikën e reja të krijuara në këtë rajon. Jezidi i dha prioritet të madh këtij delegacioni dhe i kushtoi vëmendje të veçantë, duke i prituri në rezidencën e tij private. Delegacioni pasi mësoi mbi rajonin dhe situatën e përgjithshme u kthye për në Medinë, me përjashtim të Mundhir ibën Zubejrit,³ i cili shkoi në Basra për të qëndruar një kohë tek shoku i tij Ubejdullah ibën Zijadi. Historianët sjellin edhe një detaj të rëndësishëm mbi Mundhirin. Kalifi e kishte veçuar atë nga delegacioni, duke ia dhënë një qese prej 100 monedhash, dhe më vonë ai do të emërohet shef i policisë në Medinë.

Vizita e këtij delegacioni nuk dha kurrfarë efekti pozitiv, bile ajo ishte një prej shkaqeve më kryesore të luftës, e cila do të zhvillohej pas disa muajsh, përkundër faktit se Medina kishte filluar të ziente edhe më herët, në veçanti pas vrasjes së Husejnit r.a. Pra, me të kthyer nga Damasku, të gjithë anëtarët e delegacionit nuk fshehën asgjë nga ajo

se ç'kishin parë brenda pallatit të kalifit, ose se si dukej jeta private e Jezidit.⁴ Për shkak të këtij turpi që ia bënë Jezidit, "ai do të dërgonte Nu'man ibën Beshirin në Medinë prej të cilit kërkoi që teknokratët të pendoheshin dhe të bënin çmos për t'ia kthyer prestigjin kalifit". (Bidaje: 6/250)⁵

Tani Jezidi u bë me dy njolla të mëdha: kishte masakruar familjen e Alisë r.a. me djem, nipa dhe vëllezërit e tij, si dhe banorët e Medinës, pasi mësuara mbi jetën private të Jezidit nga teknokratët, filluan të gjykojnë seriozisht se kalifi i tyre nuk ishte besimtar.⁶

Ensarët e Medinës dhe beni Hashimët e Mekës, vendosën të mos e presin njollën e tretë të këtij njeriu dhe morën vendim që t'i kufizojnë lëvizjet e familjes emevite të Medinës, duke ua ndërprerë lidhjet me kryeqytetin. Kjo lloj embargoje te ta u realizua me burgim shtëpiak të shumicës së meshkujve të kësaj familje, përfshirë këtu edhe prefektin e tyre të mitur. Në vend të tij, kurejshitet e Medinës përcaktuan përkohësisht Abdullah ibën Mu'tium, ensarët përcaktuan Abdullah ibën Handhalen, ndërsa muhaxhirët Muakal ibën Sinan el Eshxhaj-in.⁷

Gjendja ekonomike e emevitëve të Medinës do të dobësohej dita-ditës. Kjo gjendje do të përkeqësohej edhe më shumë kur medinasit do të vendosnin për dëbimin e tyre nga qyteti.⁸ Kur situata do të arrinte deri në këtë nivel, emevitet i shkruan letër Jezidit që të merrte masa kundër banorëve të Medinës dhe t'iu dërgonte ndihmë emergjente.⁹

I zemëruar, Jezidi do t'ia dërgonte letrën Amër ibën Seid ibën Asit, mirëpo ky refuzoi të shkonte që ta rikthente situatën ashtu siç kishte qenë, për shkak se Jezidi e kishte shkarkuar atë më parë nga posti i prefektit të Medinës. Jezidi, përfundimisht, do t'i drejtohej Muslim ibën Ukbe el Merij-it,¹⁰ i cili do të drejtonte një ushtri prej 10-12 mijë ushtarësh.¹¹ "Jezidi do të kërkonte nga Muslimi që ai të përpiquej ta zgjidhte problemin në mënyrë paqësore, në veçanti të kishte kujdes ndaj Ali ibën Husejnit dhe mbarë familjes hashimite dhe, pasi të kishte mbaruar punë me Medinën, t'i drejtohej Mekës për ta përmbysur edhe "ateistin" Abdullah ibën Zubejrin.¹² Gjithashtu i

tha se, në rast përkeqësimit të shëndetit të tij, zëvendës do të kishte Husajn ibën Numejr el Sukunij-in". (Dinuri: 209, Bidaje:6/252)

Ndërkohë i shkruan Ubejdullah ibën Zijadit që ta rrethonte Mekën. Mirëpo Ibën Zijadi iu përgjigj negativisht, sepse kishte mbytur nipin e Pejgamberit dhe tani e kishte të vështirë ta mobilizonte një ushtri të re për të marshuar drejt Mekës. Kështu barra e Mekës do t'i mbetej vetëm Muslimit.

Beteja në Medinë

Muslimi, me të arritur afër Medinës, u takua me familjen emevite dhe u këshillua me Mervan ibën Hakemin.¹³ Si njeri me shumë përvojë që ishte i tha që të drejtohet drejt lindjes së qytetit. Atje do të provonte të negocionte me banorët e fisit Hurre. Nëse ata nuk do të pranonin, atëherë të mos priste shumë dhe t'i sulmonte pamëshirshëm. Sipas Mervanit, pjesa lindore e Medinës ishte më e lehtë për t'u thyer. Dhe Muslimi veprroi ashtu. Banorët e Medinës kishin grupuar një hendek në lindje të qytetit dhe me të ndiheshin më të sigurt, si dhe mendonin se do t'i rezistonin më gjatë ushtrisë së Muslimit. Duke e ndier veten se janë tok, Muslimit ia kthyen përgjigjen negative, gjë që i dhanë të kuptojë se janë për



luftë. Medinasit pranonin të vriteshin të gjithë, por jo të dëgjonin urdhrat e “kalifit” të tyre.

Muslimi do t’u jepte tri ditë afat që të dorëzoheshin, mirëpo medinasit, edhe pas këtij afati, qëndruan të palëkundur dhe nuk u dorëzuan. Muslimi u përpoq edhe një herë t’i bindte të dorëzoheshin, duke ua bërë me dije se kishte urdhër nga kalifi që, “nëse nuk do të dorëzohen dhe nuk arrijnë paqe, do t’i çnjerëzojë”. (Bidaje: 6/253) Ky urdhër nuk u bëri përshtypje medinasve dhe nuk u dorëzuan. Muslimit nuk i mbeti mundësi tjetër përveçse të zbatonte urdhrin e kalifit dhe të fillonte betejën, në të cilën u vranë shumë njerëz nga të dy palët. Epërsia ushtarake e Muslimit e bëri atë fitimtar.¹⁴

Muslimi, me të hyrë në qytet, thirri Ali ibën Husjenin. Ky i fundit, derisa po shkonte te Muslimi, shihte masakrimet dhe natyrshëm ishte i frikësuar. Për ta ndier veten më të sigurt, Alia, i biri i Husejnit r.a., do të kalonte midis Mervan ibën Hakemit dhe djalit të tij Abdulmelikut, për t’u paraqitur te Muslimi. Mervani dhe të tjerët nga ushtria e Muslimit u sollën mirë me të për shkak të urdhrin të kalifit: që ai dhe familja e tij të mos prekeshin. Prej ngjarjeve që ndodhën më pas në Medinë thuhet se vetëm familja e gjerë e Abdulmuatalibit nuk u prek nga të këqijat dhe perversiteti i ushtrisë së Muslimit.

Në Medinë u masakruan rreth 10.000 vetë, prej tyre ishin 700 ensarë dhe kure-

jshitë, si dhe 80-të sahabij. Pas kësaj masakre nuk mbeti asnjë luftëtar i betejës së Bedrit i gjallë. Për këtë masakër kishte paralajmëruar Muahmedi s.a.v.s. Në një nga udhëtimet e tij, ndaloi në tokat e fisit Hurre beni Zehre dhe tha: “*Në këtë vend do të vriten më të mirët e umetit tim, pas shokëve të mi.*” (Dinuri: 219)

Muslimi do të zbatonte urdhrin e kalifit dhe do t’i thoshte ushtrisë së tij se iu është bërë hallall, për tri ditë me radhë, të vepronin si të donin me banorët e Medinës. Ata iu vërsulën vrasjeve pa kritere, plaçkitjeve, shkatërrimit dhe përdhunimeve.¹⁵ Thuhet se pas nëntë muajsh mbi një mijë gra të pamartuara kishin lindur.

Drejt Mekës

Muslimi, pasi bëri atë që bëri në Medinë, pa humbur kohë do t’i drejtohej Mekës. Pas ‘suksesit’ në Medinë, ai duhej ta kryente edhe urdhrin tjetër të kalifit, që t’i pastronte hesapet edhe me Abdullah ibën Zubejrin. Mirëpo, mosha në njërin anë dhe sëmundja në anën tjetër, do ta detyronte atë të fushonte për një kohë pak sa më të gjatë midis rrugës Medinë-Mekë. Kur e pa se nuk do të kishte forcë për të vazhduar më tutje “e thirri ibën Numejrin dhe i tha: “O shala e gomarit, dije se kam urdhër që të të lë ty për komandant të ushtrisë, nëse e shoh se nuk mund të vazhdojë më tutje. Tani më dëgjo mirë sepse je njeri që nuk e përzë mizën nga përsheshi: Kur

të arrish në Mekë, urinoje çdo kurejshit që do ta takosh atje. Kjo është vepra më e parapëlqyer, përndryshe do t’i vuash pasojat e tolerancës tënde. Nëse nuk e bën, ke për të hasur në hipokritë dhe ikanakë”. (Dinuri: 219)

Ushtria e Numejrit do të niset për në Mekë më 04.01. 64h. Kësaj ushtrie do t’i bashkëngjiten edhe vullnetarë të tjerë nga qytetet anësore të kësaj rruge. Me të arritur atje, pa asnjë paralajmërim filloi beteja e cila zgjati tërë ditën. Ibën Zubejri ishte strateg dhe me përvojë. Ai vërejti se ibën Numejri kishte përdorur një taktikë të re dhe mezi arriti të përmbahej deri në mbrëmje. Me të rënë terri, ibën Zubejri u ripozicionua duke iu përgjigjur strategjisë së ibën Numejrit dhe kështu ditën e nesërme ushtria e ibën Numejrit e kishte të pamundur të depërtonte në qytet.

Rezistenca e ibën Zubejrit zgjati gjatë tërë muajit 1-2 (Muharrem dhe Sefer). Për këtë arsye ibën Numejri do të kërkonte përforcime. Jezidi do t’i dërgonte në ndihmë skuadrën e katalpultave. Ditën e shtunë, më 03.03. 63h (Rebiul Evel), ibën Numejri filloi të godasë qytetin me katapulte. Disa gjyle të zjarra ranë mbi Qabe dhe kështu ra flaka mbi to duke shkatërruar një pjesë të mureve të saj.

Ka zëra të disa historianëve që thonë se zjarri në Qabe u shkaktuan si rezultat i banorëve të Mekës, ose nga zjarret që i kishte ndezur vetë Ibën Zubejri me



qëllim që t'ia bënte me dije ushtrisë së Jezidit vendndodhjen e Qabesë gjatë natës, që të mos e godisnin katapultat e tyre. Kështu zjarri i madh një natë kishte përfshi Qabënë dhe kishte shkatërruar një pjesë e mureve të saj (Allahu e di më së miri, por shumica e historianëve argumentojnë versionin e parë).

Rrethimi i Mekës vazhdoi deri në fund të muajit të 4-të - Rebiul Ahar. Thuhet se Ibën Zubejri kishte marrë vesh për vdekjen e Jezidit përpara ibën Numejrit dhe i kishte kërkuar disa herë këtij të fundit që ta ndërpriste rrethimin sepse ishte pa kalif. Kuptohet se Ibën Numejri nuk e besoi dhe e vazhdoi rrethimin. Mirëpo kur atij iu bë e qartë vdekja e Jezidit, ai kërkoj nga ibën Zubejri që të shkonte me të në Damask duke i premtuar atij se do ta njihje për Kalif të muslimanëve. Pas shumë përpjekjeve të ibën Numejrit që ta bindte ibën Zubejrin të shkonte me të, ibën Zubejri qëndroi në Mekë. Thuhet se ibën Zubejri më vonë e kuptoi sinqeritetin e tij dhe ishte penduar që nuk i kishte besuar atëkohë.

Diplomacia e jashtme e Jezidit

Jezidi nuk jetoi gjatë, sa për të treguar nëse ishte i shkathët në diplomacinë e jashtme. Meqenëse nuk u tregua i aftë dhe diplomat brenda shtetit të vet, me siguri që edhe në diplomacinë e jashtme kishte për të dështuar.

Siç kishim thënë edhe më herët, në vitet e fundit të jetës së Muavi ibën Sufjanit, shteti islam ishte detyruar t'i paguante tribute perandorisë Bizantine pas 'humbjes' ose tërheqjes së detyrueshme të arabëve nga rrethimi i dytë i kryeqendrës bizantine - Kostandinopojës. Tani, siç po shihet, arabët, me të vdekur Muavia, do ta kishin edhe më të vështirë me bizantinët sikur këta t'i sulmonin. Arabët u përfshinë në luftë të re civile, ndërsa bizantinët, po të shikonin drejt jugut do të kishin mundësi të depërtonin shumë thellë në territorin e muslimanëve me motivin e rimarrjes së tokave të humbura më herët. Mirëpo për fatin e mirë të arabëve, perandori Konstandini i IV-të do të përqendrohej më shumë në Bullgari për shkak të avancimit të bullgarëve në Ballkan. "Perandoria Bizantine u ndesh me rreziqe të tjera për shkak të vërshimit të popullit turk të bullgarëve në Ballkan."¹⁶ (Ostrogorsky: 100)

Konstandini IV-të do të marshonte drejt perëndimit të tokave bullgare me



anë të flotës, të cilën e drejtonte vetë ai, ndërsa një ushtri tjetër synonte kalimin e Danubit. Për shumë arsye, Konstandini i IV-të do të pësonte disfatë nga bullgarët, sa që u detyrua të bënte një marrëveshje paqeje me ta. "Për turpin më të madh të emrit bizantin, pranoi t'i paguante haraç vjetor perandorisë bullgare. Për herë të parë në territorin bizantin qe krijuar një perandori e pavarur, që Bizanti u detyrua ta njohë si të tillë." (Ostrogorsky: 101)

Përveç problemeve me bullgarët, Konstandini i IV-të kishte probleme më të hershme dhe shumë serioze brenda shtetit me rrymat fetare, sidomos me monotelitët dhe, pas një konsulte me Romën, thirri një Koncil për t'i dhënë fund monotelizmit.¹⁷ Koncili filloi më 7 nëntor 680 dhe mbaroi më 16 shtator 681.

Këto të dhëna na bëjnë të njohim realitetin politik të perandorisë bizantine edhe më shumë. Këto dy ngjarje argumentojnë se pse bizantinët nuk kishin as forcë e as motiv për t'i rimarrë tokat e humbura nga arabët. Në anën tjetër, edhe bizantinët do të duhej t'i falënderoheshin Zotit të tyre, që arabëve iu erdhi një kalif i dobët pas Muavisë, i cili nuk diti ta shfrytëzojë rastin e dobësimit të bizantinëve, por, u kap pas përforcimit të pushtetit të tij me elitën opozitare të Hixhazit. "Nëse saraçenët do ta kishin pushtuar Kostandinopojën në shekullin e VII-të dhe jo në të XV-të, ndoshta gjithë Evropa dhe Amerika, sot do të ishin muslimanë". (Norwich: 101)

Tek të dy perandoritë, si ajo bizantine dhe ajo arabe, do të fillonte një lulëzim i ri me ardhjen e dy personaliteteve të reja, të cilët u emëruan në vitin 685 g., njëri si perandor - Justiniani II dhe tjetri si kalif - Abdulmelik ibën Mervan. Justiniani i II-të arriti ta ripërtërinte traktatin me Abdulmelikun në vitin 688-9, traktat i cili ishte nënshkruar më herët midis Muavisë dhe Konstandinit të IV-të dhjetë vjet më parë. Kështu Justiniani nga kjo marrëveshje do të përfitonte sigurinë e kufijve jugorë dhe para të majme, me të cilat do të orientohej kundër armiqve të tij veriorë, ndërsa, në anën tjetër, Abdulmeliku do të përqendrohej më shumë në shuarjen e kryengritjes së Ibën Zubejrit, e cila kishte marrë përmasa shumë të mëdha.

Dijetarët rreth Jezidit

Rreth karakterit të Jezidit është shkruar shumë, aq sa thonë për të se ishte njeri i keq dhe duhet mallkuar, po aq thonë se ishte njeri i mirë. Atë e mbrojnë duke ia lënë fajin fatit të keq të tij, që ndodhi vrasja e Husejinit r.a. në Kerbelā. Ndërsa për rastin e Hures në Medinë, disa e justifikojnë se ka pasur mbështetje bazuar në ligjet e asaj kohe me robërit dhe robëreshat! Nëse autoriteti i shtetit vihet në pyetje lejohet vrasja, prandaj ky grup dijetarësh e quajnë si mëkatar për bëmat e tij karshi vetes dhe shoqërisë, por nuk shkojnë deri në atë ekstrem sa ta mallkojnë.

Sidoqoftë, ne sot, pas katërmbëdhjetë shekujve, nuk kemi pse të merremi me karakterin ose përfundimin e këtij



njeriu, sepse njerëzimi gjithmonë ka pasur, ka dhe do të ketë polemika pro et contra, prandaj ne nuk do të përfshihemi në këtë temë teologjike sepse jemi duke përshkruar ngjarje historike. Mirëpo, për hir të lexuesit më të thjeshtë, kemi sjellë material aq sa të jenë në gjendje të gjykojnë në vetvete dhe, kështu do të kuptojnë më mirë se cila rrugë duhet ndjekur. Materiali është përzgjedhur me disa hadithe të vërteta, të cilat flasin për banorët e Medinës.

“Ata që i dëmtojnë banorët e Medinës, do të treten sikurse tretet kripa në ujë.”

“Ai që i bën keq banorëve të Medinës, do ta shkrijë zjarri i Allahut, mu ashtu siç shkrihet plumbi mbi të.”

“Ai i cili i frikëson banorët e Medinës dhe ushtron tirani, do ta frikësojë Allahun dhe do ta godasë mallkimi i Allahut, i melekëve dhe i mbarë njerëzimit.”

Si duket këto hadithe dhe tërësia e porosive të Zotit në Kuran i motivuan dijetarët e atëhershëm të merren gjerë e gjatë me këtë personalitet dhe të gjykojnë rreth përfundimit të jetës dhe veprës së Jezidit ibën Muavisë. Ibën Hambeli, Ebu Bekër Abdul Aziz, el Kadi ebu Je’lij dhe djali i tij, Hoxhë Ebu Ferexhe el Xhuzij dhe shumë të tjerë kanë lejuar që sa herë të përmendet emri i Jezidit, të thuhet mallkimi i Zotit qoftë mbi të.

Mirëpo ka shumë prej tyre që e kanë heshtur këtë dhe nuk kanë gjykuar asgjë, por kemi edhe prej atyre që e kanë justifikuar veprën e tij dhe e ndalojnë mallkimin e tij për arsye të një hadithi tjetër sahih të Pejgamberit s.a.v.s., i cili ka

thënë: “Kur dikush mundohet ta prishë urdhrin e përgjithshëm, vriteni kushdo qoftë ai.” Gjithashtu mbështeten edhe në një hadith tjetër të përgjithshëm: “Kush tërhiqet nga respektimi (i pushtetit), ai do të shkojë në botën tjetër pa argumente, ndërsa ai i cili vdes i ndarë nga xhemati, vdes si injorant.” (Bidaje: 6/256- 267)

Muavije ibën Jezid (64h-64h)

Jezidi vdiq në moshë të re. Shumica e historianëve janë të mendimit se ai ndërroi jetë në moshën e tij 39 vjeçare. Ai u trashëguua nga djali i tij i madh Muavije ibën Jezid ibën Muavije (43h-64h ose 665g-686g), i cili po ashtu vdiq edhe më i ri se babai tij. Për këtë djalosh thuhej se ishte njeri shumë i devotshëm. Ai nuk qëndroi në pushtet më shumë se dy muaj. Shumica e historianëve thonë se ishte shëndetlig, por kemi edhe prej tyre që thonë se ai vdiq i helmuar. Allahun i Lartëmadhëruar e di më së miri.

Duke qenë se ishte i dobët, namazet me xhematë dhe obligimet administrative të tij i kryente Dahak ibën Kajs. Një ditë ai doli në namazin e xhumasë dhe e mbajti fjalimin lamtumirës. Të pranishmëve ju tha: “O njerëz, vërtet unë mora pushtetin, mirëpo unë jam i dobët dhe i papërvojë. Nëse ju mendoni se unë duhet ta caktoj një njeri të fortë që t’ju udhëheqë ju, ashtu siç e zgjodhi Ebu Bekri Omerin, ose sikurse bëri Omeri që zgjodhi gjashtë teknokratët më të njohur, do ta kisha bërë sikur t’i kisha të tillët, prandaj unë këtë çështje po ua lë ju në duart tuaja, pra zgjidheni më të mirin nga ju. Me këtë fjalë përfundoi ligjëratën e tij dhe zbriti. Nuk doli më nga shtëpia derisa vdiq.” (Bidaje: 6/ 271)

Që prej vdekjes së Muavisë e deri tek ardhja e Mervan ibën Hakemit, dinastia emevite kishte marrë një goditje të madhe, për pak sa nuk u shemb fare. Në këtë luhatje do të zgjerohet pushteti i Abdullah ibën Zubejrit, i cili e kishte shpallur veten Kalif të muslimanëve. Atij do t’ia besonin shtetin shumë intelektualë, teknokratë dhe politikanë të disa prefekturave... (vazhdon)

1 Ndryshe quhet edhe ngjarja e Hures. Thuajse të gjitha librat e hershëm të historisë islame (Taberiu, Ethir, Dinuri, Ibën Kethiri, Jakubi, el Xhuzij,...) si dhe të mëvonshmit, e kanë përshkruar luftën midis ushtrisë së Jezidit dhe banorëve të Medinës, si dhe luftën në Meke, derisa ishte gjallë Jezidi, i biri i Muavisë, me përjashtim të Ibën Haldunit, i cili nuk është marrë me këto dy luftëra (cila është arsyeja, vetëm një Allah e di).

2 Prefekti i ri ishte një djalosh, prej familjes emevite, gjegjësisht ishte djali i axhës së kalifit.

3 Vëllait të Abdullah ibën Zubejrit.

4 Jezidi pinte shpesh, herë pas herë nuk falej, ose ndodhte të shkonte i dehur në namaz. Luante me qentë e tij... etj.

5 Për të mos e përsëritur shpeshherë literaturën, të gjitha këto të dhëna gjenden edhe në librat: Dinuri:2, Ethir: libri 4, Taberi: libri 5, Bidaje: libri 6, el Xhuzij: libri 4, Shelebij: libri 2... Për detaje do të shërbehem vetëm me Ibën Kethirin.

6 Gjykuar sipas mentalitetit të asaj kohe, Jezidi dukej si jobesimtar. Një besimtar i thjeshtë nuk mendohej të mos falej, e të pinte pije dehëse. Mirëpo, kur bëhet fjalë për kalifin (emirin e besimtarëve), ai në asnjë mënyrë nuk duhej t’i kishte këto cilësi. Kuptohet edhe sot e kësaj dite këto rregulla vlejné për të parin e besimtarëve, por jo edhe për besimtarin e thjeshtë.

7 Përcaktimi i tyre, edhe pse përkohësisht, që t’iu prinin këta tri persona ishte gabimi më i pafalshëm i banorëve të Medinës. Ata duhej të përcaktoheshin vetëm në një njeri-një komandë.

8 Si duket ky veprim doli si rezultat i negociatave midis emevitëve dhe banorëve të Medinës. Mervan ibën Hakemi, pak para se të dilte nga Medina, kishte kërkuar nga familja hashimite që të përkujdesej për gratë e femrat e tyre dhe kjo familje, edhe pse tepër e hidhëruar ndaj tyre, pranoi që t’ia bënte këtë të mirë...

9 Kur e mori letrën, Jezidi ishte i shtrirë në shtrat. Si duket edhe gjendja e tij shëndetësore po përkeqësohej çdo ditë e më shumë.

10 Ishte një përbindësh, por i rënduar dhe në moshë. (Babai i Jezidit e kishte këshilluar birin e vet që t’i drejtohej atij në situata shumë të vështira). Në këtë kohë Muslimi ishte kryebashkiak i Gatafanit. Atij do t’i bashkëngjiten edhe bashkiakë të qyteteve si vijojnë: Abdullah ibën Mesade el Fezaj kryebashkiak i Damaskut, Husajn ibën Numejr i Humusit, Habish ibën Dexhle i Jordanit, Revah ibën Zenba’ i Palestinë... (Bidaje: 6/252)

11 Disa historianë thonë se ka drejtuar deri në 17 mijë ushtarë dhe secilit ushtar i kishte dhënë paradhënie nga 40 ose 100 dinarë.

12 Ashtu siç i kishte quajtur të përdalë nga feja Aliun dhe Husejnin r.a., Jezidi do ta quante kështu edhe Abdullah ibën Zubejrin.

13 Politikan me përvojë të madhe dhe pjesëtar i familjes emevite, i cili më vonë do të bëhej kalif.

14 Analistët ushtarakë mendojnë se betejat do të ishte situar nga banorët e Medinës sikur të udhëhiqeshin nga një komandant i vetëm.

15 Historianët kanë sjellë disa ngjarje bizare të vrasjeve të foshnjave, përdhunimeve etj., gjë që turpërohem t’i sjellim këtu. Pyes veten se si kanë mundur veten ta quajnë muslimanë!!!

16 Dyndjet e turqve ose më saktë onogrobullgarëve që kishin depërtuar në këtë territor, në fillim të shekullit të VII-të, kishin grumbulluar aq forcë sa ta sfidonin perandorinë bizantine. Nuk mund të thuhet se turqit e fundshekullit të VII-të të ishin muslimanë. Këta turq shumë shpejt do të harroheshin për shkak të dyndjeve të reja të sllavëve bullgarë në territorin e Ballkanit.

17 Deri në këtë kohë, besimtarët mono-teistë krishterë kishin prezantim të fuqishëm në perandori. Pas përfundimit të këtij koncili, i cili zgjati më shumë se një vit, në të cilin u mbajtën tetëmbëdhjetë seanca, trinitarët dolën triumfues me ndihmën e perandorit.

Amerika & Pranvera Ara

John ESPOSITO

Përmbyssa e sundimit 30 vjeçar të Hosni Mubarakut dhe agimi i ri në Egjipt shkaktën frikë për një ndryshim të paqartë në rajon në zemrat e shumë udhëheqësve. Kjo ka inspiruar protesta në Algjeri, Marok, Jordani, Siri dhe Jemen; krijimin e një partie politike në Arabinë Saudite; dhe probleme në Republikën Islamike të Iranit, e cila u trondit nga Lëvizja e Gjelbër në zgjedhjet e fundit presidenciale.

Fundi i regjimit të Mubarakut vërteton mashtrimin e stereotipeve të zakonshme: arabët e refuzojnë demokracinë, Islami nuk përputhet me sovranitetin e popullatës, kontrolli i udhëheqësve të sigurimit të shtetit është i patundshëm. Protestuesit pro-demokracisë u shtynë nga padrejtësitë e vjetra politike dhe ekonomike: mungesa e demokracisë, zbrazëtira gjithnjë në rritje ndërmjet një pakice të pasur dhe klasës së mesme dhe të varfër, korrupsioni i përhapur, rritja e çmimeve të ushqimit, shkalla e lartë e papunësisë, mungesa e mundësive dhe e kuptimit të së ardhmes për të rinjtë.

Egjiptianët korrigjuan dinjitetin dhe kontrollin e jetëve të tyre, duke kërkuar fundin e korrupsionit të përhapur sikurse edhe transparencën dhe përgjegjësinë e qeverisë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe të drejtën për të caktuar qeverinë dhe fatin e Egjiptit.

Kryengritjet në Egjipt dhe Tunizi kanë nxjerrë në shesh një lëvizje pro-demokracisë, e cila nuk drejtohet nga një ideologji e vetme ose nga ekstremistët fetarë. Ajo çka ka ndodhur nuk është përpjekje e ndonjë pushtimi islamik, por një thirrje e gjerë.

Siç e vërtetojnë edhe shenjat, pankartat, deklaratat dhe kërkesat e tyre, protestuesit dëshirojnë bashkimin e Egjiptit, thërrasin për një Egjipt dhe këndojnë himnin kombëtar të Egjiptit; ata valëvitin flamurët egjiptianë, e jo pankarta islamike. Njerëz nga çdo pozitë shoqërore, profesionistë dhe punëtorë u bashkuan në një qëllim të përbashkët.

Befasuese? Në të vërtetë, jo. Sondazhi Botëror i Gallup-it i më shumë se 35 vendeve me shumicë myslimane, duke përfaqësuar zërat e miliarda myslimanëve, kishte raportuar se në Egjipt

dhe në shumicën e vendeve myslimane, shumica e të anketuarve dëshironin demokratizim më të madh, liri dhe sundim të ligjit. Për fat të keq, Shtetet e Bashkuara dhe shumë vende evropiane vazhduan politikatat e vjetra të përkrahjes së regjimeve autoritare, sigurimeve shtetërore. Përkundër deklaramit të Amerikës për të përkrahur demokracinë dhe të drejtat e njeriut, siç vërtetoi administrata e Bushit, Amerika (nën udhëheqjen e të gjithë presidentëve të fundit) ka pasur trashëgimi të 'eksepcionalizmit demokratik', të cilën shumica e kanë parë si 'standard të dyfishtë', ajo supozoi përkrahjen amerikane të demokracisë globale, por mbështeti regjimet autoritare në botën myslimane. Kjo politikë, ndonëse atraktive për aleatët autoritarë dhe elitat e tyre të ngulitura, ushquu anti-amerikanizmin dhe frikën e ndërhyrjes perëndimore, dyndjes, okupimit dhe varësisë.

Rruga përpara

Ne jetojmë në një botë ndryshuese shumëpolëshe që kërkon atë që edhe presidenti Obama ka pranuar vazhdimisht, që prej fillimit të tij të administrimit, respektin e ndërsjellë dhe bashkëpunimin. Sfida për politikëbërësit amerikanë dhe evropianë do të jetë përtej barazimit të mbrojtjes së interesave kombëtare dhe stabilitetit dhe sigurinë e regjimeve, përtej frikës të së panjohurës, të një procesi, rezultati i të cilit nuk mund të kontrollohet, në një politikë të bazuar në parimet amerikane të vetëpërcaktimit, demokracisë dhe të drejtave të njeriut.

Nëse të kaluarën është shtruar pyetja: "A është e përshtatshme kultura arabe ose Islami me demokracinë? Sot pyetja dhe shqetësimi është: A janë të gatshëm për tranzicion rojet e vjetra dhe elitat e ngulitura (ushtarake, të sigurisë dhe ato politike), apo edhe muslimanët në demokracitë arabe?"

Një kornizë e re, bazuar në punën e qeverive të zgjedhura demokratikisht në Egjipt, Tunizi dhe vendet e tjera të regjionit, përbën një rrezik më të vogël për një të ardhme të parashikueshme, duke punuar me qeveri më të pavarura me vizionin e tyre për interesat e tyre kombëtare. Ashtu siç bëjmë me shumë vende të tjera, aleatë dhe joaleatë, në



tërë botën, marrëdhëniet tona do të bazoheshin në interesat kombëtare dhe interesat e përbashkëta strategjike, politike, ekonomike dhe ushtarake. Për dallim nga e kaluara, SHBA-ja duhet të vendosë theksin primar më tepër në investimet në ndihmë në fushat e arsimit, ekonomisë dhe teknologjisë, se sa në atë ushtarake, duke punuar veçanërisht me OJQ-të e pavarura. Përpjekjet tona duhet të jenë vetëdijshëmrisht të shumanshme, duke dërguar në fund, siç e ka theksuar edhe presidenti Obama, tek një njëanshmëri amerikane.

Ne duhet të pranojmë se është një tregim i ri në Lindjen e Mesme. Po aq kritike do të jetë për popullin egjiptian dhe tunizian të ecin përpara, në të njëjtin sens të unitetit kombëtar, në ndërtimin e një sistemi demokratik, pluralist dhe politik shumëpartiakësh, që paraqet një diversitet sidomos në shoqërinë egjiptiane. Kjo gjithashtu do të jetë e rëndësishme për të siguruar se e ardhmja nuk do të rrëmbet nga ushtria ose elitat e ngulitura që u ka dalë afati nga diktatura e kaluar.

Sunduesit ushtarakë të Egjiptit, në fakt, kanë lëvizur për të mbrojtur dhe zgjeruar pushtetin e tyre aq gjerësisht, sa që një numër në rritje i avokatëve dhe aktivistëve po shikojnë mundësinë që në fund të fundit t'i nënshtrohen autoritetit civil. Treguesit që kanë shtuar frikën se revolucioni është rrëmbyer nga ushtria përfshijnë: riparaqitjen e emergjencës për zgjerimin e ligjit nga Këshilli Suprem i Forcave të Armatosura (KSFA) në emër të ruajtjes së ligjit dhe rendit; që nga revolucioni rreth 12.000 njerëz

Be: një rrugë e re përpara



janë arrestuar dhe do të gjykojnë nga gjykatat ushtarake; një kopje e nxjerrë nga një komision i Ministrisë së Drejtësisë që raporton gjetjen e fakteve me një listë të 39 OJQ-ve, duke përfshirë organizatat më të respektuara të të drejtave të njeriut në Egjipt, që do t'i nënshtrohen hetimeve për "tradhti" nga prokuroria e sigurimit të shtetit të Egjiptit.

Një tregues edhe më i fortë i tranzicionit të taktikave të vonuara ushtarake të qeverisë kundër tranzicionit të shpejtë është edhe orari i shpallur: zgjedhjet parlamentare (duke filluar nga 28 nëntori dhe duke zgjatur deri në janar 2012), që do të ndiqen me përpilimin e kushtetutës, kanë ngritur shqetësimin se zgjedhjet presidenciale do të shtyhen së paku në vitin 2013. Gjenerali Mahmud Hegazi (Mahmoud Hegazy) theksoi: "Ne do ta mbajmë pushtetin derisa të kemi presidentin".

Por si qëndron puna me rrezikun nga ardhja në pushtet e islamistëve?

Është koha të shikojmë evidencat empirike. Që nga vitet e hershme të shek. të XX-të, larg nga të qenit avokatë të ekstremizmit religjioz, partitë e Vëllazërisë Muslimane të Egjiptit dhe të Enahda-s (Rilindja ose rizgjimi) së Tunizisë kanë zgjedhur votimet e jo plumbat. Në mesin e kritikëve (dhe armiqve) më të fuqishëm të Vëllazërisë kanë qenë militantët egjiptianë, duke përfshirë Ajman el Zawahirin e Al Kaidës. Për dekada, Vëllazëria Muslimane, edhe pse zyrtarisht jologale, ka dëshmuar të jetë lëvizja më

e madhe dhe më efektive opozitare jo e dhunshme, politikisht e shoqërisht, në shoqërinë e përgjithshme të Egjiptit. Vëllazëria ka garuar dhe ka dalë mirë në zgjedhje, përkundër ngacmimeve konstante të qeverisë, duke përfshirë burgosjen dhe arrestimin pa bindje ose fakte. Dhe ajo prapëseprapë ka mbetur jo e dhunshme. Në anën tjetër, qeveria e Mubarakut kishte një raport të dhënash të gjatë me dekada të represionit, zgjedhje të manipuluar dhe kishte përdorur batakçinjtë e dhunës qeveritare për të trembur dhe ngacmuar tërë opozitën sekulare dhe islamiste.

Të dielën, më 23 tetor, Tunizia mbajti zgjedhjet e saj të para të lira dhe demokratike. Në një pjesëmarrje mbi 70% të votuesve, midis tyre, të rinj dhe të moshuar, burra dhe gra, islamistë të moderuar dhe sekularistë, këto zgjedhje simbolizuan një rindërtim të dinjitetit dhe lirisë së tyre dhe shpresës për një të ardhme më të mirë. Në të njëjtën kohë, shumica në Egjipt dhe në vendet e tjera të botës arabe dhe perëndimi shikonte frytet e para të beharit pranveror arab. Raportet e para tregojnë se në mes partive politike 80-plus dhe të pavarurave, partia e moderuar islame e Tunizisë En Nahda (Rilindja), ka fituar më shumë se 50% të votave dhe 40% të ulëseve.

Emergjencia e En Nahda-së, si lojtar i madh politik, është rritur me historinë e saj si lëvizja primare opozitare dhe viktimë e regjimit të shtetit policor të Ben Ali-së, me organizimin e saj të fuqishëm, apelin dhe platformën kombëtare, si dhe mungesën e një alternative të fuqishme të

partive politike. Trashëgimia e Ben Ali-së së Tunizisë, si ajo e Hosni Mubarakut të Egjiptit, është një histori dhe kulturë e autoritarizmit, e cila ka penguar zhvillimin e një sistemi të fuqishëm shumëpartiakësh. Bashkimi Demokratik Kushtetues, ashtu sikurse homologia e saj Partia Nacional Demokratike e Egjiptit, demonstuan atë që në thelb është një shtet njëpartiakësh.

Shumë egjiptianë dhe tunizianë shprehin brengat e tyre për rolin që komuniteti ndërkombëtar mund të luajë në prapaskenë. Në një mbledhje pune të bashkëorganizuar nga Qendra Georgetown për Mirëkuptim Islamo-Krishter në Stamboll, në fillim të tetorit, "Zgjidhje arab: tranzicioni nga diktatura në demokraci", udhëheqësit e aktivistëve dhe politikanëve egjiptianë e tunizianë pyetën: A i pranojnë në të vërtetë SHBA-ja dhe BE-ja revolucionet e Pranverës Arabe? Si do të përgjigjen ata në emergjencën e partive të fuqishme islame sikurse En Nahda dhe Vëllazëria Muslimane? A do të përpiqen ata të ndikojnë apo të vendosin kushte në formimin e demokracisë ose në pozicionin e islamistëve? Së fundmi, komenti i sekretares së shtetit, Hillari Klinton, se plani [i qeverisë ushtarake të tranzicionit] për zgjedhje është një "orari përshtatshëm", rifyton këto shqetësime.

SHBA-ja ka çdo arsye që t'i përvishet punës për transferimin e ri të pushtetit në Egjipt dhe Tunizi dhe procesin e vazhdueshëm të transformimit politik që po paraqitet në Lindjen e Mesme. Në fillim të presidencës së tij, Barak Obama, shkoi në Kajro dhe afrooi "besimin e tij palëkundur se tërë populli është i etur për gjëra të thjeshta: mundësinë për të folur sipas mendjes së tyre dhe për të thënë fjalën e tyre se si qeverisen; besueshmërinë në sundimin e ligjit dhe administrimin e barabartë të drejtësisë; qeveri e cila është transparente dhe nuk vjedh prej popullit; lirinë për të jetuar ashtu siç zgjedhin. Këto nuk janë vetëm ide amerikane, këto janë të drejtat e njeriut dhe kjo është arsyeja pse në këto do t'i përkrahim gjithkund." Kur vjen puna të ballafaqohemi me forca pro-demokratike, le të punojmë atë të cilën e kemi thënë. ■

Revista 'Paqja' ka të drejtën e botimit të artikujve të prof. Espozitos, ngase ka arritur marrëveshje me të.

Përktheu: Osman D. GASHI

NOCIONI “TERRORIZMI ISLAM” NË KONTEK

Nexhat IBRAHIMI

Identifikimi i problemit

Kohëve të fundit, politikanë të matur, pastaj edhe intelektualë të baraspeshuar (si Edward Said, Noam Çomski, Xhon Espozito e të tjerë) kanë vërejtur se përdorimi i gabuar dhe i tepruar i konstruktit të gatuar politik “terrorizmi islam” nuk i ndihmon paqes dhe mirëkuptimit në botë dhe as raporteve rajonale e individuale në rrafshin e politikës, koekzistencës etj. Këtë e ka vërejtur edhe kryetari aktual amerikan, Barak Obama, i cili për t’i riparuar raportet ndërmjet ShBA-ve dhe botës islame, kohëve të fundit sugjeroi/urdhëroi revidimin e strategjisë për sigurinë nacionale. Ky revidim nënkupton heqjen e të gjitha shprehjeve pezhorative lidhur me Islamin si fe dhe myslimanët. Këtë lajm e kanë transmetuar thuajse të gjitha agjencitë botërore.¹

Ndonëse kjo u sugjerua/urdhërua në ShBA, për fat të keq, kjo ende nuk po ndodh në Evropë dhe sidomos në trojet shqiptare, në shtypin shqiptar, në politikën shqiptare, atë të Kosovës dhe Shqipërisë dhe vendeve përreth. Për më tepër, edhe pse si vende nuk kemi qenë të atakuar me asnjë “rrezik islam”, siç ishte Nju Jorku, Londra, Madridi etj., ndoshta nga naiviteti, e më shumë nga servilizmi, politika jonë dhe shtypi jonë shpesh janë tejet rigoroz, tendencioz dhe abuzues në terminologji. Për më tepër që kjo politikë më shumë prodhon probleme se sa që i zgjidh ato. Kjo politikë militante e agresive është e ish-presidentit amerikan Xh. Bushit, aspak bindëse as për opinionin e brendshëm, në pajtim me konceptin neokonservator të botës, në të cilën dominon konflikti mes të mirës dhe të keqes, e në të cilën ShBA dhe rendi i saj, mënyra e jetës dhe e veprimtimit të saj, ofrohen si modelet e vetme të drejta në globin tonë.

Obama drejt relativizimit të gjuhës së ashpër

T’i kthehemi sërish vendimit të Obamës që ta zbusë retorikën agresive kundrejt Islamit dhe myslimanëve. Vendimi i tij u prit mirë si në qarqet politike e intelektuale, ashtu edhe ato popullore në ShBA, por edhe te një numër i madh i vendeve në botë. Madje, në disa qarqe



ky vendim u prit me entuziazëm, me shpresë që përveç shmangies së retorikës militante të kalohet në hapa edhe më konkretë, duke e liruar Islamin dhe myslimanët nga stigma e terrorizmit, militantizmit, alkaidizmit dhe nga ndërprerja e dhunës kundër myslimanëve në emër të luftës kundër terrorizmit etj. Ky vendim njëherësh u pa edhe si tentim afirmimi ndaj vendeve myslimane, por edhe vetë myslimanëve kudo që ndodhen.

Duhet sqaruar se vendimi i Obamës nuk ishte urdhër politik, por udhëzues se si do të duhej operuar me terminologjinë dhe me veprimet kundrejt aleatëve të saj, por edhe kundërshtarëve të saj, brenda dhe jashtë vendit. Hapat e ri të administratës së Obamës janë të bazuar në instruksionet, të cilat më 2008 i ka hartuar *Qendra Amerikane kundër Terrorizmit* (US National Counter-Terrorism Centre). Në dokumentin të cilin e ka hartuar² sugjerohet që El-Kaida tash e tutje të mos quhet islame ose organizatë islame, sepse një përdorim i tillë atyre u jep legjitimitet në veprim. Për ta është me rëndësi çfarë dëgjon dëgjuesi.

A e bart Islami barrën e “ekstremistëve myslimanë”?!?

Bota myslimane, të gjitha shtresat, politike, intelektuale dhe popullore, dëshiron t’i thotë dhe po i thotë botës në tërësi se ajo që bëhet nga ndonjë mysliman ose grup myslimanësh nuk është vepër e të gjithë myslimanëve, e lëre më vepër e Islamit. Këta dëshirojnë t’i thonë Perëndimit se ajo që në mediumet elektronike dhe të shkruara me çdo kusht dëshirohet t’i vishet Islamit nuk është e drejtë për ta,

madje është ofendim dhe me këtë veprim të tyre po i bëjnë shërbim të keq vetvetes dhe grupeve radikale. Si duket këtë ka filluar ta kuptojë Uashingtoni dhe t’i bashkëngjitet intelektualëve dhe ekspertëve të shumtë që ia patën tërhequr vërejtjen krahut neokonservativist se identifikimi i disa ekstremistëve me Islamin shkon në favor të ekstremistëve dhe i identifikon ekstremistët me popullin dhe i bën si përfaqësues të popullit. Në anën tjetër, ky edhe është interesi i grupeve ekstremiste, të cilët duke luajtur me letrën e ndjenjave fetare, fitojnë simpatinë e të gjithë myslimanëve të botës, që nuk do të ishte në interes të asnjërës palë, pos në interes të ekstremizmit dhe të ekstremistëve.³

Ndërmjet të keqes dhe të mirës

Në vend të emërtimit të këtyre organizatave terroriste si islame ose myslimane, strategjia e Obamës propozon që këto grupe të përshkruhen si terroriste, të dhunshme, militante, ekstremiste, totalitare e të ngjashme, të cilat e çarmatosin në opinionin publik dhe ia heqin legjitimitetin si mbrojtës të Islamit dhe myslimanëve.

Po ashtu, është propozuar që të hiqen edhe fjala *xhihad* dhe *xhihadist* e *muxhahid*, të cilët në shtypin tonë zakonisht përkthehen si xhihad = luftë e shenjtë, xhihadist ose muxhahid = luftëtar i luftës së shenjtë. Kjo bëhet sepse, në literaturën burimore islame shprehja xhihad do të thotë angazhim, përpjekje për të mirë dhe neutralizim të të keqes dhe vetëm në instancën e fundit kjo shprehje ka kuptimin edhe të luftës. Edhe me këtë veprim, mospërdorimi i kësaj shprehjeje do t’i legjitimonte grupet e ndryshme,



kurse Islami dhe myslimanët nuk do të ofendoheshin për veprimet e individëve.

Madje propozohet që të kihet kujdes edhe te shprehja *islamizëm* dhe *islamistike* gjatë përshkrimit të organizatave terroriste. Në vend të kësaj me shprehjen islamizëm dhe islamistike do të emërtohen organizatat, të cilat e përkrahin islamin politik, por jo edhe terrorizimin.⁴

Mendoj se përdorimi i pavend i shprehjeve me konotacion negativ, që i vishen Islamit dhe myslimanëve, më tepër është prodhim i plejadës së “ekspertëve” të komponuar rishtazi për çështjen islame dhe myslimane, të cilët janë vënë në vrap për pozicione të paguara mirë në agjencione sigurie, në medime të shkruara dhe elektronike dhe institute shkencore, në ShBA, Evropë dhe në rajonin tonë. Për fat të keq, synimi i njerëzve “ekspertë” të tillë nuk është kontributi për zgjidhjen e probleme, por që problemet të mbahen në top-listë dhe që të sigurojnë për vete dobi karriere, dobi materiale etj. Shpeshherë këto teza të shtrembëruara janë shndërruar në vendime politike që edhe më tepër e kanë radikalizuar palën tjetër. Vendime të tilla i kemi disa, si mbulesa e femrës muslimane, arrestimi i individëve duke përfshirë të gjithë myslimanët etj. ■

1 Sipas: Muhamed Jusić, Pojam „islamski terorizam“ je netačan i kontraproduktivan, në: <http://www.preporod.com/muhamed-jusiain-menu-89/1710-pojam-islamski-terorizam-je-netaan-i-kontraproduktivan.html>.

2 Fjalët që veprojnë dhe fjalët që nuk veprojnë: Udhëzuesi për komunikim antiterrorist = Words that Work and Words that Don't: A Guide for Counter-Terrorism Communication.

3 Sipas: Muhamed Jusić, po aty.

4 Sipas: Muhamed Jusić, po aty.



Intelegjencia arabe

Robert F. WORTH,

Nju Jork Tajms

Filozofi politik, siriani Michel Aflaq, ishte një përkrahës i flaktë i nacionalizmit arab, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Kurse Adonisi, i cili jetonte i dëbuar në Francë, ka zhgënjyer në mënyrën më të keqe shumë sirianë. Letra e tij paraqiti disa kritika, por edhe nënvlerësoi protestat që kishin përfshirë vendin që nga marsi dhe dështoi të pranojë brutalitetin që kishte lënë të vdekur qindra sirianë. Në retrospektivë, incidenti ka ardhur për të ilustruar përçarjen mes intelektualëve të shquar të botës arabe të tillë si: Adonisi, ish - radikal dhe kryesisht njerëzve të rinj anonimë, të cilët kanë udhëhequr protestat e pranverës arabe. Më shumë se 10 muaj pas fillimit të saj, me vetëvrasjen e një shitësi frutash tunizian, vala e madhe e kryengritjes në të gjithë botën arabe ka rrëzuar tre autokratë dhe ka çuar Tunizinë drejt zgjedhjeve të reja, zgjedhje, të cilat janë pritur si agimi i një epoke të re. Ende nuk është paraqitur një projekt i qartë politik ose ekonomik, ose ndonjë mbartës standard intelektualiteti, i cili i ka dhënë formë gati çdo revolucionin modern nga viti 1776 e tutje. Në ato revolta, mendimtarë ose ideologë, nga Thomas Paine dhe Leninin te Mao dhe Vaclav Havel, ndihmuan të sigurojnë një vizion unifikues ose u bënë simbole të aspiratave të popullit. Mungesa e figurave të tilla në pranverën arabe është pjesërisht një masë presionesh ndaj intelektualëve arabë, të cilët kanë jetuar të bllokuar mes shtypjes brutale të shtetit

në njërin anë dhe mbytjes së ortodoksisë islame në anën tjetër. Shumë ishin të korruptuar nga qeveritë e tyre (ose nga paratë e naftës së Gjirit Persik), ose të dëbuar e të detyruar të jetojnë në mërgim, ku edhe humbën kontaktin me realitetin e hidhur në shoqëritë e tyre. Ata që mbetën kanë “duartrokitur” shpesh revoltat e vitit të kaluar dhe madje edhe kanë marshuar së bashku me turmat. Por ata nuk i kanë nxitur ato dhe shpesh dukeshin të tronditur dhe të hutuar nga një protestë që ata nuk mundën ta parashikojnë. Mungesa e udhëheqësve të tillë mund të jetë “vula” e një epoke të madhe post-ideologjike, në të cilën është ndërë nevoja për unifikimin e doktrinave ose figurave madhështore. Roli i intelektualëve mund të tkurret dhe t’i besohet një “organizatori rrugë”. Për disa, kjo është më se normale. “Unë nuk mendoj se ka shumë nevojë për intelektualë, në nxitjen e çdo revolucionit”, - theksoi Sinan Antoon, poet dhe novelist me origjinë irakiene, i cili ka shkruar gjerësisht mbi “Pranverën arabe” dhe tani jep mësim në Universitetin e Nju Jorkut. “Kjo protestë nuk është më një lëvizje që ka nevojë të udhëhiqet nga heronj”. Revoltat vijojnë në Siri. Organizatorët brenda dhe jashtë vendit janë tani duke luftuar për të krijuar një grup qëllimesh të përbashkëta politike, duke iu referuar më shumë koherencës intelektuale dhe udhëheqëse që është padyshim gjëja më e rëndësishme në këtë proces. “Askush nuk dëshiron të akuzohet për rrëmbimin e një revolucionit”, - pohoi Sadik Jalal al-Azm, një filozof sirian dhe mbrojtës i lirive dhe të drejtave më



të mëdha qytetare. “Kjo frikë e tepruar është duke u bërë një pengesë e madhe”. Në një farë mase, heshtja intelektuale e kryengritjes aktuale është një përgjigje e qëllimshme në retorikën revolucionare boshe të brezave të mëparshëm. Lëvizja nacionaliste arabe filloi në vitet 1930-’40 nga burrat idealistë të rinj, të cilët shpresonin për të udhëhequr rajonin larg nga e kaluara koloniale dhe tribalizmi. Filozofi politik, siriani Mishel Aflak, shkrimtarë të tjerë dhe aktivistë të rinj gjetën frymëzim në teoritë gjermane të nacionalizmit të shekullit XIX dhe përfytyruan partinë e tyre “Baath” si një instrument për modernizim dhe drejtësi ekonomike. Por partia dhe idetë e tij u rrëmbyen në mjegull dhe u shndërruan në slogane, nga oficerë të ushtrisë në Siri dhe Irak, udhëheqja “revolucionare” e të cilëve, ishte me pak fjalë tribalizmi i vjetër dhe autokracia me një maskë të ndryshuar. Në Egjipt gjithashtu, socializmi arab erdhi e u bë pak nga pak një pretekst për diktaturë dhe politika të “çmendura” brenda dhe jashtë vendit. Nacionalizmi arab arriti kulmin e vet, kur Koloneli Muamar el-Gadafi, i cili e pa veten si një intelektual hyjnor, botoi trillimin e tij dhe imponoi iluzionin, “Teoria e tretë Universale mbi njerëzit fatkeq të Libisë”. Çdo gjë në lidhje me Libinë Kolonel Gadafi e kishte vetëquajtur “revolucionare”. Por kur rebelët rrëzuan qeverinë e tij, protestuesit, të cilët udhëhoqën “Pranverën arabe”, ishin lodhur nga retorika e ndenjtur internacionaliste e paraardhësve të tyre, e cila kishte arritur pak për palestinezët dhe kishte thelluar ndarjet ndërmjet shteteve arabe në vend që t’i unifikonte ato. Ata donin të fokusoheshin në dështimet e

shoqërive të tyre. “Më parë, çdo gjë u reduktua në pjesën e jashtme: a jeni pro apo anti-amerikanë, cili është roli e Izraelit, dhe kështu me radhë”, - tha Hazem Saghieh, një redaktor politik i gazetës arabe “Al Hayat” me bazë në Londër. “Ky revolucion është krejtësisht ndryshe”. Ndryshimi është bazuar dhe thekson të drejtat civile dhe demokracinë në “shtëpi” dhe kjo nuk ka ardhur nga asgjëja. Disa intelektualë arabë kanë filluar ta flasin këtë gjuhë kohë më parë, duke përfshirë këtu edhe z. Azm, filozof sirian, i cili pas poshtërimit të luftës me Izraelin 1967 botoi një libër novator, të quajtur “autokritikë pas disfatës”. Të tjerët u përshtatën gradualisht dhe gjatë “Pranverës së Damaskut” - një dekadë më parë - që rezultoi me të vërtetë jetëshkurtër, intelektualët sirianë nënshkruan “Deklaratën 99”, një thirrje mbi të drejta më të mëdha civile dhe “pro” hapjes. Pas kësaj, shumë veta përfunduan në burg. Trimëria dhe këmbëngulja e këtyre intelektualëve dhe e të tjerëve si ata në Egjipt, mund të kenë përgatitur terrenin në heshtje, për kryengritjet gjatë këtij viti. Por gjatë viteve të fundit, zëri i tyre rezultoi i padëgjuar, sepse gjuha e tyre shekullare kishte pak rezonancë në shoqëritë ku Islami politik ishte duke u bërë forcë dominuese. As reformatorët islamikë nuk u pritën mirë kur u përpoqën për të “konvertuar” kritikët e tyre politikë në aspektin fetar. Dijetari egjiptian Hasan Hanefi, për shembull, në vitin 1980 bëri thirrje për krijimin e një “të djathtë islame”, një ideologji socialiste e rrënjosur në fe. Ai u ashtuquajt heretik dhe kërkoi mbrojtjen e policisë, pasi mori kërcënime me vdekje nga elementët radikalë. Puna e tij fitoi

një audiencë të madhe në Indonezi, por jo në vendin e tij, tha Carol Kersten, një pedagoge në Kolegjin Mbretëror të Londrës, e cila shkroi mbi reformatorët islamë. Novelisti egjiptian, Alaa al-Aswany, u bë një kritik i ashpër i qeverisë së Hosni Mubarak gjatë viteve të fundit, por i shpëtoi arrestimit falë famës dhe popullaritetit të tij. Ai ishte ndër shkrimtarët e parë që u foli turmave në Sheshin Tahrir në janar, dhe në mars, mbajti një performancë ndëshkuese gjatë një debati televiziv me Ahmed Shafik, Kryeministrin e emëruar nga z. Mubarak. Një ditë më pas, pushteti i Këshillit ushtarak të Egjiptit shkarkoi z. Shafik, dhe shumë syresh e përgëzuan dhe ia dedikuan Z. Aswany këtë arritje. Por zoti Aswany e bëri të qartë që nga fillimi, se qëllimi i tij, ishte t’u shërbente kërkesave të protestuesve në sheshin Tahrir. Ai nuk dha ndonjë ide të tijën. Z. Harling shtoi se: “asnjëri prej intelektualëve sirianë nuk ka artikuluar ndonjë lloj platformë politike, largpamëse” dhe se dështimi ka kontribuar dhe është fokusuar më shumë në shqetësimet rreth drejtimit që do të merrte protesta. Midis euforisë mbi vdekjen e Kolonel Gadafit, pak zëra skeptikë mund të dëgjoheshin midis mesazheve triumfale në internet. “Le të jete vrasja e Gadafit një mësim si për revolucionarët ashtu edhe për sundimtarët”, - shkroi një arab, përdorues i Twitter-it. “Dhe le t’u rikujtojmë revolucionarëve kudo, se Gadafi erdhi në pushtet duke e bërë revolucionin e tij 40 vjet më parë”. Vit, në të cilin ata e patën të vështirë të ndanin emrat e tyre nga ata të revolucionarëve të përmbytur. ■

Përktheu: Arsim JONUZI

Sundimi otoman, Islami dhe shqiptarët, 1874-1913

George W. GAWRYCH

Konteksti otoman

Në vitin 1874, *Besa jahud' Ahde Vefa* u shfaq në skenë, në një qytet me të vërtetë kozmopolit, në Stamboll. Në vitin 1880, Stambolli kishte një popullsi prej afro 90.000 banorësh, me pak mbi gjysmën e banorëve të tij muslimanë. Megjithëse gjuhë të shumta mund të dëgjoheshin nëpër rrugë, pjesa më e madhe e njerëzve e kuptonin lehtë turqishten. Për gjysmën e dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë, burimet ndryshojnë për sa i përket faktit se sa shqiptarë jetonin në Stamboll. Llogaritjet luhaten nga më e larta 60.000, deri te më e ulëta 10.000. Nëse shifra e parë është e saktë, atëherë kryeqyteti otoman përmbante më shumë shqiptarë sesa çdo qytet ose komunë në botën e asaj kohe. Në të njëjtën kohë, evropianët ruanin një prezencë dhe influencë të fuqishme përmes ambasadave të tyre, institucioneve financiare, shkollave


dhe qendrave kulturore. Banorët e Stambollit, duke përfshirë edhe sulltanin, vishnin rroba të bëra sipas modelit të Evropës perëndimore. Forca të ndryshme bashkoheshin në këtë qytet madhështor, bindjet e të cilave shkonin nga toleranca dhe humanizmi, nga njëra anë, deri tek intoleranca dhe fanatizmi, nga ana tjetër, me të gjitha llojet e ngjyimeve ndërmjet.

Nga pikëpamja etnike, perandoria përfshinte, midis të tjerëve, turq, arabë, kurdë, shqiptarë, grekë, armenë, bullgarë, serbë, vllah dhe çifutë, të cilët ndaheshin ndërmjet tre religjioneve kryesore të: Islamit, Krishterimit dhe Judaizmit.

Për të qeverisur një mozaik njerëzimi, reformatorët morën përsipër në vitin 1839 një varg reformash të paprecedentë. Periudha që përfshin vitet nga 1839 deri në 1876 njihet si Tanzimat (Riorganizim). Reformat përpunuan një ideologji dhe program zyrtar të njohur si "Otomanizëm" (*Osmanlîlik*), veçoria esenciale e të cilit u bë, siç u deklarua më

herët në diskutimin e dramës *Besa jahud' Ahde Vefa*, barazia e të gjithë shtetasve brenda perandorisë, pavarësisht prej origjinës, religjionit a etnicitetit. Reformuesit e Tanzimatit kishin si qëllim që të ngulitnin identitetin dhe lojalitetin otoman brenda perandorisë. Përpara këtyre reformave, fjala otoman kufizohej përgjithësisht për dinastinë ose shtetin. Tani çdo shtetas mund të pretendonte një identitet otoman, siç shihet në medaljonet e stampuara nga Sulltan Abdulmexhidi (1839-61) me titullin e ri, "*L'Empereur des Ottomans*."

Një formë e re të menduari hyri në gjuhën e përditshme. Njerëzit tani përdornin terma të tilla si "komb" (*millet*) otoman, "atdhe" (*vatan*) otoman, "qytetari" (*tabiiyet*) otomane dhe, madje, teatër otoman. Duke e zgjeruar fjalën për të identifikuar aktivitetin publik brenda perandorisë, "otoman" u bë, edhe në mënyrë të vetëdijshme edhe në mënyrë të pavetëdijshme, cilësi e të gjithë



qytetarëve, të paktën në teori. Për të penguar formimin e barrierave në marrëdhëniet shoqërore, muslimanët ndaloheshin t'iu referoheshin jomuslimanëve në një mënyrë përcmuese, për shembull, duke i quajtur ata “të pafë” (*gavur*).

Pavarësisht nga përpjekjet për farkëtimin e një identiteti të ri mbikombëtar otoman, reformuesit e Tanzimatit e kuptuan se realiteti i diversitetit etnik, religjioz dhe gjuhësor, duke mbetur ndërkohë tipari esencjal i perandorisë, kishte vlerat dhe pengesat e tij. Si rrjedhim, në drejtim të diversitetit, Otomanizmi kërkonte një artikulum, angazhim dhe pranim të pluralizmit kulturor. Në vëllimin e parë të studimit të tij me dymbëdhjetë vëllime të historisë otomane, nga 1774 deri në 1826, të botuar në 1854, Ahmed Xhevdet Pasha (1822-95) – një historian, administrator dhe reformues i njohur – e artikuloi një nocion të tillë. Ai veçoi rolin e rëndësishëm që “komunitetet arabe dhe turke” (*Arab ve Türk milletleri*) kishin luajtur në historinë islame. Arabët e kishin përhapur Fjalën e Zotit nëpërmjet pushtimit, ndërsa turqit e kishin rivendosur unitetin e “kombit islamik” me trimërinë e tyre “një prej cilësive natyrore të të qenët turk (*Türk[ük]*.”²⁵ Por Ahmed Xhevdet e çoi diskutimin e tij përtej arabëve dhe turqve. Në vlerësimin e tij të historisë perandorake, ai thekson besimin se fuqia e Perandorisë Otomane ka qëndruar në trashëgiminë e saj të ndryshme kulturore. “Komuniteti otoman” (*Osmanlı milleti*) përbënte një shoqëri të madhe sepse “njerëzit” (*insanlar*) e tij flisnin shumë gjuhë dhe sepse ai përzgjedhi “sjelljen” (*ihsan*), “zakonet” (*adap*) dhe “shprehjet” (*atvar*) më të mira midis kombeve të tij të ndryshme. Duke u mbështetur në diversitetin kulturor, otomanët e kishin përtërirë kombin islamik, i cili ishte kredhur në një gjendje kalbëzimi. Këtu, autori shprehte nocionin e pluralizmit kulturor.

Reformat institucionale dhe ligjore pasqyruan një angazhim për implementimin e ideologjisë shtetërore të Otomanizmit. Tani, shteti otoman, si një sistem politik, i inkurajoi “jomuslimanët” (*gajr-i Muslimin*) që të regjistroheshin në shkollat e reja shekullare dhe që të shërbenin në burokraci. Nga fundi i vitit 1870, të krishterët mbanin poste të rëndësishme qeveritare, të tilla si ministër, ambasador dhe nënsekretar. Sipas një studimi, jomuslimanët llogaritin për afërsisht 40 për qind, ose shtatëdhjetë emërim



në Ministrinë e Jashtme deri në fund të Tanzimatit. Ministrinë e tjera kishin, përgjithësisht, një përfaqësim të vogël të minoriteteve fetare. Megjithatë, të krishterët dhe çifutët punonin në dogana, punë publike, kantieret e flotës ushtarake detare dhe punishtet e prerjes së monedhës. Ata ndihmuan në vënien në punë të sistemit të telegrafit dhe të hekurudhave. Ata gjithashtu luajtën role të rëndësishme në jetën kulturore dhe intelektuale të perandorisë. Numri i tyre përfshinte pronarët ose drejtuesit e disa gazetave të rëndësishme dhe pronarët e shtëpive botuese. Siç e përmendëm më herët, armenët mbanin rolin parësor në ndërtimin e teatrit otoman. Në vitin 1869 u hapën gjykatat shekullare *nizamije* për ta administruar drejtësinë të bazuar mbi kode të reja. Ligjërisht, çdokush mbante një identitet otoman që bazohej në qytetarinë e përbashkët. Në vitin 1857 qeveria filloi rekrutimin ushtarak për jomuslimanët dhe në të njëjtën kohë e hoqi “taksën” (*xhizje*) për të krishterët dhe çifutët dhe e lejoi apostazinë [heqjen dorë] nga Islami. Të gjitha këto ndryshime e rritën integrimin e të krishterëve dhe çifutëve në shtetin dhe shoqërinë otomane.

Reforma të tilla sigurisht hasën

kundërshtim gjatë gjithë periudhës së Tanzimatit. Barazia, në veçanti, solli me vete edhe mundësinë, edhe përgjegjësinë: “Ndërsa jomuslimanët në përgjithësi ishin të gatshëm për të pranuar përfitimet e barazisë, ata e kundërshtuan çmimin saj.” Të krishterët dhe çifutët, për shembull, preferonin më mirë të paguanin një taksë të veçantë përjashtimi nga detyrimi ushtarak sesa të përballonin mundësinë e përmbushjes së obligimit të tyre të shërbimit ushtarak. Shumë muslimanëve, nga ana e tyre, nuk iu pëlqente që të shihnin çfarëdo pakësimi në pozitën e tyre të privilegjuar dhe preferuan, në vend të kësaj, ruajtjen e sundimit musliman në qeveri. Muslimanët pëlqenin më shumë pozitën tradicionale të të krishterëve dhe të çifutëve si të mbrojtur, të lirë për të praktikuar besimin e tyre pa ndërhyrjen e qeverisë, por shtetas të pabarabartë.

Por ndryshimi erdhi ngadalë, edhe pse me pahir. Vëzhgues perëndimorë, me qëndrime të gjata në perandori vinin në dukje ndryshime të ndjeshme në shoqërinë otomane si rezultat i Otomanizmit. Charles MacFarlane, një shtetas anglez, vinte në dukje një pamje të re të pikëpamjeve midis qëndrimit dhe udhëtimeve të tij në vitet 1827-28 dhe

atyre në vitet 1847-48. Ai përshkruante ndikimin e eliminimit të kodeve të veshjes dhe një ndryshim të përgjithshëm të sjelljes: “Në shumë raste, më kushtonte mendimi dhe shqetësimi që të dalloja midis muslimanëve dhe rajahëve (të krishterëve). Njëzet vjet më vonë, nuk ekzistonte mundësia e ngatërrimit të tyre.... Aty ku unë isha fyer disa herë dhe isha pështyrë më tepër sesa një herë prej fundërrinave të shoqërisë turke, tani sigurisht ne nuk gjetëm asgjë tjetër përveç mirësjelljes.”

Evropianë dhe amerikanë të tjerë e kanë përsëritur vëzhgimin e përgjithshëm të MacFarlane-s. Duke shkruar pas tridhjetë vjet qëndrimi në Turqi, Cyrus Hamlin (1811-1900), themeluesi dhe dekani i parë i Kolegjit Robert në Stamboll, që dalloj një tolerancë të re fetare në shoqërinë otomane, pohonte se: “Muslimani i trajtonte të krishterët me

një respekt që ai nuk e kishte pasur më parë.” Hamlin, një misionar i krishterë, paraqiste një numër rastesh të muslimanëve të konvertuar në Krishterim pa dëmtim personal dhe madje duke arritur miratim nga pasuesit e besimit të tyre të mëparshëm. Në librin e tij të botuar në 1878, ai shënon përafërsisht pesëdhjetë konvertime të tilla që kishin ndodhur me sukses gjatë njëzet vjetëve të shkuara.

Pavarësisht nga shekullarizimi i Tanzimatit, Perandoria Otomane mbeti në esencën e saj një shtet islamik, ashtu siç ilustron nga fraza tradicionale *din ve devlet*, bashkimi i fesë dhe shtetit. Megjithatë, Otomanizmi nxiti zhvillimin e patriotizmit otoman, duke i shtuar *din ve devlet*-it edhe nocionin e vatanit. Nuk eksiton shembull më i mirë i patriotizmit otoman sesa një dramë e botuar në vitin 1872 dhe e vënë në skenë në prill të vitit

1873. Namik Kemal (1840-88), një turk, shkroi *Vatan vejahud Silistre* (Atdheu apo Silistria), pa dyshim drama më e famshme otomane e shekullit të nëntëmbëdhjetë.

Vatan vejahud Silistre përqendrohet në përpjekjen e perandorisë për të mbrojtur provincën e Silistria-s nga ushtria pushtuese ruse, në Luftën Ruso-Turke të vitit 1828. Namik Kemal-i e zgjodhi Islam si emër për heroin e dramës, duke i siguruar si rrjedhim një ton religjioz linjës së ngjarjes. Kështu, sipas tij, feja islame qëndronte si lidhje midis fjalës otoman dhe vatan. Megjithatë, synimi kryesor i dramës ishte që të nguliste te publiku një patriotizëm otoman të pasionuar. Fjalët “otomanë” dhe “Otomанизëm” u shfaqën në skena shumë emocionale me qëllimin e elektrizimit të opinionit publik për ta bërë detyrim mbrojtjen e perandorisë me çdo kusht. Pavarësisht nga apelimet për Islam dhe patriotizmin otoman, *Vatan vejahud Silistre*, nxori në pah gjithashtu edhe diversitetin etnik. Dy turq, Sitki Bej dhe Abdullah Çavush, spikatnin si heronj. Por drama hapej me Zekije Hanëmen, të dashurën e Islam Beut, e veshur me veshje shqiptare. Zekija e ndjek burrin e saj në betejë e maskuar si ushtar mashkull. Prezenca e saj e herëpashershme, por e fuqishme gjatë gjithë shfaqjes, përforconte temën se të gjithë otomanët duhet të ndiejnë një lidhje dhe besnikëri të fuqishme për perandorinë.

Vatan vejahud Silistre dhe *Besa jahud Ahde Vefa* trajtuan temën e vatanit - atdheut. Vatanin ende mbarte kuptimin e tij tradicional të qytetit ose vendit të lindjes dhe edukimit të një personi. Por ai u shoqërua gjithashtu me patriotizmin dhe me nocionin e trinitetit të *din ve devlet ve vatan*, dhe kjo influencë arriti popullaritet pa dyshim nga fundi i vitit 1870. Namik Kemal theksonte, me një zell ngjites, shenjtërinë e atdheut otoman dhe të patriotizmit otoman. Në pjesën e parë të dramës së tij, heroi Islam Beu e deklaronte vatanin si pjesë të fesë muslimane: “Vatani është një me besimin. Ai që nuk e do vatanin, nuk e do as Zotin.” Megjithatë, një zell i tillë patriotik mund të ishte i rrezikshëm. Theksimi aq shumë i vatanit, zvogëlonte rëndësinë e institucionit të sulltanatit. Si pasojë, pas dy shfaqjesh, qeveria e pengoi dramën dhe e ndaloi shfaqjen e saj. *Vatan vejahud Silistre* e Namik Kemal-it më së fundi u bë pjesë e letërsisë revolucionare që lexohej në mënyrë sekrete nga ata që kundërsht-



tonin sundimin autokratik të Sulltan Abdulhamidit të II-të (sundoi 1876-1909).

Theksi duhej të vendosej më tepër mbi atdheun otoman, mbi patriotizmin otoman dhe mbi besimin islam, që të theksohej bashkimi dhe asimilimi në dëm të pluralizmit dhe diversitetit kulturor. Duke i shkruar një shoku në vitin 1878, Namik Kemal-i zbulonte tendencën e tij në këtë drejtim.

Pa dyshim është e pamundshme që të inkurajosh përhapjen e gjuhës sonë midis grekëve dhe bullgarëve, por është sigurisht e mundshme midis shqiptarëve dhe laz-ëve, pra muslimanëve. Nëse ne hapim shkolla të rregullta në vendet e tyre dhe zbatojmë programet, që nuk janë zbatuar deri tani, gjuha laz-e dhe shqiptare do të harrohen plotësisht brenda njëzet vjetësh.

Dhe në dramën e tij, Namik Kemal-i e portretizon babanë e Zekijes si një turk, ndonëse ajo në fillim të shfaqjes shfaqet e veshur me një kostum shqiptar.

Përkundrazi, Shemsedin Samiu, si një shqiptar i vetëdijshëm për etnicitetin e tij, shihet një rrezik në patriotizmin otoman që synohej në dëm të diversitetit kulturor dhe etnik. Në këtë pikëpamje, *Besa jahud Ahde Vefa* u shfaq si një korrektuese ndaj *Vatan vejahud Silistre*. E shkruar dhe e vënë në skenë një vit pas *Vatan vejahud Silistre*, *Besa jahud Ahde Vefa* nxori në pah dy vatane. Shemsedin Samiu u fokusua në vatanin e veçantë, në vatanin që lidhej me një *kavim* të veçantë, që në këtë rast ishte populli shqiptar, me cilësitë dhe tiparet e tyre të të qenët shqiptar. Sipas pikëpamjes së tij, uniteti otoman, sado i madhërishëm dhe i shenjtë, duhej të lejonte lulëzimin e pluralizmit kulturor brenda komunitet musliman. Në fund të fundit, drama e tij synonte të fuqizonte vlerësimin e diversitetit etnik brenda perandorisë. Në një sens, dy dramat ishin plotësisht të ndryshme. Namik Kemal-i paraqiti një mesazh politik të patriotizmit otoman që përqendrohej në konceptin ideologjik të vatanit. Shemsedin Samiu, nga ana tjetër, zhvilloi një temë kulturore, duke u fokusuar mbi besën, një institucion shekullor, dhe e paraqiti vatanin e tij të veçantë si vendin territorial të kulturës, vlerave dhe besnikërisë shqiptare. Komponenti politik i *Besa jahud Ahde Vefa* ishte i pakapshëm.

Konteksti shqiptar

Lëvizjet e vetëdijes kombëtare shqiptare dhe të mbrojtjes kulturore e kishin paradaturuar shfaqjen e *Besa jahud Ahde*



Vefa. Përpyekjet e para në këtë drejtim u fokusuan kryesisht në krijimin e një gjuhe të shkruar standarde. Naum Veqilharxhi (1797-1846) mban një vend të spikatur në historiografinë shqiptare si një pionier në këtë drejtim. I lindur afër Korçës, në vitin 1797, ai emigroi në Rumani në një moshë të re dhe më vonë mori pjesë në kryengritjen rumune të vitit 1821. Atje, i mërguar nga atdheu i tij dhe i frymëzuar nga retorika nacionaliste përreth tij, ai filloi ta konsiderojë zhvillimin e gjuhës amtare si domosdoshmëri për ruajtjen e kulturës shqiptare. Në vitin 1844, pas krijimit të një alfabeti të ri shqiptar, Veqilharxhi botoi një abetare dhe e dërgoi atë në qytetin e tij të lindjes. Shumë historianë shqiptarë e fillojnë zgjimin kombëtar të Shqipërisë me këtë botim. Veqilharxhi zgjon interesim për faktin se ai ishte një vendas që u mbroth në sigurinë e “Diasporës Shqiptare”, duke i lidhur dy botët në të njëjtën kohë së bashku, një dinamikë që do të mbetet esenciale për të kuptuarit e zhvillimit të shqiptarizmit.

Konstantin Kristoforidhi (1830-95), një i krishterë ortodoks, gjithashtu ka dhënë kontributet e para për zhvillimin e gjuhës shqipe. I lindur në Elbasan, në Shqipërinë e Mesme, ai ndoqi Gjimnazin Zosimea në Janinë, nga viti 1847 deri në vitin 1850. Gjatë qëndrimit të tij në këtë qytet jugor shqiptar pas periudhës me Shoqërinë Angleze Biblike, kohë gjatë së cilës ai përktheu pjesë të Testamentit të Ri dhe të Vjetër në gjuhën e tij amtare. Ashtu si Veqilharxhi përpara tij, ai kishte filluar ta shihet zhvillimin e gjuhës shqipe si një çelës për ruajtjen

e popullit të tij. Si rrjedhim, Kristoforidhi ia kushtoi pjesën më të madhe të jetës së tij studimit dhe shkrimit të gjuhës, një përpjekje që përfshiu udhëtimin anembanë Shqipërisë për të mbledhur material. Në vitin 1904, pas vdekjes, u botua vepra e tij kryesore: *Fjalori i gjuhës shqipe*. Këta dy shembuj paraqesin trazirat etnike të një numri të vogël shqiptarësh, por ata nuk arritën që të pushtonin imagjinatën e bashkëdhetarëve të tyre shqiptarë.

Përveç kontributeve të mësipërme, shqiptarët muslimanë në Shqipërinë Jugore zhvilluan traditën e poezisë së shkruar në gjuhën shqipe me shkronja arabe. Poema më e vjetër në këtë drejtim u duk në vitin 1725. Bektashinjtë nxorën një numër epikash letrare në gjysmën e parë të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Teqeja e tyre në Frashër, në qytetin e lindjes së Shemsedin Samiut, mori pjesë në këtë aktivitet letrar.

Interesimi evropian për Shqipërinë u shtua gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë, në një masë të madhe për shkak të rritjes së interesave strategjike dhe ekonomike të Fuqive të Mëdha në rajon. Studimet akademike ndoqën shembullin e të tjerave dhe u zhvilluan gjatë gjithë periudhës nën shqyrtim. Ndërmjet botimeve më të shquara, gjatë periudhës nga viti 1830 deri në vitin 1870, ishin *Die Sprache der Albanesen oder Schkipetaren* në vitin 1835, i gjermanit Josef Xylander (1794-1854); *Albanesische Studien* me tre vëllime në vitin 1854, i austriakut Johann Georg von Hahn (1811-1869); *Über das Albanesische in seinen verwandtschaftlichen Beziehungen* në vitin 1855, i gjermanit Franz Bopp (1791-1867); dhe *Manuel de la langue chikipe, ou albanise* në vitin



1879, i francezit Auguste Dozon (1822-91). Këto studime dëshmuar dobitë dhe frymëzimin e ndërsjellë për të dy palët: edhe për shqiptarët, edhe për evropianët. Kristoforidhi për shembull, krijoi miqësi me Johann Georg von Hahn, konsullin austriak dhe studiuesin e ardhshëm të albanologjisë. I gjithë aktiviteti i sipërm studiues, vendas dhe evropian, formoi sfondin për dramën e Shemsedin Samiut, *Besa jahud Ahde Vefa*.

Shoqëria shqiptare ishte komplekse dhe e fragmentuar. Në gjuhën shqipe, fjala për “Albania” është Shqipëri, ose Vendi i Shqiponjave, dhe “albanians” janë shqiptarë, Bijtë e Shqiponjave. Në vitin 1877-78, Shqipëria ishte e ndarë administrativisht ndërmjet katër provincave (*vilajet-eve*) otomane të Ishkodra-s (Shkodrës), Kosovës (Kosovo), Manastirit (Bitola) dhe Yan-ya [Janinës]. Nga pikëpamja kulturore, shoqëria shqiptare ndahej në dy rajone që veçoheshin nga Lumi Shkumbin, pikërisht në jug të Tiranës. Toskët që banonin në Shqipërinë Veriore, quheshin *Toskëri* ose *Toskëlik*, në gjuhën shqipe dhe turqishten otomane respektivisht. Gegëve, nga ana e tyre, që jetonin në Shqipërinë veriore, iu referoheshin si *Gegani* apo *Gegëlik*, një rajon që përfshinte provincat e Shkodrës, Kosovës dhe një pjesë të vogël të Manastirit. Secili rajon zotëronte dialektin e vet të veçantë. Dialekti tosk përfshinte shumë fjalë greke në fjalorin e tij. Por shqiptarët toskë dhe gegë mund ta kuptonin me lehtësi njëri-tjetrin.

Shqiptarët ndaheshin ndërmjet tre komuniteteve ligjrisht të veçanta fetare. Vlerësimet e përafërta e caktonin popullsinë shqiptare në mbi një milion muslimanë, 300.000 ortodoksë dhe

180.000 katolikë. Përafërsisht 70 për qind e shqiptarëve identifikoheshin me Islamin dhe përbënin shumicën dërrmuese religjioze të popullsisë në të dy rajonet. Shqiptarët katolikë përbënin afro 10 për qind të popullsisë shqiptare, të përqendruar në veri, me ortodoksët që përbënin 20 për qind, kryesisht në jug.

Në përputhje me tre besimet e veçanta, shqiptarët përfshiheshin nën tre hierarki të veçanta religjioze. Sulltani ishte mbrojtës i muslimanëve, të cilët ai i administronte nëpërmjet *shejhulislam*-it të tij, zyrtarit kryesor fetar musliman në perandori. Tre gjuhë letrare përbënin, përgjithësisht, pjesën e arsimit të elitës muslimane. Turqishtja otomane shërbente si gjuhë zyrtare e administratës, arabishtja si gjuhë e Islamit dhe Kuranit, dhe persishtja si gjuhë popullore e poezisë. Shkollat qeveritare nuk e ofronin gjuhën shqipe si gjuhë shkollimi.

Shqiptarët ortodoksë ranë nën autoritetin e Patrikanës Ekumenike Rume, rezidenca e së cilës ndodhej në distriktin Fener të Stambollit. Kjo patrikanë kontrollonte shkollat dhe kishat ortodokse në Shqipëri dhe greqishtja shërbente si mjet i vetëm për shkollim dhe adhurim. Kështu, shqiptarët ortodoksë i përkisnin administrativisht komunitetit rum [grek]. Shqiptarët katolikë hynë nën proteksionizmin e Austro-Hungarisë. Një kler i huaj, italian ose austriak, udhëhiqte jetën fetare të shqiptarëve katolikë, pasi priftërinjtë vendas ishin të paktë në numër. Shqiptarët katolikë e patën më të lehtë për të shprehur kulturën e tyre të veçantë, sesa pala tjetër e tyre në Islam dhe Ortodoksi. Kleri i huaj e përdorte gjuhën shqipe në shkollat e tij fetare dhe botonte materiale në gjuhën shqipe. Çdo komunitet fetar kishte dinamikën e vet të brendshme të fuqishme, të drejtuar pjesërisht nga vendndodhja e tij gjeografike.

Përveç tre besimeve të veçanta, rendi sufi i bektashinjve pretendonte shumë pasues shqiptarë, veçanërisht në *Toskëlik* ndërmjet toskëve. Bektashizmi kishte qenë rendi sufi zyrtar (*tariqat*) i jeniçerëve deri në shkatërrimin e fundit në vitin 1826. Pas shkatërrimit të Korpusëve të Jeniçerëve, Sulltan Mahmudi II e ndaloi edhe rendin, duke i detyruar bektashinjët të iknin në Stamboll; shumë prej tyre u vendosën në rajonin e largët të Shqipërisë. Bektashinjët pinin verë dhe nuk agjëronin gjatë Ramazanit. Teologjia bektashiane përfshinte një doktrinë pothuaj trinitariane. Toleranca fetare

e përgjithshme e rendit bëri të mundur që të përkrahej dialogu ndërmjet muslimanëve dhe të krishterëve. Bektashinjët, në këtë frymë, ndihmuan ushqimin e kulturës dhe të gjuhës shqipe brenda kufijve të manastireve të tyre. Në vitin 1878, sipas një llogaritje, rendi bektashi kishte njëzet teqe në Shqipërinë Jugore.

Gjatë gjithë periudhës së këtij studimi, nëpunësit otomanë panë edhe bashkimin edhe përçarjet midis shqiptarëve. Ata i përmendin ata si “shqiptarë” (*arnavudlar*) ose “populli shqiptar” (*arnavud kavmi*), por gjithashtu ata përdornin edhe termat toskë dhe gegë. Krahinat shqiptare quheshin *Arnavudluk*, por në dokumente haset edhe emërtimi *Toskëlik* dhe *Gegëlik*, *Arnavudluk* ishte një emërtim gjeografik, *kavim* kishte kuptimin e një populli në sensin etnik, dhe *kavimijet* nënkuptonte etnicitetin. Të gjithë këta terma ishin esencialisht pa ndonjë kuptim politik. Në fillim të vitit 1870, shqiptarëve iu desh që ta shtjellonin dhe ta përfaqonin ideologjinë moderne të nacionalizmit etnik. Shoqëria shqiptare ishte ende shumë e përçarë në krahina dhe grupe shoqërore pa një vetëdijje të fortë kombëtare.

Përfundim

Imazhi i shqiptarëve në shoqërinë otomane përshkonte një spektër të gjerë: nga një popull përgjithësisht besnik me një histori shërbimi dhe sakrifice për perandorinë, deri te një grup etnik i egër, rebel dhe i pabesë. Duke shpërfillur çdo cilësi negative, Shemsedin Samiu vendosi ta shkruajë *Besa jahud Ahde Vefa* me qëllim që ta paraqesë popullin shqiptar në një dritë sa më pozitive për publikun otoman. Ai paraqiti një portret mjaft të idealizuar të një populli me attribute fisnike, të tilla si besnikëria ndaj fjalës së dhënë, nderi dhe vetë-flijimi – një popull që kishte derdhur shumë gjak për shtetin otoman. Si një vepër teatrale, drama paraqiste një pohim të fuqishëm kulturor të identitetit etnik shqiptar në Stamboll për publikun otoman. Ndërkaq, në Shqipëri, njerëzit, gjithashtu, pohonin dallueshmërinë e tyre sa herë që ata flisnin në gjuhën e tyre amtare, vishnin veshjen e tyre amtare, ose praktikonin traditat e tyre amtare. Përveç kësaj, otomanët joshqiptarë ishin plotësisht në dijeni të shqiptarisë kur ata vërenin praktikatat e sipërme.

Në vendosjen e shfaqjes brenda kontekstit të kohës të tij, Shemsedin Samiu paraqet dy vatane. Vatani i përgjithshëm ose otoman përfaqësonte një identitet

dhe lidhje mbinacionale të bashkimit të të gjithë popujve të ndryshëm të perandorisë së bashku nën flamurin e otomanizmit, ashtu siç definohej nga reformat e Tanzimatit. Vatani i veçantë përfaqësonte atdheun e një *kavim* ose një populli të bazuar mbi “kombësinë etnike” (*kavmi-jet*), në këtë rast Shqipërinë. Shemsedin Samiu i vlerësonte dy vatanet si anë të ndryshme të së njëjtës monedhë, dhe kjo ishte në përputhje me unitetin otoman, që përfshinte diversitetin etnik. Në hyrjen e tij, Shemsedin Samiu kishte lënë të kuptohej se nevojitej që letërsia otomane t’i kushtonte më tepër vëmendje kulturore të ndryshme vendase të perandorisë. Ai sigurisht kërkonte një shprehje më të madhe të shqiptarisë nga populli shqiptar.

Por Shqipëria dhe shoqëria shqiptare ishin shumë më komplekse sesa portreti i idealizuar i paraqitur në *Besa jahud Ahde Vefa*. Shemsedin Samiu e kuptoi këtë realitet. Përveç historisë së shërbimit dhe sakrificës për *din ve devlet ve vatan*, shqiptarët gjithashtu kishin një dosje të pasur të rebelimeve kundër pushtetit qeveritar. Ahmed Xheveti kapi imazhin e fundit kur ai i përshkroi shqiptarët si një popull “i egër”. Përveç kësaj, besnikëritë e tjera në popull [*kavim*] dukeshin shumë më të fuqishme sesa patriotizmi shqiptar. “Organizimi fisnor [tribalizmi]” (*asabijet*) i jepte përparësi fisit mbi të gjithë grupin më të madh etnik. Dallimet midis *Toskalik* ve *Gegalik* nxitnin krahinorizmin. Gjithashtu, faktorët religjiozë, shoqërorë dhe ekonomikë përcaktinin interesat dhe pikëpamjet individuale. Me dhënien e diversitetit në shoqërinë shqiptare, Shemsedin Samiu nuk kishte dyshim se synonte që të nguliste një identitet kombëtar dhe krenarinë midis bashkatdhetarëve shqiptarë, por spektatorët e tij të parë ishin qarqet e shkolluara të rëndësishme otomane.

Brenda katër vjetëve, pas shfaqjes në skenë të *Besa jahud Ahde Vefa*, Perandoria Otomane thua jse në mënyrë të befasishme dhe të papritur përjetoi krizën më të madhe, një krizë që e preku drejtpërsëdrejti Shqipërinë dhe shqiptarët. Si kundërpërgjigje, intelektualët dhe aktivistët shqiptarë u përpoqën që t’i bashkojnë shqiptarët në mbrojtje të vatanit shqiptar dhe, në vazhdim, të përcaktojnë qartë vendin e Shqiponjës Shqiptare nën Gjysmëhënën Otomane. Këto përpjekje do ta vinin në provë angazhimin e shqiptarëve për Shqipërinë e tyre. (vazhdon...)

Përktheu nga anglishtja
Mimoza SINANI

Intervistë me poetin dhe dramaturgun Ilir Muharremi

Arti është sferë

Intervistoi: Edmonda MAZREKU

Përmes poezisë shprehen të gjitha ato shqetësime dhe trazime që njeriu ka brenda vetes. Janë këto fjalët që dalin bindshëm nga goja e poetit dhe dramaturgut Ilir Muharremi, në shpirtin e të cilit poezia dhe drama ruhen përherë si të veçanta.

Poezia për Ilirin është çlirim nga shumë ato përzjerje dhe stuhi me vetveten, ku përmes metaforës, shprehet i gjithë sinqeriteti, duke u bërë përherë gjuhë plotësimi dhe rikthim nëpër përhumbjet personale.

Për të mësuar më shumë rreth krijimtarisë së tij, revista “Paqja” zhvilloi një intervistë me poetin dhe dramaturgun Ilir Muharremi.

PAQJA: Ilir, ju keni doktoruar në dramaturgjji, por në të njëjtën kohë shkruani edhe poezi. Çfarë është poezia për ju?

Iliri: Poezia për mua është ajo e pavetëdijshmja, e cila bëhet e vetëdijshme. Atë e nxjerr nga vetja, tinëzisht prek egon, duke e transmetuar me fjalë. Shqetësimet, ngacmimet trazojnë detin tim poetik, e shndërrojnë në një vullkan ose magmë ngjyrash, të cilat përjetohej dhe dëgjohej. Çlirohen nga ajo përzjerje dhe stuhi e vetvetes, duke u plasuar në të jashtmen. Poezia është e sinqertë në përjetimin e saj individual.



PAQJA: A ndiheni i plotë dhe i çliruar kur shkruani poezi?

Iliri: Eh i plotë, mund të them në një shkallë i çliruar, duke u futur në labirintet fizike e morale të qenies sime, duke nxjerr në pah vuajtjet, kënaqësitë, fatkeqësitë, lumturitë, të cilat shoqërojnë qenien time. Qëllimi është të tregohet sinqeriteti artistik-poetik i imi, por nëse kam gjetur plotësinë, ose nëse jam shpërndarë i tëri, mendoj se ende mbetet tek unë diçka në thellësi pa u kënduar. Mund të them, ka melodi melankolike të pakënduara të cilat presin që koha t’i nxjerrë.

PAQJA: Çfarë mendoni për poezinë shqipe?

Iliri: Në përgjithësi poezia shqipe nuk është aq e mjerueshme, siç e theksojnë shumë analistë ose poetë. Mungon ajo dehja e sinqertë sikurse e kemi te poeti i madh Charl Bodler, i cili nga sinqeriteti individual shpërthen dhe shoqërohet nga vuajtjet, fatkeqësitë, lumturitë dhe i pasqyron me një gjuhë të simbolizmit dhe modernizmit. Kurse tash mungojnë poezitë e poetëve postmodernë. Kur them mungojnë fjala është tek origjinaliteti postmodern, e jo klasik siç jemi mësuar t’i gëlltitim. U mungon ai origjinaliteti postmodern, relativizmi dhe skepticizmi më radikal se paraardhësit e tyre. Ky art postmodern është i lidhur ngushtë me post-strukturalizmin dhe ka shumë elemente të përbashkëta.

PAQJA: Ju deri tani keni botuar dy libra me poezi dhe një dramë. Na flisni diçka rreth tyre?

Iliri: Librin e parë me poezi “Djali në qytetin” e kam botuar kur isha vetëm trembëdhjetëvjeçar, në një kohë të rrezikshme, kur nuk guxohej të botohej gjithçka, ngase kjo vepër përmban pakënaqësi ndaj regjimit të asaj kohe, duke e shprehur direkt në vargje. Ndërsa, “Dera e fundit e çmendurisë” është libri i dytë me poezi, i cili posedon filozofi, psikologji, fantazi individuale, duke buruar nga realiteti. Është plotë dhimbje dhe ekspresivitet, i ngjan veprave të Van Goghut, në kuptim jo të njëjtë, por nëse i lexon me ëndje dhe i thellon në unin

ë e jetës

tënd, atëherë do vërshohesh nga arti ekspresiv si bazë. Disa janë postmoderne të strukturuar mirë, por unë nuk kam dëshirë të flas për poezitë e mia. Ato ia lë kritikës të ballafaqohet.

PAQJA: Poezia juaj është një metaforë, e cila çfarë i jep më tepër të kuptojë lexuesit?

Iliri: I jep të kuptojë atë thellësinë, ndjenjësinë, simbolikën dhe realitetin e brendshëm individual. Shpeshherë poezia ime është globale, ekspresive, e prekur nga nuancat e postmodernizmit.

PAQJA: Si është pritur poezia juaj nga kritika shqiptare?

Iliri: Është pritur mirë, si nga adhuruesit e poezisë, po ashtu edhe nga kritikët. Poezia është si piktura, ndjenja shpërthen në telajo me ndihmën e koloritit. Kontrollon nga dora e mjeshtrit, por përgjigjet gjenden në thellësi. Spektatorët zbulojnë përgjigje të ndryshme dhe nga ato përgjigje mjeshtri mëson më shumë për pikturën. Ashtu edhe unë mësoj nga vlerësimet dhe përgjigjet e adhuruesve të poezisë sime.

PAQJA: Na flisni diçka më konkrete për dramën "Van Goghu kosovar". Si është pritur nga dramaturgët shqiptarë?

Iliri: Drama "Van Goghu kosovar" buron nga një përjetim i thellë me nu-



anca ekstaze, surreale dhe absurde. Ngjarja rrëfen për një piktor 22-vjeçar, i cili përjeton momente të vështira jetësore gjatë periudhës së rinisë, gjë që i kushton shumë shtrenjtë në fazat e mëvonshme të jetës. Në luftë, ushtria serbe ia vret nënën, babanë dhe motrën. I tmerruar nga sa kishte parë duke ia masakruar familjen, ai kalon në skizofreni. Tërë ngjarja pasqyron jetën e tij prej skizofreni, nga e cila në fund nuk mund të shërohet, andaj si 'strehë' e gjen çmendinë. Kjo dramë është vënë në skenë në vitin 2007 nga regjisori Hazir Sh. Haziri, i cili e ka inskenuar mjaft mjeshhtërisht, duke i mbetur besnik strukturës së veprës. Kritikët e kanë pritur mjaft mirë, si në Shqipëri, Maqedoni, Mal të zi dhe Kosovë.

PAQJA: Cilat tema preferoni t'i shtjelloni më shumë në krijimtarinë tuaj?

Iliri: Temat aktuale, përjetime individuale, preokupimet shoqërore, problemet ekonomike, juridike, ekzistenciale dhe të absurdit. Qëllimi i artistit tim është të futet në çdo sferë dhe t'i jap vizion shtetit.

PAQJA: Cilat janë disa nga mangësitë themelore dhe shkaqet rreth zhvillimit të dramës shqipe sot?

Iliri: Drama shqipe nuk është shumë e varfër, e varfër në kuptim të gjuhës nëse flasim për Shqipërinë. Mirëpo, nëse do ta krahasojmë me Kamynë, Joneskon, Sartrin dhe Brehtin, atëherë thellësia dhe zhvillimi i përzierjes së

ngjyrave është më i zbehtë. Konflikti, gradacioni, kompozicioni dhe struktura e autorëve të huaj, është jashtë mase mahnitëse, mbresëlënëse, vullkanike dhe arrin të prekë çdo ndjenjë, qoftë ajo edhe e rëndomtë. Ndërsa, në dramën shqipe, prapa vellos së autorit, fshihet naiviteti jo profesional dhe jo filozofik, por sipërfaqësisht tentojnë të futen në labirint të përzier. Ndoshta më kupton se ku e kam fjalën!

PAQJA: Cili është mendimi juaj për kritikët e dramaturgjisë shqipe?

Iliri: Ne nuk kemi kritikë dhe këtë e them me plot arsye. Ne kemi vetëm kritikë pozitive duke dëmtuar dramaturgët dhe duke fshehur jo dijen e tyre.

PAQJA: Çfarë duhet të ndryshojë në dramaturgjinë shqiptare?

Iliri: Shumëçka. Së pari duhet të ndërtohet sinqeriteti me veten. Guximi për të prezantuar realitetin momental dhe ngacmuar problemin, i cili zgjerohet në horizonte pa kufij.

PAQJA: Në fund të kësaj interviste, cili është mesazhi juaj për lexuesit e revistës "Paqja"?

Iliri: Mesazhi im është që të punohet sa më shumë e jo të flitet pa menduar duke nënçmuar vlerat e të tjerëve. Në artin skenik, nëse nuk funksionon kolektivi, atëherë vlera bie në humnerë. Më vjen mirë që revista "Paqja" trajton tema hulumtuuese dhe prezanton mendime të shëndosha. ■

STRESI I SHKAKTUAR NGA TRAUMAT!

Artan BEJTA & Jehona SAHITI

Cdoherë, pas përjetimit të ndonjë traume, është normale të ndjeni frikë, mërzë, ankth dhe hutim. Mirëpo, në rastet e zakonshme, me kalimin e kohës, mërzia fillon të zbehet dhe ju filloni ta shijoni jetën përsëri. Por, nganjëherë ndodhia traumatike është aq e madhe sa që ju nuk mund ta tejkaloni dot. Ndihehi i ngujuar brenda ndjenjës së rrezikut të vazhdueshëm dhe kujtimeve të dhimbshme të cilat nuk zbehen.

Nëse keni përjetuar ndonjë ndodhi traumatike dhe nuk po mund ta riktheni normalitetin në jetën tuaj, nuk po mund të shoqëroheshi me persona të tjerë dhe nuk po ndiheni i sigurt, atëherë ka mundësi që ju jeni duke vuajtur nga stresi post-traumatik, stresi i shkaktuar pas ndodhisë traumatike. Personat me PTSD (post traumatic stress disorder) ndihen sikur nuk do të mund ta harrojnë kurrë ngjarjen e frikshme dhe nuk do të bëjnë kurrë përsëri jetë normale. Mirëpo, kjo gjendje tejkalohet nëse kërkoni ndihmën e mjekut, keni përkrahje dhe fitoni shprehje të reja të adaptimit.

Çka është stresi post-traumatik?

Stresi post-traumatik është formë e rëndë e ankthit që lajmërohet te personat pas ekspozimit ndaj ndonjë ndodhie, e cila ju shkakton stres psikologjik. Ngjarje të tilla janë ato ku vetë personit ose të tjerëve u kanoset rreziku me vdekje, pastaj ato ku cenohet integriteti fizik, seksual ose psikologjik i vetë personit, ose i personave të tjerë në prani të tij. Pra, stresi post-traumatik është efekt i traumës psikologjike, ku personat që e përjetojnë këtë hasin në vështirësi në sferën sociale, në punë dhe në jetën e përditshme.

Shumica e njerëzve e lidhin stresin post-traumatik me ushtarët dhe luftën, që është shkaku më i shpeshtë te meshkujt, por PTSD-në mund ta nxitë çdo eksperiencë jetësore e rëndë, e cila është e pakontrollueshme dhe e paparashikueshme.

Stresi post-traumatik lajmërohet në personat që e përjetojnë vetë ndodhinë traumatike, personat që janë dëshmitarë të saj dhe personat që merren me pasojat e saj si p.sh: punëtorët e emergjencës, hetuesit, policët etj., madje lajmërohet edhe te familjarët dhe shokët e personit që e ka përjetuar traumën aktuale.

Stresi post-traumatik te secili person zhvillohet ndryshe. Simptomat e PTSD-së lajmërohen zakonisht disa orë ose ditë pas ndodhisë traumatike, por në disa raste ato lajmërohen edhe disa javë, muaj ose vite më vonë.

Numri i ngjarjeve traumatike që mund të shkaktojnë stres post-traumatik (PTSD) është shumë i madh, e ndër ngjarjet më të shpeshta mund të përmendim luftën, katastrofat natyrore, aksidentet rrugore ose ajrore, sulmet terroriste, vdekja e papritur e personit të dashur, dhunimi, rrëmbimi, agresioni, abuzimi seksual ose fizik, braktisja në fëmijëri, ose çdo ndodhi shkatërruese ndaj të cilës ju ndiheni të pafuqishëm dhe të pashpresë.

Dallimi midis stresit post-traumatik dhe reagimit normal ndaj traumës

Ngjarjet traumatike që shkaktojnë PTSD janë zakonisht shumë shkatërruese dhe të frikshme saqë e dëshpërojnë secilin njeri. Gati secili person që e përjeton ndonjë ndodhi traumatike përjeton një ose disa nga simptomat e stresit post-traumatik. Kur thyhet ndjenja e sigurisë dhe besimit tuaj, është normale që të ndiheni si të çmendur, të mpiheni ose të hutoheni. Shumë shpesh ndodh të shihni ëndrra të këqija, të keni frikë dhe të mos mund të ndaleni duke menduar për ngjarjen traumatike. **Ky është reagim normal ndaj ndodhive jonormale.** Te shumica e njerëzve këto simptoma zgjasin disa ditë ose javë, por zbehen gradualisht derisa më në fund zhduken. Por, nëse keni PTSD, simptomat jo që nuk zvogëlohen, por ato vetëm sa

keqësohen dita-ditës. **Reagimi normal ndaj traumës mund të shndërrohet në PTSD nëse ju tërhiqeni në vetvete.**

Pas përjetimit të traumës, mendja dhe trupi janë në shok. Por kur ju bëheni të vetëdijshëm për atë që ka ndodhur dhe i shqyrtoni emocionet tuaja, e përbaltoni me lehtë gjendjen e tillë. Kurse në PTSD, ju mbeten në shok psikologjik. Kujtimet për atë që ka ndodhur dhe ndjenjat tuaja nuk lidhen si duhet. Për ta tejkaluar këtë gjendje, duhet patjetër të përballemi me kujtimet dhe emocionet tuaj.

Shenjat dhe simptomat e PTSD-së

Simptomat e stresit post-traumatik mund të shfaqen shpejt, gradualisht ose ta ndërrojnë intensitetin e paraqitjes së tyre me kalimin e kohës. Nganjëherë paraqitja e tyre është e papritur, kurse nganjëherë ato i nxit ndonjë gjë që na kujton ngjarjen traumatike si p.sh. ndonjë zhurmë, pamje, aromë ose fjalë e caktuar.

Çdo person e përjeton ndryshe PTSD-në, prandaj simptomat ndahen në tri grupe:

1. Përjetim i sërishëm i ndodhisë traumatike (ripërjetimi i traumës)

- Kujtime të bezdisshme dhe të hidhura për ngjarjen
- Kthim në të kaluarën (veprime ose përjetime sikur ngjarja po ndodh përsëri)
- Ankthe gjatë natës



(për ngjarjen traumatike ose për ndonjë gjë tjetër të frikshme)

- Kaplim i stresit shumë intensiv kur kujtohet ngjarja traumatike
- Reagim intensiv i organizmit kur kujtohet trauma (rrahje të shpejtuara të zemrës, frymëmarrje e shpejtuara, vjellje etj.)

2. Ankthi i shprehur dhe emocione të theksuara

- Vështirësi për të rënë në gjumë ose për të qëndruar në gjumë
- Irritabilitet ose shpërthim i zemërimit
- Koncentrim i vështirësuar
- Hipervigjilitet
- I nevrikosur dhe që shqetësohet lehtë

3. Tërheqje në vetvete dhe ndjenja e shtangimit

- Personi eviton aktivitetet, vendet, mendimet ose ndjenjat që ia kujtojnë traumën
- Nuk i kujton dot detajet e traumës
- Humbet interesin ndaj aktiviteteve dhe jetës në përgjithësi
- Ndihet i izoluar nga të tjerët dhe emocionalisht i shtanguar
- Ka ndjenjën se të ardhmen e ka të kufizuar (që nuk do të bëjë jetë normale, të martohet, të bëjë karrierë etj.)

4. Simptomat e tjera të shpeshta në PTSD:

- Zemërim dhe irritabilitet
- Ndjenjë e fajit, turp, fajësimit të vetes
 - Abuzimi me substanca
 - Ndjenja e mosbesimit dhe tradhtisë
 - Depresion dhe humbje e shpresës
 - Mendim për të bërë vetëvrasje
 - Ndihet i vetmuar dhe i huaj
 - Dhimbje fizike

A reagojnë fëmijët ndryshe nga të rriturit?

Fëmijët dhe tinejxherët mund të reagojnë në mënyra ekstreme ndaj traumës, por simptomat e tyre dallojnë nga simptomat e të rriturve. Te fëmijët e vegjël vërehen këto simptoma:

- Humbje e shprehisë për kontroll të urinimit dhe defekimit pasi që e kanë fituar atë
- Harrojnë ose nuk mund të flasin më
- E paraqet traumën përmes lojës, vizatimit etj.
- Ngjitet tepër për prindin ose ndonjë të rritur tjetër, ngase ka frikë nëse ndahet nga prindi
- Gjurmë të shqetësuar me ankthe me përmbajtje të paqartë
- Lojë kompulsive ku i përsërit temat e traumës
- Dhimbje që nuk kanë shkas të dukshëm
- Bëhen agresive dhe irritohen lehtë

Simptomat te fëmijët më të rritur dhe te tinejxherët janë të ngjashme me ato te të rriturit. Tek ata shpesh bile zhvillohen sjellje përçarëse, jorespektuese dhe shkatërruese. Bile ata nganjëherë ndihen me faj që nuk e kanë parandaluar lëndimin ose vdekjen, e ndonjëherë edhe duan të hakmerren.

Shkaktarët dhe faktorët e rrezikut për PTSD

Edhe pse është e pamundur që të parashikohet se te cilët njerëz do të paraqitet PTSD, megjithatë ekzistojnë disa faktorë të rrezikut që ju bëjnë më të ndjeshëm në këtë sëmundje.

Shumë faktorë të rrezikut kanë të bëjnë me vetë karakteristikat e traumës. PTSD shkaktojnë më tepër ato trauma

të cilat paraqesin rrezik serioz për jetën ose sigurinë personale: sa më i madh dhe i zgjatur kërcënimi, aq më e madhe mundësia që personi të përgjigjet me PTSD. Të këqijet e qëllimshme të shkaktuara nga njerëzit, si: dhunimi, agresioni, torturimi, janë më traumatike se sa të lindurit me të meta të ndryshme ose aksidentet dhe katastrofat. Ka shumë rëndësi edhe fakti që trauma është e papritur, e pakontrollueshme dhe pa mundësi shpëtimi nga ajo.

Faktorë të tjerë të rrezikut për PTSD-në janë:

- Përvojat e mëparshme traumatike, sidomos në moshë të re
- Historia pozitive familjare për PTSD-në ose depresion
- Historia e abuzimit fizik ose seksual
- Historia e abuzimit të narkotikëve
- Histori e depresionit, ankthit ose sëmundjeve të tjera mentale
- Niveli i lartë i stresit në jetën e përditshme
- Mungesa e përkrahjes pas traumës
- Pamundësia për t'u adaptuar

Mjekimi i PTSD-së

Nëse dyshoni që ju ose ndonjë person i juaji i afërt ka simptome të PTSD-së, duhet që menjëherë të kërkoni ndihmën e mjekut. Sa më herët që përballenit me PTSD-në, aq më lehtë e mposhtni atë. Nëse ngurroni të kërkoni ndihmë, dijeni që PTSD-ja nuk është shenjë e dobësisë dhe se e vetmja mënyrë për ta tejkaluar atë është përballja me atë që ju ka ndodhur dhe pranimiti i saj si pjesë e së kaluarës. Ky proces është shumë më i lehtë nëse kërkoni ndihmë dhe udhëhiqeni nga ndonjë profesionist mjekësor.

Është shumë e natyrshme që të mos doni t'i kujtoni ndjenjat dhe kujtimet e dhimbshme. Por, nëse mundoheni që ta mbyllni veten dhe t'i ndrydhni kujtimet tuaja, PTSD-ja vetëm sa do të keqësohet. Ju asnjëherë nuk do të mund t'i largoni këto emocione plotësisht – ato do të dalin në shesh posa t'i nënshtroheni edhe stresit më të vogël. Prandaj, kjo shmangie vetëm sa do t'i dëmtojë raportet tuaja me njerëzit, aftësinë tuaj për të funksionuar dhe kualitetin e jetës suaj.

Ja pse duhet mjekuar PTSD-ja:

1. Mjekimi i hershëm jep rezultate më të mira në shërim
2. Simptomat e PTSD-së mund t'ua ndryshojnë jetën familjare
3. PTSD-ja mund të ketë lidhje me probleme të tjera shëndetësore. ■





BERISHA NË ANALET E FUTBOLLIT AUSTRALIAN!

Besart Berisha ka hyrë në analet e futbollit australian, duke shënuar hetrikun më të shpejtë në një ndeshje futbollit. Ai ka shënuar 3 gola për vetëm 5 minuta (24,27,29 min), në fitoren e klubit të tij Brisbane Roar kundër Adelaide United

Alban BILALLI

Atë që nuk e ka bërë Messi, Ronaldo dhe shumë yje të tjerë të futbollit, e bëri Besart Berisha, futbollisti shqiptar nga Prishtina, duke shënuar hetrik brenda vetëm 5 minutave. Në javën e katërt të kampionatit australian, Berisha ka shënuar 4 gola në fitoren historike të skuadrës së tij Brisbane Roar kundër Adelaide United, me rezultat 7 me 1. Fitorja e Brisbane mbeti nën hije të hetrikut të Berishës, i cili shënoi tre “ekspresgola” për vetëm 5 minuta (24,27,29). Me këtë hetrik, Berisha hyri në analet e futbollit australian, duke u bërë futbollisti i parë që ka shënuar tre gola vetëm brenda 5 minutave.

Në një intervistë të shkurtër dhënë revistës sonë, Berisha është shprehur i habitur me mënyrën se si ka shënuar, por në anën tjetër është shprehur mjaft i lumtur për këtë arritje. “Ka qenë një moment i pabesueshëm. Edhe për mua shënimi i tre golave ka qenë aq i shpejtë sa që nuk kam pas kohë m’i analizu mirë. Kënaqësia ka qenë e papërshkrueshme, diçka që më ka munguar shumë në futboll kohëve të fundit,” - është shprehur për revistën “Paqja” futbollisti shqiptar Besart Berisha.

Befason klubin dhe mediat

Hetriku i Berishës ka befasuar jo vetëm opinionin futbolldashës, por edhe vetë klubin e tij dhe mediat australiane, të cilat i kanë kushtuar vëmendje të

madhe superndeshjes së Berishës. Vetë Berisha është shprehur se klubi ka qenë i befasuar me fillimin e shpejtë të shënimit të golave, ngase ai javë më parë shkoi në Australi. “I gjithë stafi i Brisbanit kanë qenë shumë shumë të lumtur dhe të befasuar. Ata as që e kanë pritur që kaq shpejt do të filloj me shënimin e golave në këtë sezon,” - është shprehur Berisha.

Urimet për të nuk kanë munguar edhe jashtë Australisë. Nga Gjermania e Kosova ai ka marrë mjaft urime për këtë sukses, por edhe ka qenë i ftuar në emisione televizive dhe intervista nëpër gazeta australiane. “Kam pas shumë urime, si brenda Australisë, nga Gjermania, Kosova etj. Kam pas shumë



shumë intervista, si dhe kam qenë i ftuar në shumë emisione sportive. Një ndjenjë e mirë kjo, nuk e kam pritur të them të drejtën,” - është shprehur Berisha.

Nuk është kontaktuar nga Shqipëria!

Kur një sulmues tregon lojëra të mira, ai patjetër duhet të ftohet nga Kombëtarja e tij. Kjo nuk po ndodh për Berishën, i cili ende nuk është ftuar këtë vit që të luajë për Shqipërinë. Për kombëtaren kuqezi, Berisha deri më tani ka zhvilluar 17 ndeshja duke shënuar 2 gola. Berisha e pranon që nuk është kontaktuar nga kombëtarja kuqezi, por thotë se për momentin është i fokusuar për Brisbane e më pas do të vijë koha edhe për kombëtaren. “Kombëtarja Shqiptare nuk më ka kontaktuar fare, por për mua momentalisht është shumë me rëndësi që këtë vit të jem i fokusuar në ekipin tim Brisbane Roar, sepse kam pas dy vite shumë të vështira. Besoj që më mirë për mua është të jem prezent gjithë sezonin në Brisbane e pastaj do t’i vijë koha edhe kombëtares kuqezi,” - është shprehur Besart Berisha, sulmuesi shqiptar në radhët e kampionit australian Brisbane Roar.

Kombëtarja shqiptare duhet t’i bëjë ftesë Berishës, ngase ajo ka nevojë për një goleador si Berisha. Berisha në një ndeshje shënoi katër gola, kurse Shqipëria në 10 ndeshjet kualifikuese për Kampionatin Evropian në futboll “EURO 2012” shënoi vetëm 7 gola! ■